



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I MINISTRAVE

**Dokumenti i Orientimit  
Të  
Ndhmës së Huaj**

Prill 2008

# Përmbajtja

## 1. Hyrja 8

1.1 Qëllimi .....	8
1.2 Metodologjia dhe struktura e raportit .....	8
1.3 sistemi i planifikimit të integruar dhe strategjia kombëtare për zhvillim dhe integrim .....	9
1.4 Deklarata e parisit mbi efektivitetin e ndihmës së huaj.....	9

## 2. Tendencat aktuale të ndihmës së huaj..... 11

2.1 Tendencat e përgjithshme të ndihmës së huaj.....	11
2.2 Ndhma e Huaj dhe Ekonomia .....	12
2.3 përbërja e ndihmës së huaj.....	14
2.4 Investimet publike sipas financimit të brendshëm dhe të huaj .....	17

## 3. Orientimi i ndihmës së huaj brenda sektorëve ..... 18

3.1 Demokratizimi dhe Shteti i SË drejtës .....	19
3.2 Zhvillimi ekonomik .....	26
3.3 Infrastruktura .....	29
3.5 Zhvillimi Social .....	34
3.6 Zhvillimi territorial.....	43

## 4. Orientimi i ndihmës së huaj në të ardhmen ..... 48

4.1 Burimet e ndihmës së huaj në të ardhmen .....	48
4.2 Fokusi sektorial .....	49

## 5. Përmirësimi i menaxhimit të ndihmës së huaj ..... 56

5.1 Raportimi dhe regjistrimi i ndihmës sW huaj.....	56
5.2 Lidhja me Buxhetin.....	57
5.3 kapaciteti DisbursUES dhe absorbues i Ndhmës së Huaj. ....	61
5.4 Monitorimi dhe Vlerësimi.....	62

## ANEKSI 1. NDIHMA E HUAJ SIPAS DONATORËVE ..... 65

## ANEKSI 2. PROGRAMIMI I DONATORËVE ..... 66

## Shkurtime

BB	Banka Botërore
BE	Bashkimi Europian
BEI	Banka Europiane e Investimeve
BERZH	Banka Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim
CARDS	Ndihma Komunitare për Rindërtim, Zhvillim dhe Stabilizim
CEB	Banka e Zhvillimit të Këshillit të Europës
CFCU	Njësia Qëndrore Financiare e Kontraktimit
DAC	Komiteti i Ndhmës për Zhvillim
DfID	Departamenti i Mbretërisë së Bashkuar për Zhvillim Ndërkombëtar
EURALIUS	Misioni i Asistencës Europiane për Sistemin e Drejtësisë në Shqipëri
FAO	Organizata Botërore e Ushqimit
FSHZH	Fondi Shqiptar i Zhvillimit
GEF	Shërbim i Mjedisit Global
GRECO	Këshilli i Europës Grupi i Shteteve kundër Korrupsionit
GTZ	Shoqëria Gjermane për Bashkëpunimin Teknik
IBRD	Banka Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim
IFAD	Fondi Ndërkombëtar për Zhvillimin Bujqësor
IFC	Korporata Financiare Ndërkombëtare
IFN	Instituti Financiare Ndërkombëtare
IHD	Investimet e Huaja Direkte
IOM	Organizata Ndërkombëtare për Migrim
IPA	Instrumenti i Para-aderimit
KE	Komisioni Europian
LCDP	Programi i Zhvillimit të Komuniteteve Lokale
MCC	Korporata e Sfidës së Mijëvjeçarit
MFP	Manaxhimi i Financimeve Publike
MIPD	Dokumenti i Planifikimit Indikativ Shumë Vjeçar
MSA	Marrëveshja për Stabilizim dhe Asociim
NATO	Organizata e Marrëveshjes së Atlantikut Verior
NJZP	Njësia e Zbatimit të Projektit
NVM	Ndërmarrje të Vogla dhe të Mesme
OBT	Organizata Botërore e Tregtisë
ODA	Ndihma Zyrtare e Zhvillimit
OECD	Organizata për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik
OSBE	Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Europë
OZHM	Objektivat e Zhvillimit të Mijëvjeçarit
PAMECA	Misioni i Asistencës së Policisë i Komunitetit Europian për Shqipërinë
PBA	Programi i Buxhetit Afatmesëm
PBB	Produkti i Brendshëm Bruto
PBP	Përjasje me Bazë Programi
PBS	Përjasje me Bazë Sektor
PEFA	Shpenzimet Publike dhe Përgjegjshmëria Financiare
PEIR	Rishikimi i Shpenzimeve Publike dhe Institucionale
PNUD	Programi i Zhvillimit të Kombeve të Bashkuara
PPR	Programi i Rishikimit të Politikës
PVH	Plani i Veprimit për Harmonizimin
SIDA	Agjencia Ndërkombëtare Suedeze për Zhvillim dhe Bashkëpunim
SIGMA	Mbështetje për Përmirësim në Qeverisje dhe Menaxhim
SKZHES	Strategjia Kombëtare për Zhvillimin Ekonomik dhe Social
SKZHI	Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim
SPI	Sistemi i Planifikimit të Integruar
SPPS	Mbështetje për Sistemet e Prokurimit Publik
STD	Sekretariati Teknik i Donatorëve
SWGs	Grupet Sektoriale të Punës

TIK	Teknologjia e Informacionit dhe Komunikimit
UN	Kombet e Bashkuara
UNAIDS	Programi i Përbashkët i Kombeve të Bashkuara për HIV/SIDA
UNEP	Programi Mjedisor i Kombeve të Bashkuara për Mjedisin
UNFPA	Fondi i Kombeve të Bashkuara për Popullsinë
UNHCR	Komisioni i Nivelit të Lartë për Refugjatët për Kombet e Bashkuara
UNICEF	Fondi Ndërkombëtar i Emergjencës për Fëmijët nga Kombet e Bashkuara
UNIDO	Organizata e kombeve të Bashkuara për Industrinë dhe Zhvillimin
UNIFEM	Fondi i Kombeve të Bashkuara për Gratë
USAID	Agjencia e Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar

**Ministritë, departamente, institucione dhe agjenci të tjera qeveritare**

AKSHI	Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit
DAP	Departamenti i Administratës Publike
DBSKNH	Departamenti i Bashkërendimit të Strategjive dhe Koordinimit të Ndhmës së Huaj
ERT	Enti Rregullator i Telekomunikacionit
INSTAT	Instituti i Statistikës
ITAP	Instituti i Trainimit të Administratës Publike
KESH	Korporata Elektroenergjitike Shqiptare
KM	Këshilli i Ministrave
KPS	Komiteti i Planifikimit Strategjik
MADA	Agjencia e Zhvillimit të Zonave Malore
MASH	Ministria e Arsimit dhe Shkencës
MB	Ministria e Brendshme
MBUMK	Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit
MD	Ministria e Drejtësisë
METE	Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjitikës
MF	Ministria e Financave
MI	Ministria e Integritimit
MMPAU	Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujrave
MPÇSSHB	Ministria e Punëve, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta
MPJ	Ministria e Punëve të Jashtme
MPPTT	Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit
MSH	Ministria e Shëndetësisë
MTKRS	Ministria e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve

## Përmbledhje

Dokumenti i orientimit të ndihmës së huaj fokusohet në rolin e ndihmës së huaj në zhvillimin e Shqipërisë në të gjitha fushat. Ky dokument përqendrohet në prioritetet afat shkurtër dhe afatmesme për financime të huaja gjatë periudhës 2008-2013, bazuar në Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim (SKZHI) e cila u miratua me anë të VKM nr. 342 datë 12.3.2008 të Këshillit të Ministrave. Dokumenti identifikon mënyrat sipas të cilave Qeveria synon të përmirësojë menaxhimin e ndihmës së huaj në Shqipëri.

Pavarësisht rëndësisë që ndihma e huaj ka për Prodhimin e Brendshëm Bruto (PBB), niveli i mbështetjes për frymë në Shqipëri është më i ulët në rajon: 109 euro për person në vit, 25% nën mesataren për Ballkanin Perëndimor. Totali i ndihmës së huaj nga 2000 deri në 2007 ka qenë relativisht i qëndrueshëm midis 300 milion euro dhe 350 milion euro në vit ose rreth 4% e PBB dhe 11% e totalit të shpenzimeve publike.

Aktualisht, *ndihma e huaj përbën rreth gjysmën e totalit të investimeve publike*. Në vitin 2000, grantet përbënin 68% të ndihmës së huaj por kjo përqindje ka pësuar rënie ndërkohë që përqindja e kredive është rritur duke i tejkaluar grantet për herë të parë në 2006.

Të dhënat nga OECD DAC për vitet 2000 - 2005 tregojnë se *totali i ndihmës së ofruar nga donatorët shumëpalësh dhe dypalësh është thuajse në të njëjtin nivel*: donatorët më të mëdhenj shumëpalësh janë Komisioni Europian (KE) (18%) dhe Banka Botërore (BB) (17%); dhe donatorët më të mëdhenj dypalësh janë SHBA (13%), Greqia (8%), Gjermania (7%) dhe Italia (5%). Tendanca aktuale është që KE, BB dhe Institucionet Financiare Europiane të rrisin mbështetjen e tyre për Shqipërinë në vitet në vijim.

*Shpërndarja sektoriale e ndihmës së huaj ka pësuar ndryshime të mëdha nga viti në vit*, por nga vlerësimet dhe analizat që janë bërë, vihet re se ajo ka qenë në përputhje me prioritetet e shprehura në dokumentet strategjike të zhvillimit të vendit. Kështu, sektori “Qeverisja dhe Shteti Ligjor” është mbështetur me rreth 25% të totalit të ndihmës së huaj; dhe “Infrastruktura (Energjia, Transporti dhe Uji) me rreth 32% të ndihmës së huaj. Njëkohësisht, këta sektorë, kanë përfituar edhe kredi në shuma të konsiderueshme jo-koncensionare. Sektorët socialë (duke përfshirë Arsimin dhe Shëndetësinë) janë mbështetur me rreth 19% të ndihmës së huaj dhe zhvillimi ekonomik me rreth 10%.

*Niveli i mbështetjes nga ana e donatorëve nuk ka qenë i njëjtë*, dhe kjo ka bërë të vështirë planifikimin e investimeve nga ana e Qeverisë. Për këtë arsye është i domosdoshëm përmirësimi i orientimit të ndihmës së huaj.

Shqipëria është një nga vendet me rritjen më të shpejtë ekonomike në Europë, megjithëse niveli i të ardhurave për frymë është relativisht i ulët. Rritja e qëndrueshme ekonomike ka ardhur si rezultat i reformave të suksesshme për zhvillimin social dhe institucional si dhe nga niveli i lartë i investimeve, rreth 50% e të cilave janë investime private. *Qeveria po tenton të rrisë më shumë nivelin e kredive tregtare*, por kjo është e kufizuar nga mundësia për të manaxhuar borxhin publik. Ndhma e huaj (sidomos grantet dhe kreditë e buta) ka një avantazh relativ krahasuar me kredinë tregtare, në veçanti për investimet afatgjata dhe për mbështetjen e institucioneve dhe zhvillimit njerëzor të cilat kombinojnë investimin dhe ndihmën teknike.

Duke konsideruar axhendën e integritit europian, me qëllim që të arrihen standardet e BE-së, *është e nevojshme një rritje e vazhdueshme e ndihmës së huaj në vitet në vijim*. Sipas eksperiencës të vendeve të anëtarësimeve të fundit në BE, shkalla e progresit në arritjen e këtyre standardeve në Shqipëri do të varet edhe nga niveli i financimeve të huaja dhe atyre të brendshme.

Bazuar në Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim, *sektorët më prioritarë* ku do të nevojitet vazhdimi i ndihmës së huaj janë:

- **Demokratizimi dhe Shteti Ligjor:** *Forcimit të Institucioneve Demokratike* i është dhënë prioritet i lartë në SKZHI dhe kjo thekson edhe një herë nevojën për t'i përafuar ato më tej me standardet që do të sigurojnë implementimin e *acquis communautaire*. Në vitet e fundit Qeveria ka bërë përpjekje të mëdha për të përmirësuar dhe konsoliduar reformat në këtë sektor. KE, donatorët bilateralë Europianë dhe SHBA kanë luajtur një rol të rëndësishëm në mbështetjen e reformave në këtë sektor. Prioritetet për mbështetje nga ana e donatorëve janë: *rritja e kapacitetit të administratës publike për të implementuar MSA-në; infrastruktura e gjyqësorit; decentralizimi fiskal; regjistri civil; modernizimi i policisë për të forcuar manaxhimin e kufijve dhe lufta kundër krimit të organizuar.*
- Përsa i përket **Zhvillimit Ekonomik** në Shqipëri, në vitet e fundit Qeveria ka pasur në fokus të punës së saj krijimin e një mjedisi të përshtatshëm për të tërhequr sa më shumë investitime private. Shqipëria ka përfituar nga një sasi e konsiderueshme e ndihmës së huaj për zhvillimin ekonomik pasqyruar kjo edhe në dokumentat e programimit të vetë donatorëve. Është e rëndësishme që mbështetja të bëhet në bazë të dokumenteve strategjike kombëtare që reflektojnë normat e BE-së dhe IPA duhet të luajë një rol thelbësor në këtë proces. Prioritetet për mbështetje nga ana e donatorëve janë: *vazhdimësia e mbështetjes për krijimin e një mjedisi të përshtatshëm për investime private; promovimi i zhvillimit të Ndërmarrjeve të Vogla dhe të Mesme, eksporteve dhe investimeve të huaja direkte (IHD); si dhe mbrojtja e konsumatorit.*
- **Infrastruktura Publike** në Shqipëri ka vuajtur nga një mungesë serioze e investimeve dhe neglizhim të mirëmbajtjes. Në infrastrukturë janë orientuar rreth 60% të të gjithë investimeve publike dhe 50% e ndihmës së huaj. Transporti dhe energjia kanë përfituar pjesën më të madhe të fondeve. Mbështetja e donatorëve, veçanërisht nga ata shumëpalesh, është shumë e rëndësishme për zhvillimin e këtij sektori në periudhën afatmesme. Anëtarësimet e fundit në BE japin indikacione mbi tendencën e ardhshme të mbështetjes së donatorëve, që është orientimi kryesisht në sektorin e ujësjellës/kanalizimeve. Disa nga prioritetet për mbështetjen e këtij sektori janë: *përfundimi i rrjetit të rrugëve kombëtare dhe rurale; siguria rrugore; rritja e efikasitetit të energjisë; reforma e menaxhimit të ujësjellësave dhe kanalizimeve, sidomos në nivelet lokale, së bashku me investimet përkatëse në asetet fizike; ngritja e institucioneve efikase mjedisore.*
- **Zhvillimi Social** është përqëndruar në rritjen e kapaciteteve individuale të qytetarëve, duke përfshirë shëndetin dhe arsimimin e tyre, si dhe zgjerimin e mundësive për qytetarët e të gjitha shtresave sociale. Krahasimet ndërkombëtare sugjerojnë se shpenzimet qeveritare në fushën e zhvillimit social në shumicën e vendeve në tranzicion janë nën nivelet e kërkuara. Duke qenë se efienca e menaxhimit në sektor është ende e ulët, ndihma e huaj luan një rol kritik mbështetës. *Banka Botërore parashikohet të vazhdojë rolin e liderit në këtë sektor dhe të zgjerojë eksperiencën me përjashtim me bazë sektori (SWAp) të iniciuara tashme në arsim.*
- **Zhvillimi Territorial** (rajonal, rural dhe lokal, ekonomik dhe bujqësor) është një aspekt i rëndësishëm në arritjen e standardeve europiane. Në Shqipëri ka ende disnivele të konsiderueshme ndërmjet rajoneve, në veçanti zonat rurale janë në situatë të pafavorshme. KE dhe donatorë të tjerë me eksperiencë të ngjashme kanë siguruar ndihmë teknike dhe mbështetje logjistike për ngritjen e kapaciteteve të zbatimit. Prioritetet për mbështetje të sektorit janë: *modernizimi i fermave, mjedisit bujqësor dhe tregjeve rurale; dhe zbatimi i Strategjisë Kombëtare të Zhvillimit Rajonal.*

SKZHI parashikon se brenda pesë viteve të ardhshme, *mund të nevojiten disa rishpërndarje të financimeve sektoriale dhe ndihma e huaj duhet të ndjekë këto tendenca.* Reformat në demokratizimin dhe shtetin ligjor do të vazhdojnë të jenë në fokus të punës së Qeverisë ndërkohë që mbështetja financiare për reformat ekonomike do të vazhdojë të rritet. Mbështetja

për infrastrukturën publike për periudhën afatmesme do të qëndrojë në nivelet aktuale, por një pjesë e mirë e saj do të orientohen drejt investimeve në ujësjellës kanalizime dhe menaxhimin përkatës mjedisor në përputhje me tendencat normale të vendeve kandidate të BE-së. Bazuar edhe në modelet normale të anëtarësimeve në BE, parashikohet që mbështetja për zhvillimin e sektorëve socialë të qëndrojë në nivelet aktuale dhe ajo për zhvillimin rajonal dhe lokal të pësojnë rritje.

Qeveria nëpërmjet zbatimit të Sistemit të Planifikimit të Integruar po harton procedura të përmirësuara për koordinimin dhe menaxhimin e ndihmës së huaj duke e rritur rolin udhëheqës të saj. *Sigurimi i qëndrueshmërisë institucionale* është një nga sfidat më të rëndësishme me të cilat përballet ndihma e huaj dhe kjo kërkon angazhim të vazhdueshëm nga Qeveria dhe mbështetje dhe bashkëpunim nga donatorët. Kurdo që të jetë e mundur, **duhet që të rritet bashkëpunimi i donatorëve me përfaqje sektoriale (Sector Wide Approach) dhe programesh (Programme Based Approach);** përdorimi sa i më gjerë i sistemeve qeveritare si dhe **integrimi i ndihmës së huaj në buxhetin afatmesëm.** Rëndësia e këtij fakti theksohet edhe në raportet e vlerësimit si dhe në Deklaratën e Parisit për rritjen e efektivitetit të ndihmës së huaj. Të gjitha këto do të lehtësonin punën e Qeverisë në programimin dhe orientimin sa me eficient të burimeve të brendshme e të jashtme.

DBSKNH do të përgatisë një raport vjetor progresi për ndihmën e huaj, në dhjetor/janar të çdo viti. Ky raport do të kontribuojë në planifikimin buxhetor afatmesëm dhe do të orientojë donatorët për përqëndrimin e ndihmës së tyre.

# 1. Hyrja

## 1.1 QËLLIMI

Qëllimi kryesor i këtij dokumenti është fuqizimi i rolit kryesues të Qeverisë në procesin e koordinimit të ndihmës së huaj.

Dokumenti synon:

të mbështesë procesin e **orientimit të ndihmës së huaj kundrejt prioritetëve të Qeverisë**, sikurse janë të përcaktuara në SKZHI, dhe në buxhetin vjetor dhe atë afatmesëm (ky orientim do të ndikojë si në balancën e shpërndarjes së ndihmës së huaj midis sektorëve ashtu edhe brenda tyre);

**të mbështesë donatorët në programimin e ndihmës së tyre** dhe në përcaktimin dhe manaxhimin e projekteve; si dhe

të asistojë në procesin e hartimit të buxhetit afatmesëm në mënyrë që të sigurojë koordinimin ndërmjet investimeve të brendshme dhe ndihmës së huaj.

të qartësojë ndikimin e ndihmës së huaj në zhvillimin ekonomik dhe social të vendit tonë si dhe rëndësinë e vazhdimësisë të saj në të ardhmen;

Duke sintetizuar faktet ekzistuese mbi ndikimin e ndihmës së huaj, dokumenti synon të nënvizojë se si mund të përmirësohet ndikimi, efektiviteti dhe efienca e ndihmës së huaj në vitet në vijim.

Krijimi dhe menaxhimi i një baze të dhënash për ndihmën e huaj është një mjet kryesor për të shmangur dublikim të programeve midis donatorëve dhe ministrive. Dokumenti vjetor do të raportojë mbi ecurinë vjetore të ndihmës së huaj si dhe do të ofrojë një motivim për të përditësuar dhe siguruar cilësinë e informacionit, i cili mund të përdoret nga të gjitha palët e interesuara.

## 1.2 METODOLOGJIA DHE STRUKTURA E RAPORTIT

Ky raport është përgatitur nga Departamenti i Bashkërendimit të Strategjive dhe Koordinimit të Ndhmës së Huaj (DBSKNH) në konsultim me ministrinë e linjës dhe donatorët. Procesi filloi me përgatitjen e Formularëve Konsultativë të Ministrive nga DBSKNH, të cilat identifikonin katër informacione kryesore për çdo ministri: (i) prioritetet e SKZHI-së; (ii) financimin e brendshëm aktual; (iii) ndihmën e huaj aktuale; dhe (iv) sugjerime për orientimin e ndihmës së huaj në të ardhmen. Informacioni i marrë nga formularët konsultativë u klasifikua sipas programit të buxhetit për çdo ministri. Formularët konsultativë, së bashku me udhëzimet zyrtare, iu dërguan ministrive të linjës për t'u plotësuar. Informacioni i marrë nga ministrinë përbën thelbin e këtij dokumenti dhe është përmbledhur në kapitullin 3 të tij. Ky kapitull ndiqet nga kapitulli 4, i cili paraqet përfundimet rreth orientimit midis sektorëve.

Analiza e tendencave të kaluara të ndihmës së huaj, e paraqitur në kapitullin 2, është hartuar nga DBSKNH në bashkëpunim të ngushtë me Sekretariatit Teknik të Donatorëve (STD). Kapitulli 5 paraqet orientimin e menaxhimit të ndihmës së huaj në të ardhmen, duke përdorur informacione e marrë nga agjencitë qeveritare dhe donatorët për anketimin e DAC.



### 1.3 SISTEMI I PLANIFIKIMIT TË INTEGRUAR DHE STRATEGJIA KOMBËTARE PËR ZHVILLIM DHE INTEGRIM

Një nga objektivat e Sistemit të Planifikimit të Integruar (SPI) është lidhja e ngushtë midis ndihmës së huaj me prioritetet strategjike dhe procesin e buxhetimit. SPI-ja e cila u adaptua në nëntor 2005 përbën një grup parimesh funksionale për të garantuar që procesi i planifikimit dhe i zbatimit të politikave nga ana e Qeverisë të kryhet në mënyrë koherente, eficiente dhe të integruar. Dy janë proceset më të rëndësishme në këtë sistem:

- **Procesi afatgjatë për planifikimin strategjik, Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim (2007-2013),** e cila përcakton përparësitë dhe synimet strategjike. SKZHI ofron një vizion afatgjatë për zhvillim kombëtar si dhe një horizont afatmesëm për planifikimin e politikave. SKZHI sintetizon strategjitë sektoriale dhe ndërsektoriale afatmesme dhe afatgjata.
- **Procesi buxhetor afatmesëm, i quajtur Programi Buxhetor Afatmesëm,** i cili kërkon që midis muajve mars dhe maj çdo ministri të përgatisë një plan trevjeçar brenda një tavani të përcaktuar shpenzimesh, për të arritur objektivat e politikës, si hapa të ndërmjetshëm për arritjen e synimeve të SKZHI-së. Tavanet buxhetore të vitit të parë të PBA-së shpërndahen me detaje gjatë procesit të hartimit të buxhetit vjetor, që realizohet midis muajve korrik dhe tetor.

Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim dhe Programi Buxhetor Afatmesëm mbështesin plotësisht proceset e mëposhtme të planifikimit:

- **Programin e Qeverisë** i cili u paraqit në parlament në shtator të 2005-ës, në përputhje me detyrimet kushtetuese.
- **Integrimin European dhe në NATO,** veçanërisht zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit (e cila përditësohet çdo vit) dhe Planin e Veprimit të Anëtarësimit në NATO.
- **Menaxhimin e investimeve publike,** i cili - me disa procedura të reja që u zbatuan për herë të parë më 2007-ën - do të bëhet pjesë integrale e PBA-së.
- **Ndihmën e huaj,** veçanërisht përpjekjet e Qeverisë për të optimizuar përdorimin e ndihmës së huaj në përputhje me zotimet e Deklaratës së Parisit për efikasitetin e ndihmës.

Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim zëvendëson Strategjinë Kombëtare për Zhvillimin Ekonomik dhe Social (SKZHES), e cila ishte dokumenti kryesor strategjik i Qeverisë deri në vitin 2006. SKZHI-ja është e lidhur me procesin e rregullt të planifikimit të ministrive, duke përfshirë dhe procesin e PBA-së. Strategjitë sektoriale dhe ndërsektoriale do të jenë dokumenti i referencës për PBA-në. Përgatitja dhe përditësimi i strategjive sektoriale është një nga tiparet kryesore të procesit të SKZHI-së. Megjithëse strategjitë sektoriale do të përditësohen në rast se do të ketë ndryshime të rëndësishme në politikat që ato parashikojnë, SKZHI-ja nuk do të ndryshojë. Megjithatë, një rishikim i procesit të zbatimit të SKZHI-së do të bëhet çdo vit, duke i paraprirë procesit të përgatitjes së PBA-së në mënyrë që të nxirren informacione të mjaftueshme për përcaktimin e taveve buxhetore sektoriale fillestare.

### 1.4 DEKLARATA E PARISIT MBI EFEKTIVITETIN E NDIHMËS SË HUAJ

Për vite me radhë, efektiviteti i ndihmës së huaj ka qenë shqetësim për qeveritë dhe donatorët. Deklarata e Parisit mbi Efektivitetin e Ndhmës së Huaj, e nënshkruar në Mars 2005<sup>1</sup> përfaqëson një angazhim nga të gjithë aktorët për të identifikuar problemet kryesore dhe për të gjetur një zgjidhje permanente për to. Së bashku me 107 shtete dhe 26 organizata ndërkombëtare, Shqipëria ka nënshkruar Deklaratën e Parisit mbi Efektivitetin e Ndhmës së Huaj. Deklarata e Parisit përmban 56 angazhime të cilat janë të lidhura me pesë parime kryesore: 'Pronësia', 'Pozicionimi', 'Harmonizimi', 'Manaxhimi për Rezultate', dhe 'Përgjegjësia e Përbashkët'.

<sup>1</sup> [http://www.oecd.org/document/18/0,3343,en\\_2649\\_15577209\\_35401554\\_1\\_1\\_1\\_1,00.html](http://www.oecd.org/document/18/0,3343,en_2649_15577209_35401554_1_1_1_1,00.html)

Qeveria është e gatshme për të drejtuar menaxhimin me efikasitet të ndihmës së huaj, e cila është thelbësore në arritjen e angazhimeve afatmesme dhe afatgjata të Qeverisë drejt integritimit në strukturat e BE-së dhe NATOs, duke përfshirë përmbushjen e suksesshme të standardeve dhe kriterëve të përcaktuara në MSA dhe në Planin e Veprimit të Anëtarësimit në NATO.

Anketimi i vitit 2006 për Monitorimin e Deklaratës së Parisit (që filloi në Maj 2006 dhe bazohej mbi të dhënat e vitit 2005)<sup>2</sup> vendosi bazën me anë të së cilës do të monitorohen përmirësimet në efektivitetin e ndihmës së huaj. Anketimi i vitit 2006 identifikoi sfidat dhe veprimet prioritare për Qeverinë dhe donatorët në mënyrë që të arrihen objektivat e vendosura për t'u arritur në vitin 2010. Qeveria është e gatshme të kryesojë në arritje të progresit drejt veprimeve prioritare të identifikuar, duke përfshirë kryerjen e Anketimit të Monitorimit të Deklaratës së Parisit për vitin 2008 (e cila do fillojë në tremujorin e parë të 2008 dhe do të përdorë të dhëna nga 2007). Anketimi i 2008 do të identifikojë progresin e arritur që prej vitit 2005 dhe rezultatet e tij do të kontribuojnë në Forumin e Nivelit të Lartë mbi Efektivitetin e Ndhmës së Huaj që do të mbahet në Accra në Shtator 2008.

Deklarata e Parisit udhëhiqet pjesërisht nga monitorimi i treguesve të krahasueshëm të progresit. Informacioni për këta indikatorë është mbledhur nga Qeveria dhe donatorët duke përdorur një metodologji standarde të miratuar. Një pyetësor standard siguron të dhënat për treguesit 3 deri në 10, ndërsa treguesit 1, 2, dhe 11 janë të bazuar në vlerësime cilësore të Bankës Botërore. Koordinatorët Shqiptarë që punuan për Anketimin e vitit 2006 janë përfaqes të DBSKNH dhe Ministrisë së Financave. STD shërbeu si pikë referimi për donatorët dhe koordinoi përgjigjet e tyre. I njëjti proces do të zhvillohet edhe për Anketimin e 2008. Një Plan Veprimi Harmonizimi (PVH) do të hartohet në 2008, me publikimin e raportit përfundimtar të Anketimit të 2008.

Rezultatet kryesore, sfidat, dhe veprimet prioritare të identifikuar mund të përmbliidhen si më poshtë:

- 'Pronësia' - drejtim efikas mbi politikat e zhvillimit dhe strategjitë, dhe koordinim i veprimeve të zhvillimit: Vlerësimi i përgjithshëm ishte "mesatar". Sfidat e identifikuar ishin integritimi i kufizuar i disa strategjive dhe planeve. Veprimet prioritare të identifikuar ishin përfundimi dhe implementimi i SKZHI-së 2007-2013.
- 'Pozicionimi' - donatorët e mbështesin ndihmën e tyre në institucionet, procedurat dhe strategjitë kombëtare të zhvillimit: Vlerësimi rezultoi në një pozicionim relativisht të dobët. Sfidat e identifikuar ishin sistemi i pakoordinuar i raportimit dhe rregjistrimit të ndihmës së huaj. Veprimet prioritare të identifikuar ishin zbatimi i reformave në menaxhimin e financave publike dhe sistemin e prokurimeve.
- 'Harmonizimi' - veprimet dhe aktivitetet e donatorëve janë më të harmonizuara, më transparente dhe më efikase: Vlerësimi tregoi se kishte kufizim në përpjekjet për të përmirësuar harmonizimin dhe se ka mjaft vend për përmirësime. Sfidat e identifikuar ishin përdorimi i kufizuar të përjasjes me bazë programi (PBP) dhe veprimeve prioritare për donatorët - nën drejtimin e qeverisë - për të koordinuar më mirë misionet e donatorëve dhe punën analitike në vend.
- 'Menaxhimi për rezultate dhe përgjegjësia e përbashkët' - donatorët dhe vendet partnere menaxhojnë burimet, përmirësojnë vendimmarrjen, dhe janë përgjegjës për rezultatet e zhvillimit: Vlerësimi rezultoi në pikë të ulta për sistemet e raportimit dhe vlerësimin si dhe ndërgjegjësimin e publikut mbi strategjitë qeveritare. Veprimet prioritare të identifikuar ishin krijimi i një sistemi monitorimi dhe vlerësimi në nivel kombëtar si pjesë e SKZHI-së 2007-2013, si dhe hartimin e një Plani Veprimi Harmonizimi, i cili do të përfshijë angazhimet dhe veprimet e donatorëve dhe të Qeverisë.

<sup>2</sup> Anketimi i vitit 2006 për Monitorimin e Deklaratës së Parisit - Shqipëria, Volumi 2 (Kapitujt e Vendeve të ndryshme), OECD/DAC 2007 ([www.oecd.org/dac/effectiveness/monitoring](http://www.oecd.org/dac/effectiveness/monitoring))

## 2. Tendencat aktuale të ndihmës së huaj

Ky kapitull paraqet tendencat aktuale të ndihmës së huaj bazuar në të dhënat e mëposhtëme.

- Të dhënat për granted dhe kreditë koncensionare deri në vitin 2005. Të dhënat janë marrë nga baza e të dhënave të Organizatës për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik (OECD)/Komiteti i Asistencës së Zhvillimit (DAC) për vitet deri në 2005, i cili është viti i fundit për të cilin janë publikuar të dhënat zyrtare. Këto të dhëna janë klasifikuar si Ndhmë Zyrtare për Zhvillim (ODA)<sup>3</sup>, dhe përkojnë me të dhënat e dokumentit të Deklaratës së Parisit dhe me raportimet e tjera ndërkombëtare mbi ndihmën e huaj. Të dhënat janë për disbursimet dhe bazohen në informacionin zyrtar vjetor që donatorët raportojnë në OECD/DAC.
- Ndihma e huaj pas vitit 2005. Burimi i dytë kryesor i informacionit është baza e të dhënave zyrtare të donatorëve, i cili është mirëmbajtur nga STD dhe kohët e fundit po menaxhohet plotësisht nga DBSKNH. Parashikimet për ndihmën e huaj për vitin 2006 dhe 2007 janë bazuar në bazën e të dhënave të donatorëve duke supozuar se disbursimet bëhen në shuma të barabarta gjatë ciklit të projektit. Baza e të dhënave synon të përfshijë të gjithë projektet në vazhdim, të gjitha projektet e planifikuara si edhe ato projekte që kanë përfunduar kohët e fundit.
- Kreditë jo koncensionare. ODA përfshin vetëm kreditë me një element granti mbi 25%, dhe nuk përfshin kreditë të cilat jepen me terma më tregtarë. Burimet kryesore të ndihmës së huaj jo-koncensionare janë Banka Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH), Banka Europiane e Investimeve (BEI) dhe Banka e Zhvillimit të Këshillit të Europës (CEB). Analiza e bazës së të dhënave të borxhit në MF tregon se disa nga donatorët dypalësh japin edhe kredi në terma jo-koncensionare. DAC raporton vlerën totale të ndihmës<sup>4</sup> jo-koncensionare deri në 2005 dhe këto të dhëna janë përdorur në këtë dokument. Për të pasqyruar nivelin e kredive jo-koncensionare pas vitit 2005 janë përdorur të dhënat e marra nga baza e të dhënave të donatorëve. Gjithashtu, ndarja sektoriale e kredive jo-koncensionare është marrë nga baza e të dhënave të donatorëve.


### 2.1 TENDENCAT E PËRGJITHSHME TË NDIHMËS SË HUAJ

Ndihma e huaj gjatë periudhës 1990 - 2007 ka arritur vlerën prej rreth 5.3 bilion euro, nga të cilat 67% është dhënë në formë grantesh, 24% kredi koncensionare dhe 13% kredi jo-koncensionare. Ndihma e huaj në Shqipëri ka filluar në 1990 duke u rritur me shpejtësi, deri në mes të viteve 1990, kur shënon rënie. Rritja e theksuar e ndihmës së huaj në 1999 ishte rezultat i krizës së Kosovës dhe asistenca ishte kryesisht në formën e ndihmës emergjente. Që nga viti 2000, ndihma e huaj ka qenë në nivele të qëndrueshme duke variuar në vlerat 300 - 350 milion euro në vit. Në katër vitet e fundit, rritja në nivelin e kredive jo-koncensionare ka kompensuar rënien e qëndrueshme në nivelin e granteve dhe kredive koncensionare.

<sup>3</sup> Të dhënat mbi ndihmën e huaj për vitet 1990 - 2005 të paraqitura në këtë kapitull i referohen disburimeve neto të ODA, dhe jo atyre koncensionare, nga baza e të dhënave të OECD/DAC mbi agregatet vjetore të ODA. ODA është përkufizuar si grante ose kredi të cilat: (a) ndërmerren nga sektori zyrtar; (b) kanë si objektiv kryesor promovimin e zhvillimit ekonomik dhe mirëqenies; (c) janë me terma financiare koncensionare (nëse është kredi, duhet të ketë një element granti për të paktën 25%) (OECD/DAC 2007). ODA raportohet çdo vit nga të gjithë donatorët e vendeve të DAC. Të dhënat e DAC raportohen në USD dhe janë të konvertuara në EURO me kursin e këmbimit të vitit. Këto të dhëna mund të ndryshojnë me ato të bazës së të dhënave të donatorëve dhe nga ato të raportuara nga donatorët në anketimin e 2006.

<sup>4</sup> Pjesa më e madhe e ndihmës jo-koncensionare e raportuar nga DAC është në kredi, ndonëse ka edhe forma të tjera, si p.sh. kreditë e eksportit.

Figura 2.1 Ndhimja e huaj totale, grante dhe kredi 1990-2007 (€ milion)



Burimi: OECD/DAC për 2000-05; Parashikimet më të mira të Qeverisë për 2006 dhe 2007 nga baza e të dhënave të donatorëve.

Në krahasim me vendet fqinje me të njëjtin nivel të ardhurash, Shqipëria ka përfutur nivele më të ulëta për frymë të ndihmës së huaj gjatë periudhës 2000 - 2005<sup>5</sup>.

Tabela 2.2 Ndhimja e huaj dhe PBB për frymë në vit, mesatare për 2000-05

	Ndhimja e huaj për frymë (€)	Popullata (milion)
Shqipëria	109	3
Bosnje-Hercegovina	171	4
Maqedonia	136	2
Serbia	177	8


Burimi: OECD/DAC (2007) dhe Treguesit e Zhvillimit Botëro (ËDI) (2007)

## 2.2 NDIHMA E HUAJ DHE EKONOMIA

Që nga viti 2000, raporti i ndihmës së huaj me produktin e brendshëm bruto (PBB) ka pësuar rënie. Kjo ka ardhur kryesisht si rezultat i rritjes së PBB (e cila mesatarisht ka qenë rreth 6% që prej vitit 2000), sesa i uljes së nivelit të ndihmës së huaj. Në vitin 2007, raporti i parashikuar i ndihmës së huaj me PBB ishte 4.5 %.

<sup>5</sup> Të gjithë këto vende klasifikohen si shtete me të ardhura të ulëta dhe të mesme (LMIC) (OECD/DAC, 2007).


**Figura 2.2 Ndhimja e huaj si pjesë e PBB-së, 2000-07 (%)**



Burimi: OECD/DAC (2007); Parashikimi më i mirë i Qeverisë për 2006 dhe 2007 marrë nga baza e të dhënave të donatorëve.

Të ardhurat nga burimet e jashtme, si remitancat, fitimet nga eksporti, dhe IHD janë burim i rëndësishëm i investimeve dhe konsumit. Niveli i remitancave dhe eksporteve janë rritur ndjeshëm që nga mesi i viteve 1990. Prandaj, rëndësia relative e ndihmës së huaj përkundëjt të ardhurave të tjera nga burime të jashtme ka pësuar rënie. Në vitin 2007, raporti i eksporteve kundëjt PBB-në ishte 24%, e ndjekur nga remitancat me 14%, ndihma e huaj me 4.5%, dhe IHD me 3%.

**Figura 2.3 Ndhimja e huaj, eksportet, remitancat dhe IHD, 1990-2007 (€ milion)**




Burimi: OECD/DAC (2007); Parashikimet më të mira të Qeverisë për 2006 dhe 2007 të marra nga baza e të dhënave të donatorëve; Banka e Shqipërisë (2007)

## 2.3 PËRBËRJA E NDIHMËS SË HUAJ

### Sipas Llojit

Gjatë periudhës 2000 - 2007, 48% e totalit të ndihmës së huaj ishte në formën e granteve dypalëshe, e ndjekur nga kreditë shumëpalëshe (22%), grantet shumëpalëshe (19%), kreditë jo-koncensionare (19%) dhe kreditë dypalëshe (11%). Grantet dypalëshe kanë qenë të ndryshueshme dhe kanë qenë më të ulëta në katër vitet e fundit. Rënia e nivelit të granteve dypalëshe është kompensuar përafërsisht nga rritja e nivelit të kredive koncensionare dypalëshe, duke e bërë mbështetjen e përgjithshme të partnerëve dypalësh relativisht të qëndrueshme. Grantet shumëpalëshe dhe kreditë koncensionare kanë qenë të ndryshueshme, dhe aktualisht janë nën nivelet e vitit 2000. Kjo rënie është kompensuar nga rritja e nivelit të kredive jo-koncensionare, të cilat kryesisht ofrohen nga donatorët shumëpalësh.

Figura 2.4. Grante dhe Kredi dypalëshe dhe shumëpalëshe, 2000-2007 (€ milion)



Burimi: OECD/DAC për 2000-05; Parashikimi më i mirë i Qeverisë për 2006 dhe 2007 marrë nga baza e të dhënave të donatorëve.


Burimi më i madh për kreditë jo-koncensionare është BERZH-i, i cili ka një portofol prej rreth 780 milion euro, kryesisht në sektorin energjitik dhe transport. BEI ka një total projektsh të miratuara prej rreth 270 milion euro, gjithashtu për sektorin energjitik dhe transportin, por duke përfshirë edhe sektorin e ujit, dhe kohët e fundit edhe arsimin. CEB ka një total projektsh të miratuara prej rreth 52 milion euro dhe mbështet shëndetësinë, arsimin dhe strehimin social. Së fundi, IFC, 'dritarja' e BB për mbështetjen e sektorit privat, ka ndërmarrë projekte me një kosto totale prej rreth 260 milion euro, kryesisht në fushat e informacionit financiar dhe prodhimit<sup>6</sup>. Ndhima e dhënë nga këto banka konsiderohet e rëndësishme për Qeverinë për shkak të aftësisë së tyre për të mbështetur investimet afatgjata si dhe për bashkëpunimin me donatorët dypalësh dhe shumëpalësh, banka të tjera tregtare dhe me sektorin privat. Sipas statistikave të DAC, në periudhën 2000 - 2005 ndihma për zhvillim përbënte 67% të totalit të ndihmës, asistenca teknike 28% dhe emergjencat dhe ndihma ushqimore 5%.

<sup>6</sup> Analiza e veprimeve të institucioneve të huaja është bazuar në bazën e të dhënave të donatorëve, dhe është kontrolluar kundrejt: listës së plotë të projekteve të BERZH; listës së plotë të projekteve të BEI-t në Shqipëri; Raportit Vjetor 2006 të CEB dhe projekteve të miratuara në 2006; raportimit të IFC për projektet e saj. Të gjitha këto të dhëna gjenden në faqet përkatëse të internetit; dhe bazën e të dhënave të kredive të MF.

## Sipas donatorëve

Katër donatorët më të mëdhenj dypalësh kanë qenë Gjermania, Greqia, Italia, dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës, të cilët kanë ofruar 33% të totalit të ndihmës së huaj për periudhën 2000-2005. Dy donatorët më të mëdhenj shumëpalësh kanë qenë KE dhe BB/IDA<sup>7</sup> të cilët kanë ofruar 32% të totalit të ndihmës së huaj (Tabela A1.1 paraqet ndihmën e huaj të ofruar nga të gjithë donatorët për periudhën 2000 - 2005).

Figura 2.5 Ndhma e huaj sipas donatorëve, 2000-05 (%)



Burimi: OECD/DAC (2007); për BERZH/BEI/CEB dhe kredi të tjera jo-koncionare të dhënat janë marrë nga baza e të dhënave të donatorëve

Nivelet e ndihmës së huaj të ofruar nga KE, Gjermania dhe Greqia u rritën gjatë periudhës 2000 - 2005. Ndhma e huaj e ofruar nga BB/IDA u zvogëlua për arsye të afrimit të afatit për kalimin e statusit të BB nga ai i IDA në atë të IBRD. Ndhma e huaj e ofruar nga SHBA ka qëndruar në të njëjtin nivel gjatë kësaj periudhe. Midis gjashtë donatorëve kryesorë, KE ofron nivelin më të lartë të madh të granteve (34%), i ndjekur nga SHBA (29%) dhe Greqia (18%). BB ofron rreth 75% të totalit të kredive të buta duke qenë huadhënësi më i madh, e ndjekur nga Gjermania (10%) dhe Italia (9%).

## Sipas sektorëve

Shpërndarja e ndihmës së huaj nëpër sektorë për periudhën 2000 - 2007 ka ndryshuar gjerësisht nga viti në vit, por pa pasur një tendencë të qartë.

Tabela 2.3 Përqëndrimi i ndihmës së huaj sipas sektorëve, 2000-2007 (€ milion)

Total	2000	2001	2002	2003	2004	2005	2006	2007	Total
Demokratizimi dhe Shteti i së Drejtës	85	61	49	67	64	89	46	63	524
Zhvillimi Ekonomik	40	42	49	22	23	31	66	69	342
Transporti	16	16	26	32	21	16	32	42	201
Energjia	33	51	83	61	95	90	104	106	623
Uji	99	53	22	37	47	54	35	23	370
Zhvillimi Social	67	47	37	102	46	46	34	44	423
Të tjerë	38	47	59	15	16	25	14	19	233
Total	378	318	325	336	312	351	331	364	2715

Shënim (1): në terminologjinë e DAC, "zhvillimi ekonomik" përfshin bujqësinë, industrinë, tregtinë, biznesin/bankat/financën, dhe turizmin.

<sup>7</sup> BB/IDA i referohet huadhënies nga Organizata Ndërkombëtare e Zhvillimit (IDA).

Shënim (2): të dhënat përfshijnë kreditë jo-koncensionare, të cilat për vitet 2006-07 bazohen në bazën e të dhënave të donatorëve dhe për 2000-05 në totalin e DAC, të shpërndara sipas sektorëve të bazës së të dhënave të donatorëve. Shënim (3): të dhënat e DAC për 2001 për sektorët nuk janë të njëjta me të dhënat e DAC të analizuar sipas donatorëve. Kjo është zgjidhur duke përdorur totalin e analizës sipas donatorëve dhe shpërndarjen e këtij totali nëpër sektorë sipas rregullit të mesatares për vitet 2000 dhe 2002. Burimi: OECD/DAC (2007); parashikimi më i mirë i Qeverisë për 2006 dhe 2007 marrë nga baza e të dhënave të donatorëve.


Një pjesë e madhe e ndihmës përqëndrohet në qeverisje, duke përfshirë demokratizimin dhe shtetin e së drejtës. Zhvillimi ekonomik, duke përfshirë bujqësinë, industrinë, tregtinë, biznesin/financën, dhe turizmin, është rritur me hapa të shpejtë gjatë dy viteve të fundit, gjë që mund të shpjegohet nga përqëndrimi aktual i disa donatorëve në këtë fushë. Sektorët socialë kanë qenë shumë të mbështetur në të kaluarën, por të dhënat tregojnë se ndihma e huaj e alokuar në këta sektorë ka pësuar rënie vitet e fundit.

Mbeshtja për infrastrukturën ka qëndruar konstante në total (përveç në 2001), por ka pasur luhatje të mëdha midis transportit, energjisë dhe ujit. Mbi 85% të kredive jo-koncensionare janë përdorur për infrastrukturën. Rritja e nivelit të kredive jo-koncensionare do të thotë që mbi 50% e ndihmës së huaj për infrastrukturën aktualisht vjen nga kreditë koncensionare, ku pjesa më e madhe i shkon sektorit energjistik.

## Sipas statusit

Baza e të dhënave të donatorëve synon të përfshijë projekte që janë në zbatim ose të planifikuara me angazhime konkrete. Gjithashtu, ajo përfshin një pjesë të konsiderueshme të projekteve të përfunduara dhe disa shënime në lidhje me programimin e ardhshëm. Figura e mëposhtme paraqet një vlerë të përafërt të disbursimeve të pritshme të projekteve, duke supozuar se disbursimet janë të barabarta gjatë viteve të planifikuara të zbatimit të projektit. Grafiku tregon se angazhimet e projekteve në vazhdim priten të bien me nivele të njëjta gjatë katër viteve, ndërsa projektet e planifikuara do të shpenzohen plotësisht deri në vitin 2010 ndërkohe që zbatimi i tyre do të vazhdojë edhe në vitin 2011. Niveli i financimeve indikative do të rritet deri në 2011.

Figura 2.6 Ndhma e huaj sipas statusit, 2000-11 (€ milion)



Burimi: baza e të dhënave të donatorëve.



## 2.4 INVESTIMET PUBLIKE SIPAS FINANCIMIT TË BRENDSHËM DHE TË HUAJ

Tabela 2.4 paraqet nivelin e ndihmës së huaj dhe investimeve të brendshme për sektorë të ndryshëm. Në vitin 2007, fondet e brendshme përbënin 42% të investimeve publike. Sektorët në të cilët pjesa e financimit të brendshëm është më e ulët se mesatarja prej 42% e investimeve publike janë:

- Rendi publik, ku policia po adopton praktikat dhe standardet ndërkombëtare
- Zhvillimi ekonomik, ku eksperiencia e mbështetjes së reformës institucionale dhe zhvillimit të sektorit privat me financim të brendshëm është akoma në fillimet e saj
- Energjia, ku ka nevojë për financim tregtar (ndonëse të dhënat e mësipërme nuk përfshijnë kredinë e konsiderueshme tregtare të brendshme që KESH merr për investime)
- Mjedisi, ku është nevojë urgjente ngritja e institucioneve dhe praktikave të reja
- Punësimi dhe politika sociale, në të cilat fondet e Qeverisë janë të përqëndruara në kostot korente dhe është e nevojshme eksperiencia ndërkombëtare për struktura të reja institucionale dhe fizike

**Table 2.3 Investimet Publike sipas sektorëve dhe burimit të financimit, 2007**

	Financime të brendshme Lek milion	Financime të brendshme € milion	Financime të huaja € milion	Financime të brendshme si pjesë e totalit (%)
Drejtësia	750	6.3	12.5	33%
Rendi Publik	445	3.7	16.0	19%
Arsimi	4,850	40.4	21.5	65%
Shëndetësia	3,929	32.7	20.0	62%
Punësimi	150	1.3	4.4	22%
Energjia	23	0.2	105.6	0%
Ujësjetës Kanalizime	3,122	26.0	22.9	53%
Transporti	14,467	120.6	41.7	74%
Zhvillimi Ekonomik	381	3.2	9.3	25%
Bujqësia	1,159	9.7	22.6	30%
Mjedisi	421	3.5	20.5	15%
Të tjera	1,996	16.6	67.4	20%
Total	31,693	264.1	364.5	42%

Shënim (1): investimet e brendshme janë marrë nga buxheti i vitit 2007 (MF); investimet e huaja janë të marra nga baza e të dhënave të donatorëve, duke supozuar se disbursimi ndodh në vlera të barabarta gjatë jetës së projektit.

Shënim (2): të dhënat e ulëta të investimeve publike të brendshme për energjinë shpjegohen me faktin se buxheti nuk financon investimet e KESH.

Burimi: baza e të dhënave të donatorëve e mbajtur nga Qeveria; buxheti i vitit 2007 (MF).

Përqëndrimi relativisht i lartë i ndihmës së huaj në sektorët e mësipërm do të vazhdojë të jetë i justifikuar edhe për disa vite. Megjithatë, do të ketë një tendencë të uljes së diferencave midis sektorëve. Disa prej sektorëve përfitojnë një nivel të lartë të ndihmës së huaj për shkak se kanë nevojë për ndihmë teknike të konsiderueshme përveç nevojës për investime. Gjithashtu, disa nga kreditë më të mëdha gjysëm tregtare, kryesisht për sektorin energjistik, do të shndërrohen në kredi plotësisht tregtare, duke ndjekur tendencat e filluara me kalimin e Shqipërisë nga statusi IDA dhe përdorimi i kredive të ofruara nga donatorët dypalësh.

### 3. Orientimi i ndihmës së huaj brenda sektorëve

Ky kapitull prezanton rolin e ndihmës së huaj në sektorët kryesore dhe mënyrën se si ajo mbështet strategjitë sektoriale. Në këtë kapitull përdoren po ato emërtime sektorësh sikurse në SKZHI si dhe janë adoptuar pesë fushat kryesore të SKZHI-së, të cilat janë gjithashtu në përputhje me strukturat e përdorura aktualisht në vendet europiane. Në secilin prej sektorëve, prioritetet e SKZHI-së bëjnë të mundur orientimin e ndihmës së huaj brenda sektorëve. Teksti përshkruan elementët kryesorë të ndihmës së huaj aktuale për çdo sektor, duke u përqëndruar kryesisht në programe më të rëndësishme si edhe në pesë fushat kryesore të SKZHI-së. Kjo paraqitje e ndihmës së huaj nuk synon të japë detaje mbi të gjithë projektet e donatorëve.

Në fund të përshkrimit për secilin sektor jepen një numër i caktuar prioritetesh afatmesme për financim nga donatorët. Këto prioritete janë përzgjedhur në bashkëpunim me ministritë e linjës dhe bazohen në boshllëqet aktuale si dhe avantazhin e krahasur të donatorëve në arritjen e prioritetëve të SKZHI-së. Ky orientim mbështetet gjithashtu dhe nga lista e projekteve prioritare të paraqitur në kapitullin 4.

DONH ka të njëjtin këndvështrim mbi afatin kohor sikurse SKZHI-ja: Fokusi afatmesëm është për periudhën 2007-2010, fokus i cili do të influencohet nga vendimet për financim që merren në vitin pasardhës. Megjithatë, DONH dhe SKZHI kanë për qëllim të influencojnë edhe në programet më afatgjata për vitet 2011-2013. Orientimi i ndihmës së huaj merr në konsideratë nevojën për të siguruar mbështetje në ata sektorë të cilët do të përfitojnë financim në rritje gjatë periudhës 2011-2013.

Aty ku ekziston mundësia ndihma e huaj duhet të jetë e lidhur me programet buxhetore në mënyrë që në të ardhmen të lehtësohet integrimi me buxhetin. Tabela 3.1 paraqet institucionin përgjegjës për sektorët kryesorë të SKZHI-së si dhe përmbledh financimin e brendshëm dhe të huaj për secilin sektor. Në disa raste, prioritetet e SKZHI-së dhe investimet publike nuk mund të përshtatet me një program të caktuar buxheti. Ky fenomen ndodh sidomos me strategjitë dhe projektet ndërsektoriale por edhe me disa prej strategjive sektoriale si dhe me përqsjet me bazë sektori. (SWAp) (referoju kapitullit 5). Qeveria i përdor strategjitë ndërsektoriale si një mjet për të paraqitur iniciativat e reja si dhe për të përmirësuar aktivitetet e programeve ekzistuese. Në këtë dokument është supozuar që prioritetet dhe projektet ndërsektoriale janë nën programet buxhetore të ministrive kryesuese të linjës.

**Tabela 3.1 Investimet Kombëtare dhe të Huaja, sipas sektorëve (në milion euro)**

Strategjia SKZHI	Institucioni kryesues për buxhetin	Totali i Investimeve Publike Mesatare 07-10 <sup>1</sup>	Investimet e Huaja në Vazhdim 2008 <sup>2</sup>	Investimet e Huaja të planifikuara të njohura 2011 <sup>3</sup>
<b>Demokratizimi dhe Shteti i së Drejtës</b>		<b>36.5</b>	<b>24.4</b>	<b>18.5</b>
Administrata Publike	MB	0.1	0.1	0.0
Decentralizimi	MB - 01660	2.5	2.4	4.2
Statistika	INSTAT	0.0	0.0	0.0
Drejtësia	MD – të gjithë departamentet	13.6	6.8	7.5
E drejta e pronës		0.0	0.0	0.0
Rendi Publik	MB – kryesisht 03140	20.4	15.1	6.8
<b>Zhvillimi Ekonomik</b>		<b>38.4</b>	<b>31.8</b>	<b>16.6</b>
Ekonomia dhe Tregu	METE – të gjithë përveç 04320	24.8	20.8	14.1
Financat Publike	MF – të gjithë	13.6	11.0	2.5
<b>Infrastruktura</b>		<b>473.0</b>	<b>280.8</b>	<b>69.0</b>
Transporti	MPPTT - 04520-60	214.3	51.3	24.4
Energjia	METE – 04320	165.7	165.6	8.1

Uji	MPPTT – 06370	67.5	41.4	25.8
Mjedisi	MMPAU – të gjithë departamentet	25.5	22.5	10.8
Komunikimi		0.0	0.0	0.0
<b>Zhvillimi Social</b>		<b>111.8</b>	<b>43.7</b>	<b>4.3</b>
Shëndetësia	MSH - të gjithë departamentet	48.0	24.7	2.3
Arsimi	MASH - të gjithë departamentet	49.8	6.5	0.8
Punësimi	MPÇSSHB – 10550/04170	3.1	2.2	0.5
Gjinia	MPÇSSHB – 10460/10430	0.6	0.6	0.0
Mbrojtja Sociale	MPÇSSHB – 10430	3.0	5.3	0.0
Përfshirja Sociale	MPÇSSHB – 10430		4.4	0.7
<b>Zhvillimi Territorial</b>		<b>51.0</b>	<b>26.9</b>	<b>16.4</b>
Bujqësia	MBUMK- të gjithë përveç 04280	16.6	9.6	11.0
Rural	MBUMK - 04280 & ADF	5.2	1.9	0.0
Zhvillimi Rajonal		0.9	0.8	3.1
Turizmi, Kultura dhe Rinia	MTKRS - të gjithë departamentet	7.8	1.2	0.6
Planifikimi Urban dhe Hapsinor	MPPTT - 06180/01310	20.5	13.3	1.7
<b>Të tjera</b>		<b>64.4</b>	<b>1.3</b>	<b>0.1</b>
<b>Total</b>		<b>775.2</b>	<b>408.9</b>	<b>124.8</b>

1. Institucioni kryesues për buxhetin përfshin institucionin buxhetor, si dhe kodin për departamentin përkatës, në ato raste është i identifikueshëm

2. Totali i investimeve publike përfshin të gjitha investimet e buxhetit si dhe vlerën e përafërt të disbursimeve të projekteve të donatorëve në vazhdim, të cilat nuk janë të përfshira në buxhet, të të marra nga baza e të dhënave të donatorëve. Ndhima e huaj në vazhdim dhe ajo e planifikuar janë marrë nga baza e të dhënave të donatorëve duke supozuar që vlera totale e çdo projekti është e ndarë në disbursime të barabarta vjetore, gjatë gjithë jetës së projektit.

3. Të dhënat për ndihmën e huaj të planifikuar për vitin 2011 janë llogaritur nga baza e të dhënave të donatorëve dhe përfshijnë të gjithë projektet në vazhdim dhe ato të programuara, të cilat priten të përfundojnë gjatë vitit 2011 ose më pas, duke supozuar që vlera totale e çdo projekti është e ndarë në disbursime të barabarta vjetore, gjatë gjithë jetës së projektit. Ky është një tregues i programimeve për të cilat kemi dijeni dhe jo një vlerë e përafërt e ndihmës në të ardhmen.

Burimet: shifrat e buxhetit janë marrë nga buxheti duke përjashtuar financimet e huaja; projektet e donatorëve në vazhdim dhe të planifikuara janë marrë nga baza e të dhënave të donatorëve.

Shumë donatorë mbështesin shoqërinë civile dhe OJF-të. Ky dokument përfshin vetëm ndihmën e cila është raportuar zyrtarisht nga donatorët, por e zbatuar nga OJF-të. Gjithsesi, ekziston një numër i madh projektesh, të vogla në përgjithësi, të cilat sigurojnë mbështetje financiare direkte të OJF-ve (ndërkombëtare dhe kombëtare) dhe të departamenteve të administratës vendore, të cilat nuk janë të raportuara në Qeveri ose nuk janë të përfshira në bazën e të dhënave të donatorëve.

### 3.1 DEMOKRATIZIMI DHE SHTETI I SË DREJTËS

Përforcimi i demokracisë moderne i mbështetur nga shteti i së drejtës është një nga pesë fushat prioritare të SKZHI-së. Progres i madh është bërë në këtë drejtim që nga viti 1990 dhe Qeveria është e vendosur ta përshpejtojë këtë proces. Progres i mëtjeshëm duhet bërë në sistemin zgjedhor, administratën publike, decentralizimin, statistikat, anti-korrupsionin, drejtësinë, të drejtën mbi pronën; rendin publik; dhe në veçanti luftën kundër krimit të organizuar dhe menaxhimit të kufijve.

Financimi i brendshëm në investime ka rezultuar më i lartë në sektorët e drejtësisë dhe rendit publik. Ndhima e huaj aktualisht përbën rreth 80% të financimit total dhe investimet në administratën publike, qeverisjen lokale dhe rendin publik përbëjnë më tepër se 85% të saj. Një pjesë e ndihmës së huaj ka shkuar për elementë të zgjedhjeve dhe parlamenti kryesisht nga OSBE dhe Holanda. Planifikimi aktual i ndihmës së huaj që shkon për sektorët e administratës publike dhe shtetit të së drejtës është në përputhje me prioritetet e Qeverisë. Planifikimi afatgjatë kërkon shtimin e kësaj ndihme kryesisht në mbështetje sektorëve të drejtësisë dhe rendit publik, me nevojë të përkohshme për mbështetjen e rregjistrimit civil.

## Administrata publike dhe decentralizimi

### Administrata publike

Reforma e Administratës publike mbetet një ndër prioritetet kryesore të Qeverisë dhe është mbështetur në mënyrë të konsiderueshme dhe të vazhdueshme nga donatorët gjatë dekadës së kaluar. SKZHI thekson se pranimi i Shqipërisë në BE kërko që të arrihen standartet e kapaciteteve menaxhuese të institucioneve dhe sistemeve administrative. kjo do të bëjë të mundur zbatimin efektiv të *acquis communautaire* si dhe angazhimeve të axhendës për zhvillim. SKZHI gjithashtu thekson se forcimi i mëtejshëm i kapaciteteve institucionale për zbatimin e MSA-së, koordinimin dhe planifikimin strategjik, si dhe prezantimi i një menaxhimi të orientuar në rezultate mbeten sfidat kryesore të Qeverisë.

Strategjia e plotë e reformës së administratës publike është ende duke u hartuar. Koordinimi i këtij procesi nga Qeveria bëhet nga Departamenti i Administratës Publike (DAP) i cili është nën vartësinë e Ministrisë së Brendshme. Instituti për Trajnime të Administratës Publike (ITAP) siguron trajnime në shkallë të gjerë për nëpunësit e shërbimit civil shqiptar.

Mbështetja për reformën e administratës ka qenë objektivi për një numër të madh donatorësh, të cilët kanë dhënë rreth 30 milion euro nëpërmjet 22 projekteve të përfunduara dhe në vazhdim. Aktorët kryesorë në mbështetje të reformës së administratës publike gjatë viteve të fundit kanë qenë Komisioni Europian me projektin CARDS , të cilët kanë dhënë mbështetje për DAP-in si dhe në zbatimin e ligjit për shërbimin civil (bashkë me BB); Komisionin e Shërbimit Civil dhe ITAP-in. BB ka mbështetur gjithashtu koordinimin e politikave të administratës publike në Këshillin e Ministrave, ndërsa Qeveria Britanike nëpërmjet DfID, PNUD-i, Holanda, Zvicra dhe Spanja mbështesin planifikimin strategjik, forcimin e menaxhimit të shpenzimeve publike dhe koordinimin e ndihmës së huaj.

Një fond mirëbësimi prej 7 milion \$ me kontributin e gjashtë donatorëve dhe i menaxhuar nga BB, do të sigurojë mbështetje për Këshillin e Ministrave (KM), dhe për të gjitha ministrinë në forcimin e kapaciteteve të tyre qeverisëse për zbatimin e komponentëve të caktuar të SPI-së. Fokusi kryesor është mbi forcimin e kapaciteteve për koordinimin, zbatimin dhe monitorimin e strategjisë, menaxhimin e shpenzimeve dhe atë të ndihmës së huaj. IPA ka parashikuar mbështetje financiare për tre vitet në vijim, kryesisht për mbështetjen e mirë qeverisjes dhe forcimin e kapaciteteve që merren me integrimin europian dhe përafrimin e legjislatcionit.

Mbështetja e mëtejshme e donatorëve përsa i përket forcimit të qeverisjes dhe administratës publike për periudhën afatmesme duhet të fokusohet kryesisht në këto çështje:

- përmirësimin e koordinimit të integritit Europian në të gjithë instancat qeveritare si dhe forcimin e kapaciteteve për të zbatuar MSA-së dhe angazhimet e Marrëveshjes së Përkohshme
- forcimin e DAP-it dhe ITAP-it
- forcimi i zbatimit të Ligjit të Shërbimit Civil dhe procedurave përkatëse
- zbatimin e komponentëve të ndryshëm të SPI-së
- zbatimin efektiv dhe monitorimin e SKZHI-së
- krijimin e sistemit modern të menaxhimit të burimeve njerëzore
- mbështetje për krijimin e një sistemi menaxhimi dhe performance të bazuar në rezultate.

### Decentralizimi

Shqipëria është duke zbatuar strategjinë kombëtare për decentralizimin dhe autonominë e pushtetit lokal dhe ka bërë një progres të dukshëm në procesin e decentralizimit ndërsa synon të veprojë në përputhje me parimin e Kartës të Këshillit të Europës mbi vetëqeverisjen e pushtetit

lokal. Sfidat kryesore për procesin e decentralizimit sikurse identifikohen në SKZHI mbeten: forcimi i kuadrit ligjor dhe rregullator me qëllim që të forcohet autonomia dhe autoriteti i pushtetit lokal; decentralizimi fiskal; forcimi i kapaciteteve të personelit të qeverisjes lokale dhe të Këshillave Rajonalë; transferimi i shërbimeve publike dhe pronave publike tek pushteti vendor. Decentralizimi i suksesshëm do të bëjë të mundur që Shqipëria të zbatojë programin e zhvillimit territorial, i cili do të përfitojë një pjesë të konsiderueshme të ndihmës së huaj.

Banka Botërore dhe SHBA kanë mbështetur forcimin e strukturës ligjore, financimin e pushtetit lokal, ligjin për planifikimin hapësinor dhe zhvillimin ekonomik lokal. Projekti i KE-së CARDS do të mbështesë decentralizimin fiskal (projekti nuk ka filluar ende); Suedia po mbështet zhvillimin e strukturave ligjore për statusin e personelit të qeverisjes lokale dhe kthimin e tyre në personel të shërbimit civil. Italia po mbështet projektin 'ARTGOLD' të zhvillimit lokal, të zbatuar nga PNUD, dhe shumë rajone italiane mbështesin autoritetet lokale shqiptare. Holanda ka disa projekte në mbështetje të mirëqeverisjes në rajone të ndryshme. Decentralizimi i shërbimeve sociale financohet nga BB dhe projekti për Shërbimet Sociale të DIFID-it. Autonomia e shkollave financohet përmes projektit Cilësi dhe Barazi në Arsim, i cili financohet bashkarisht nga BB, BEI dhe CEB, program ky me përqsje në bazë sektori (SWAp). Njëkohësisht SHBA mbështet decentralizimin e shërbimit shëndetësor parësor. Programi i PNUD-it për qeverisjen lokale dhe donatorë të tjerë dypalësh kanë mbështetur aspekte të tjera të funksionimit të këshillave rajonal dhe forcimit të kapaciteteve për planifikimin strategjik. Kohët e fundit, BB ka mbështetur pjesë të procesit të transferimit të pronave publike. Projekti i BB për Menaxhimin dhe Administrimin e Tokës mbështet ngritjen e kapaciteteve të disa bashkive të përzgjedhura për të marrë përsipër funksionet e reja të transferuara. Decentralizimi i ujit dhe kanalizimeve është mbështetur nga një sërë projektesh për ndihmë teknike por me përfundimin e strategjisë së sektorit të ujit dhe kanalizimeve pritet të ketë më tepër progres në këtë fushë.

Shumë donatorë, ndihmën e tyre për sektorët, ia japin direkt qeverisë lokale. Këto ndihma janë konsideruar si mbështetje për sektorët përkatës dhe jo si mbështetje për sektorin e decentralizimit.

Mbështetja e mëtejshme nga donatorët për periudhën afatshkurtër dhe atë afatmesme duhet të fokusohet në:

- forcimin e decentralizimit fiskal
- zhvillimin e kapaciteteve dhe trajnimin e personelit të pushtetit vendor dhe këshillave rajonalë
- menaxhimin e decentralizuar të shërbimeve
- krijimi i sistemeve të informacionit për qeverisjen vendore
- menaxhimi i shërbimeve publike të transferuara, kryesisht atyre të ujit dhe kanalizimeve
- planifikimi hapësinor.

## Rregjistri civil dhe kartat e identitetit

Zhvillimi i një sistemi për rregjistrimin civil të besueshëm dhe gjithëpërfshirës është një ndër prioritetet më kryesore të Qeverisë si një mjet i domosdoshëm për planifikimin e saj në fushat e shëndetësisë, taksave, sigurimeve shoqërore, lëvizjen e lirë të popullsisë, arsimin, shërbimin postar, shërbimin ushtarak etj.

Faza e parë e krijimit të rregjistrimit elektronik dhe të kartave të identitetit duhet të përfundojë gjatë vitit 2008. Kjo fazë është mbështetur nga KE/CARDS, Norvegjia dhe OSBE-ja. Faza e dytë është planifikuar të përfundojë në tre-katër vitet e ardhshme dhe ky proces do të kërkojë mbështetje të mëtejshme financiare dhe ekspertizë teknike nga donatorët.

Mbështetja e mëtejshme për rregjistrin civil duhet të fokusohet në:

- forcimin e strukturës ligjore ekzistuese
- mbështetje për agjencinë (që do të krijohet) për sistemin e adresave
- përcaktimin e procedurave për krijimin e sistemit të ri të adresave
- krijimin e autoritetit për koordinimin e hartës qendrore
- kompjuterizimin e plotë të rregjistrit civil dhe lidhjen e tij me sistemin e adresave
- lidhjen e rregjistrit civil dhe kartave të identitetit në një sistem të përbashkët
- përmirësimin e strukturës ligjore për mbrojtjen e të dhënave personale

## Statistikat

Sfida kryesore e Qeverisë në fushën e Statistikave është zbatimi i planit kombëtar pesëvjeçar për përmirësimin e Sistemit Kombëtar të Statistikave. Duke zbatuar këtë program, Instituti Kombëtar i Statistikave (INSTAT) do të forcojë transparencën e statistikave kombëtare dhe do t'i sjellë ato më pranë standardeve dhe kërkesave të EUROSTAT.

Mbështetja financiare e veprimeve të deritanishme të INSTAT nga Qeveria ka qenë e kufizuar krahasuar me nevojat në nivel kombëtar të INSTAT. Gjithsesi, INSTAT ka përfituar nga mbështetja e vazhdueshme e donatorëve e dominuar nga KE, duke filluar nga programi Phare në fundin e viteve '90 dhe duke vazhduar me mbështetje të përvitshme nga CARDS. Gjithashtu, IPA ka vënë në dispozicion fonde (duke filluar zbatimin në vitin 2008) për mbështetjen e prodhimit të statistikave rajonale. Gjatë viteve të fundit, Suedia ka dhënë një kontribut të dukshëm për INSTAT duke mbështetur statistikën për bizneset, mjedisin dhe gjinitë. BB dhe DfID kanë mbështetur anketimin mbi familjet (si psh Anketa e Matjes së Nivelit të Jetesës dhe anketa e të ardhurave të familjeve Shqiptare). Ndërkohë, në fushat e mësipërme është siguruar mbështetje edhe nga agjencitë e Kombeve të Bashkuara.

Ndërkohë që Shqipëria po krijon kapacitete më të mëdha për të përmbushur normat e BE-së për realizimin e statistikave rutinë, Qeveria do të marrë përsipër përgjegjësinë e financimit të plotë të ciklit të aktiviteteve statistikore. Gjithsesi, për realizimin e kësaj sipërmarrje do të duhen së paku 10 vjet, ndërkohë që vazhdimësia e ndihmës së huaj për sektorin e statistikave është shumë e rëndësishme në mënyrë që të ngritja e kapaciteteve të vazhdojë.

Për të evituar kërkesat e vazhdueshme dhe të veçuara ndaj çdo donatori dhe për çdo aktivitet, INSTAT ka kërkuar nga partnerët ndërkombëtarë që të koordinojnë mbështetjen e tyre për Statistikat në Shqipëri me qëllim afrimin e tyre me standardet statistikore evropiane, nëpërmjet krijimit të një Trust Fund-i ciklik (Fondi i Besimit). Aktivitetet e INSTAT-it që duhet të mbështeten nga Trust Fund janë:

- rritja e kapaciteteve dhe ndihmë teknike për realizimin e anketave vjetore për produktet, investimet në kapitalin bruto, dhe për statistikën e mbetjeve industriale
- hartimi i renditjes së plotë të llogarive kombëtare jo financiare sipas sektorëve
- kodimi gjeografik i të dhënave statistikore në zona të vogla
- krijimi i faqes së re të internetit dhe shpërndarja e të dhënave
- blerja e programeve statistikore kompjuterike të licencuara
- ndërmarrja e Anketes së Matjes së Nivelit të Jetesës (LSMS 2008)
- anketa e kostos së punës në ndërmarrjet jo bujqësore
- ndërmarrja e CENSUS-it të vitit 2011

## Drejtësia dhe anti-korrupsioni

### Drejtësia

Sfidat kryesore që identifikon SKZHI-ja përsa i përket reformës në sistemin e drejtësisë përfshijnë masat që duhen marrë për të përmirësuar efikasitetin e këtij sistemi që do të garantojë pavarësinë e gjyqësorit dhe rritjen e përgjegjshmërisë kundrejt shoqërisë, si dhe përmirësimet strukturore dhe legjislative për të bërë të mundur zbatimin e *acquis communautaire* si dhe ngritjen e kapaciteteve dhe strukturave të gjyqësorit në mënyrë që ato të reflektojnë standardet europiane.

Gjatë viteve të fundit, Ministria e Drejtësisë ka përqëndruar një pjesë të madhe të investimeve të brendshme në rehabilitimin e burgjeve. Këto investime janë shoqeruar me mbështetje të rëndësishme nga donatorët, kryesisht nga projektet CARDS të KE. Megjithatë, infrastruktura gjyqësore mbetet e varfër dhe ka nevojë për investime të konsiderueshme gjatë viteve në vijim, veçanërisht për rinovimin e gjykatave të rretheve, burgjeve dhe sistemeve të paraburgimit. Investime modeste lokale janë bërë për institucionet e pavaruara të drejtësisë.

Mbështetja e donatorëve prej të cilës ka përfituar sektori i drejtësisë përfshin 30 projekte në vazhdimësi ose që kanë përfunduar kohët e fundit, të cilat mbështesin reformën në drejtësi. KE me CARDS kanë qënë donatori më i madh që siguron ndihmë teknike në një sërë fushash nëpërmjet projekteve të Misionit të Asistencës Europiane për Sistemin e Drejtësisë Shqiptare (EURALIUS). Suedia ka mbështetur sistemin e drejtësisë për të miturit. OSBE-ja dhe Këshilli i Europës kanë mbështetur çështjet mbi të drejtat e njeriut në sistemin e drejtësisë. SHBA ka filluar projekte që fokusohen në shtetin e të drejtës, Gjermania ka mbështetur trajnimin e gjyqtarëve ndërsa Spanja së bashku me CARDS të KE-së kanë siguruar mbështetje financiare për Këshillin e Lartë të Drejtësisë. Shërbimet e përmbarrimit gjithashtu janë mbështetur me investime modeste nga donatorët.

Përsa i përket investimeve të ardhshme ndër të tjera mund të përmendim projektin e financuar nga KECARDS/IPA, EURALIUS, faza tjetër e të cilit pritet të fillojë gjatë vitit 2008 dhe do të vazhdojë të sigurojë mbështetje institucionale dhe ndihmë teknike brenda fushave të ndryshme në sistemin e drejtësisë. Zbatimi i projektit IPA që do të fillojë në vitin 2008 do të përqëndrohet në qendrat e paraburgimit si dhe arkivat e drejtësisë.

Mbështetja e donatorëve për periudhën afatmesme duhet të fokusohet në:

- rehabilitimin e ambienteve të burgjeve, rritjes së kapaciteteve të burgjeve dhe cilësisë së shërbimeve për të ndaluarit; trajnime për administratorët e burgjeve, rritjen e kapaciteteve në çështjet e të drejtave të njeriut brenda standardeve europiane; zbatimin e master planit për qendrat e paraburgimit; si dhe zhvillimin e sistemit informatik për burgjet
- përmirësimin e infrastrukturës së shërbimit gjyqësor dhe gjykatave në veçanti të gjykatave të rrethit dhe gjykatave të krimeve të rënda, sikurse dhe asaj për mbrojtjen e dëshmitarëve
- forcimin e sistemit të drejtësisë për të miturit si dhe përmirësimin e aksesit në ndihmën ligjore dhe informacion
- përmirësimin e koordinimit midis prokurorëve dhe policisë, në veçanti duke përmirësuar infrastrukturën e sistemit të menaxhimit të çështjeve penale
- rritjen e kapaciteteve hetimore nëpërmjet trajnimeve dhe paisjeve moderne të hetimit
- përmirësimin e infrastrukturës së shërbimit të përmbarrimit dhe përmirësimin e komunikimit me anë të lidhjes së internetit të brendshëm të të gjitha zyrave të përmbarrimit
- mbështetjen për shkollën e magistraturës për një periudhë afatmesme, duke vazhduar

mbështetjen për shkollën në mënyrë që ajo t'u ofrojë administratorëve të drejtesisë dhe gjyqtarëve trajnime mbi të drejtat e njeriut, etikën gjyqësore, çështjet e korporatave dhe ato komerciale, çështjeve të tjera të lidhura me MSA-në si dhe ligjet respektive.

## E drejta mbi pronën

Adresimi i çështjeve mbi të drejtën e pronës ngelet një prioritet i rëndësishëm për Qeverinë. SKZHI-ja identifikon një numër prioritetesh përsa i përket të drejtës mbi pronën ku përfshihen: kompensimi i pronave, vlerësimi dhe regjistrimi; procesi i legalizimit; transferimi i pronave publike nën pushtetin vendor dhe transferimi i pyjeve dhe kullotave për komunitetin lokal.

Një mbështetje të konsiderueshme për përmirësimin e situatës së pronave kanë dhënë dhe donatorët shpesh si pjesë e një programi më të gjerë i cili mbështet zhvillimin ekonomik dhe zhvillimin urban. Norvegjia, Finlanda, SHBA-ja, BB, PNUD-i, Çekia dhe OSBE-ja kanë financuar projekte të cilat kanë pasur si qëllim rregjistrimin fillestar të pasurive të patundshme si dhe përcaktimin e pronarëve të tyre. Një tjetër projekt i KE-së CARDS i planifikuar për të filluar në vitin 2008 do të mbështesë regjistrimin pasurive në zonat bregdetare. E drejta mbi pronën është një prioritet dhe për projektet IPA, i cili identifikon zhvillimin e plotë të sistemit të pasurive të patundshme. BB mbështet gjithashtu çështjen e pronave nëpërmjet projektit të Administrimit të Tokave. BB ka planifikuar mbështetje të mëtejshme për Zyrën e Rregjistrimit të Pasurive të Paluajtshme nëpërmjet "Programit në Mbështetje të Politikave të Zhvillimit" (DPO2).

Mbështetja e donatorëve për periudhën afatmesme duhet të fokusohet në:

- Mbështetje për kompjuterizimin e Zyrës së Rregjistrimit të Pronave të Patundshme si dhe për rritjen e kapaciteteve të personelit
- Mbështetje për përmirësimin e strukturës ligjore

## Anti-korrupsioni

Institucionet Shqiptare kanë bërë përpara në zbatimin e rekomandimeve të vitit 2002 të Grupit të Shteteve kundër Korrupsionit të Këshillit të Europës (GRECO). Kjo përfshin ligjin e ri të prokurimit publik; marrjen e masave për forcimin e pavarësisë dhe transparencës së Agjencisë së Prokurimeve Publike; emërimin e Avokatit për Prokurimet Publike; ngritjen e Qendrës së Rregjistrimit të Bizneseve "one stop shop"; dhe përafrimin e legjislacionit specifik mbi ryshfetet.

SHBA, KE dhe BB kanë qenë donatorët kryesorë, duke dhënë një mbështetje të vazhdueshme për iniciativat anti-korrupsion. KE dhe SHBA e kanë fokusuar ndihmën e tyre në mbështetjen dhe hartimin e ligjit të ri për prokurimet publike dhe atij kundër pastrimit të parave. SHBA gjithashtu ka siguruar një mbështetje të konsiderueshme (13.8 milion \$) përmes Llogarisë së Sfidës së Mijëvjeçarit (Millennium Challenge Account) që mbështet modernizimin e sistemit të taksave, liberalizimin e licencimeve dhe regjistrimeve të bizneseve, dhe Avokatin e Prokurimeve Publike. BB e ka mbështetur Qeverinë në rregullimin e legjislacionit që lidhet me anti-korrupsionin dhe në ngritjen e kapaciteteve për zbatimin e tij.

Mbështetja e donatorëve në anti-korrupsion duhet të fokusohet në:

- ngritjen e kapaciteteve institucionale për hetimin dhe penalizimin e korrupsionit
- mbështetje e kuadrin ligjor për transparencën e sistemit politik dhe etikën e funksionareve publik, duke përfshirë financimin e partive politike dhe fushatave zgjedhore



- e-Gov në nivelin e qeverisjes vendore
- reforma të mëtejshme për rregullat e liçencimeve dhe shërbimeve publike
- rregullat për aktivitetet lobuese
- mbështetje teknike dhe ligjore për institucionet kundër pastrimit të parave

## **Policia dhe krimi i organizuar**

### **Policia**

Policia e shtetit ka disa prioritete strategjike të cilat kanë të bëjnë jo vetëm me përmirësimin e përgjithshëm të sektorit por në veçanti me zhvillimin e infrastrukturës organizative dhe përmirësimin në aspektin operacional të forcave të policisë. Këtu përfshihen: inteligjenca dhe policimi në komunitet; decentralizimi i kompetencave; trajnimi për menaxhim; burimet njerëzore; ngritja e kapaciteteve në Akademinë e Policisë; përmirësimi i menaxhimit të logjistikës; zhvillimi i infrastrukturës policore; unifikimi i ndërtesave dhe pasjeve të një standardi; dhe përmirësimi i masave të sigurisë në rrugë.

Pjesa më e madhe e investimeve të brendshme ë Ministrisë së Brendshme i takon programit të Policisë së Shtetit i cili përqendrohet në blerje paisjesh dhe rinovimin e drejtorisë së policisë. Por niveli aktual i financimeve të brendshme nuk mjafton për të arritur qëllimet e shumta të reformës në këtë sektor.

Mbështetja e donatorëve është fokusuar në forcimin e kapaciteteve për institucionet e policisë si dhe në luftën kundër krimit të organizuar. Pjesa më e madhe e financimit është siguruar nga KE me programin CARDS, kryesisht nëpërmjet Misionit të Komunitetit European në Ndhmësë të Policisë Shqiptare (PAMECA). Një tjetër projekt shtesë i SHBA dhe KE i cili është duke u përfunduar, mbështet reformën në sektorin e sigurimit, sistemet informatike dhe policimin në komunitet. Projekti IPA do mbështesë fazën e tretë të misionit PAMECA, që do fillojë në vitin 2008.

### **Krimi i Organizuar**

Prioritetet strategjike të lidhura me krimin e organizuar, terrorizmin dhe trafikimin fokusohen kryesisht në përmirësimin e kapaciteteve operationale të Departamentit të Krimit të Organizuar; përmirësimin e infrastrukturës për operatione speciale (TIM, RMIS, Datacom, Memex); përmirësimi i shërbimeve për mbrojtjen e dëshmitareve; si dhe luftën kundër të gjitha formave të trafikimit të paligjshëm.

Lufta kundër krimit të organizuar, terrorizmi dhe trafikimi kane pasur mbështetje financiare nga rreth 20 projekte donatorësh me një shumë pothuajse 30 milion euro. Tre projekte të reja janë planifikuar për të filluar në vitin 2008. KE është donatori kryesor që mbështet luftën kundër krimit të organizuar dhe anti-terrorizmin, dhe nëpërmjet CARDS dhe IPA kanë dhënë 6.5 milion euro. SHBA është donatori dypalësh kryesor në këtë sektor. Mbështetje të konsiderueshme kanë dhënë gjithashtu dhe Suedia, Austria, Italia dhe Greqia, me një fokusim kryesisht në luftën kundër trafikimit human.

### **Menaxhimi i Integruar i Kufijve**

Qeveria ka adoptuar një strategji kombëtare për Menaxhimin e Integruar të Kufijve (MIK) si dhe një plan veprimi të cilat janë në përputhje me kërkesat dhe standardet europiane. Prioritetet dhe sfidat në këtë fushë ngelen ato në përmirësimin e legjislacionit si dhe ndryshimet në strukturën organizative dhe menaxhim.

Menaxhimi i kufijve ka një mbështetje të rëndësishme nga donatorët me katër projekte në vazhdimësi dhe shtatë të planifikuar, me një total prej 20 milion euro, ku përshihen donatorë si

KE me CARDS, SHBA, Greqia, Italia dhe OSBE-ja. Kjo mbështetje pritet të rritet me fillimin e projekteve të planifikuara nga IPA dhe SHBA-ja.

Mbështetja e donatorëve për policinë, luftën kundër krimit të organizuar dhe anti-trafikimit dhe menaxhimin e integruar të kufijve për periudhën afatshkurtër dhe atë afatmesme duhet të fokusohet në:

- Përmirësimin e menaxhimit të kapaciteteve për Policinë e Shtetit Shqiptar
- Zbatimi i strategjisë për policimin në komunitet
- Forcimin e kapaciteteve operuese për policinë rrugore, përmirësimin e sigurisë në rrugë si dhe përmirësimin e logjistikës për policinë
- Përmirësimi i aseteve operacionale dhe i sistemit të menaxhimit të informacionit, si dhe mbështetje të mëtjshme për rinovimin dhe mirëmbajtjen e sistemit të komunikimit DATACOM.
- Përforcimin e bashkëpunimit midis institucioneve të ndryshme shtetërore të përfshira në luftën kundër krimit të organizuar dhe terrorizmit, në veçanti, midis gjyqësorit dhe policisë.
- Krijimin i sistemit të inteligjencës moderne të mbledhjes dhe procedimit të informacionit, duke përfshirë këtu mjete të veçanta hetimore, ndërhyrjet në telekomunikacion dhe përdorimin e informacionit të inteligjencës.
- Forcimin e kapaciteteve për të siguruar analistë të anti-terrorizmit dhe hetues të trajnuar dhe me aftësi dhe mjete më të mira hetimore
- Përmirësimin e kapaciteteve humane dhe teknike për menaxhimin e kufijve

## 3.2 ZHVILLIMI EKONOMIK

Shqipëria është një vend me ekonomi me zhvillimin më të shpejtë në Europë. Qeveria është e vendosur të sigurojë që kjo rritje të ndodhë në mënyrë të vazhdueshme në ekonominë formale, në mënyrë që bizneset shqiptare të mund të konkurojnë në tregjet europiane. Zhvillimi i institucioneve ekonomike efektive është prioriteti i dytë kryesor strategjik në SKZHI. Këtu përfshihet promovimi i zhvillimit të ekonomisë kombëtare dhe krijimi i një sistemi efektiv për sistemet e doganave, taksave dhe financimt publik. Përsa i përket zhvillimit ekonomik, investimi publik me financim të brendshëm nuk ka munguar por gjithsesi pjesa më e madhe është e financuar nga ndihma a huaj. Pjesa e ndihmës së huaj e planifikuar aktualisht për zhvillimin ekonomik është në përputhje me prioritetet e qeverisë. Dokumentet e programeve të donatorëve tregojnë se prioritetet e tyre, përtej periudhës afatmesme e vendosin theksin në zhvillimin ekonomik, gjë që përputhet edhe me prioritetet më afatgjata të SKZHI-së që kanë për qëllim rritjen e mbështetjes për zhvillimin ekonomik.

### Ekonomia dhe mbrojtja e konsumatorit

#### Ekonomia

Prioritetet strategjike të strategjisë sektoriale për Zhvillimin e Biznesit dhe të Investimeve përfshijnë: përfundimin e reformës rregullatore për rritjen e konkurrencës; eliminimin e praktikave anti-konkurrese; inkurajimin e ekonomisë formale; promovimin e Ndërmarrjeve të Vogla dhe të Mesme (NVM), eksporteve dhe investimeve të huaja direkte; ndjekjen e parimeve të Organizatës Botërore të Tregtisë (OBT) dhe të Marrëveshjes së Përkohshme për angazhimet e BE-së; si dhe përfundimin e procesit të privatizimit. Investimet me financim të brendshëm drejtohen kryesisht në ristrukturimin e ndërmarrjeve industriale, sipas kërkesave të MSA-së, dhe në zhvillimin e aktiviteteve në sektorin e minierave.

Mbështetja e donatorëve për zhvillimin ekonomik do të arrijë 13 milion euro në vitin 2008. Në këtë sektor numërohen rreth 16 projekte donatorësh midis të cilëve një projekt i madh për zhvillimin e NVM-ve i mbështetur nga Italia dhe Gjermania (projekte në vazhdimësi për promovimin e mikro-ekonomisë dhe NVM-ve në zonat urbane dhe ato rurale) dhe projektit për reformën mbi mjediset e bizneseve dhe forcimin e institucioneve të biznesit e fiiancuar nga BB. Projekte të konsiderueshme ka gjithashtu për zhvillimin e ndërmarrjeve, të financuara kryesisht nga SHBA-ja (siç është Fondi Amerikano-Shqiptar për Ndërmarrjet), si dhe për privatizimin. Projekte të planifikuara për zhvillimin ekonomik përfshijnë: ndërtimin e një parku industrial me mbështetje nga Italia, promovimin e NVM-ve mbështetur nga Gjermania, dhe sigurimin e linjës së kredive dhe huave për biznes, mbështetur nga Italia. IPA ka vënë në dispozicion 3 milion euro për të mbështetur zhvillimin e NVM-ve dhe rritjen e sipërmarrjes dhe inovacionit (projekti fillon në-e 2008).

Mbështetja e mëtejshme nga donatorët dypalësh dhe ata shumëpalësh për zhvillimin ekonomik është një prioritet i rëndësishëm. Megjithatë, duke pasur parasysh progresin që Shqipëria po bën për arritjen e standardeve europiane, është e rëndësishme që kjo mbështetje të vijë në formë të unifikuar mbarëkombëtare në mënyrë që të reflektojë normat dhe direktivat e BE-së. IPA duhet të luajë një rol të rëndësishëm në përcaktimin e kësaj forme.

Mbështetja e mëtejshme e donatorëve duhet të fokusohet në:

- Zbatimin e kartës europiane për Ndërmarrjet e Vogla dhe të Mesme
- Mbështetjen teknike për nxitjen e IHD-ve, tregtisë dhe eksportit
- Krijimin e një agjencie për garantimin e eksportit
- Inovacionet në biznes dhe transferimin e teknologjisë
- Parqet industriale

## Mbrojtja e Konsumatorit dhe Mbikëqyrja e Tregut

Prioritetet strategjike përse i përket kësaj fushe ndërsektoriale janë: të forcohet niveli i konsumatorit nëpërmjet një sistemi informimi dhe këshillimi; të mbrohen interesat ekonomike të konsumatorit nëpërmjet zhvillimit të një strukture të duhur ligjore dhe institucionale, si dhe nëpërmjet zhvillimit të një rrjeti shoqatash konsumatorësh; të mbrohen në një mënyrë sa më efektive konsumatorët nga rreziqet (sigurisë në ushqim, kontrollimi i pesticideve dhe sëmundjeve veterinare, strukturat mbikëqyrëse për lëndët farmaceutike etj.).

Ministria e Ekonomisë Tregtisë dhe Energjitikës ka marrë rreth 0.3 milion euro fonde nga buxheti i shtetit për vitin 2008, për programin e mbikëqyrjes së tregut; ky fond kalon nëpërmjet Inspektoratit Teknik Qendror. Ndërsa ndihma e huaj është dominuar kryesisht nga një seri projektesh CARDS të fokusuara në standardizimin, çertifikimin, akreditimin dhe metrologjinë. Një tjetër projekt i CARDS prej rreth 1.5 milion euro është planifikuar të fillojë në vitin 2008.

Rreth 0.8 milion euro investime me financim të brendshëm të Ministrisë së Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit për vitin 2008 i takojnë programit të sigurisë së ushqimit dhe mbrojtjes së konsumatorit, kryesisht për të mbështetur financiarisht ambientet dhe paisjet për laboratorët e sigurimit të ushqimit. Ndihma e huaj është fokusuar krijimin e autoritetit të ushqimit (CARDS), inspektimet veterinare dhe fitosanitare (CARDS), masave mbrojtëse ndaj gripit të shpendëve (Japonia dhe BB). Një projekt për rritjen e kapaciteteve përse i përket sigurisë së ushqimit, mbështetet nga Qeveria Italiane. Dokumenti i Planifikimit Indikativ Shumë Vjeçar i KE-së/IPA identifikon sigurinë e ushqimit dhe shërbimet veterinare si një ndër programet e tyre por ky program nuk do të fillojë para vitit 2009.

Mbështetja e donatorëve në të ardhmen mund të fokusohet në:

- Forcimin e kuadrit ligjor dhe strukturave institucionale për mbrojtjen e konsumatorit dhe mbikqyrjen e tregut
- ngritjen e një qendre për mbështetjen e konsumatorit për të promovuar rritjen e ndërgjegjes së konsumatorit dhe formimin e tij, si dhe mbështetjen e shoqatave të konsumatorit
- mbështetjen e mëtejshme për sigurinë e ushqimit, shërbimeve veterinarë dhe inspektimit fitosanitar

## Financat publike

Prioritetet strategjike sipas strategjisë sektoriale për financat publike janë: përmirësimi i cilësisë së shpenzimeve; zgjerimi i bazës tatimore dhe harmonizimi i politikave tatimore me prioritetet kombëtare; modernizimi dhe menaxhimi i borxhit publik; fuqizimi i performancës dhe i kredibilitetit të agjencive doganore dhe tatimore.

Pjesa më e madhe e investimit publik prej 4.3 milion euro, financuar nga buxheti i shtetit për vitin 2008 do të vihet në dispozicion të blerjes së pajisjeve doganore për kontrollin e karburanteve. Ndërsa mbështetja financiare nga donatorët ka qenë më e shpërndarë mes programeve si më poshtë vijon:

- nën programin e menaxhimit të shpenzimeve publike, projekti i “ Forcimit të menaxhimit të shpenzimeve publike” është financuar nga DfID, Holanda dhe Suedia, ndërkaq Sistemi i Thesarit është mbështetur nga BB dhe CARDS, ndërsa Programi i Politikave të Zhvillimit të BB ka mbështetur menaxhimin e investimeve publike.
- menaxhimi i të ardhurave nga taksat është mbështetur nga DfID dhe Suedia
- menaxhimi i të ardhurave nga doganat është mbështetur për një kohë të gjatë nga misioni i KE për doganat shqiptare
- programi për luftën kundër transaksioneve financiare jo legale është mbështetur për një kohë të gjatë nga SHBA dhe një projekt i CARDS
- kontrolli i brendshëm dhe ai i financave publike është mbështetur nga CARDS dhe SIGMA

Trust Fund i SPI-së, i cili do të menaxhohet nga BB, do të luajë gjithashtu një rol të rëndësishëm në vitet e ardhshme, veçanërisht në fushën e analizës makroekonomike, atë menaxhimit të shpenzimeve dhe borxhit.

Përsa i përket institucioneve të pavarura:

- Agjencia e Prokurimeve Publike është mbështetur nga një projekt i Korporatës së Sfidës së Mijëvjeçarit i financuar nga SHBA dhe nga CARDS
- Kontrolli i Lartë i Shtetit është mbështetur nga projekti CARDS
- Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare është mbështetur nga projekti i BB “Regional Balkan Facility”.

Mbështetja e donatorëve në financat publike duhet të fokusohet në:

- përmirësimin e kapaciteteve për menaxhimin e parashikimeve makroekonomike dhe fiskale të shpenzimeve publike
- menaxhimin e shpenzimeve publike

- përafrimin e legjislacionit me BE për taksat dhe doganat dhe rritja e forcimit të kapaciteteve për zbatimin e këtij legjislacioni
- zbatimin e një sistemi të kompjuterizuar për deklarimet në dogana dhe përpunimi i të dhënave në të gjitha pikat doganore
- përforsimin e kapaciteteve për regjistrimin e taksave, veçanërisht në fushën e kontrollit dhe mbikëqyrjes mbi taksat dhe përfundimi i procesit të kompjuterizimit të zyrave të taksave
- forcimin e kapaciteteve administrative të Agjencisë së Prokurimit Publik, zyrave të prokurimit publik në ministritë e linjës, në qeverisjen vendore, dhe gjykatave që merren me çështjet e prokurimeve publike.
- më shumë mbështetje i duhet dhënë kontrollit dhe mbikëqyrjes së financave publike

### 3.3 INFRASTRUKTURA

Shqipëria për vite me radhë ka vuajtur nga investimet e pakta në infrastrukturën kombëtare, duke përfshirë këtu transportin, energjinë, ujin, kanalizimet dhe mjedisin. Me qëllim përmirësimin e kësaj situate, Qeveria ka vënë në dispozicion të përmirësimit të infrastrukturës kombëtare më shumë se gjysmën e investimeve të brendshme dhe të ndihmës së huaj të viteve të fundit. Investimet në energji janë mbështetur kryesisht nga ndihma e huaj dhe huatë tregtare. Në transport, ujë, kanalizime dhe mjedis janë siguruar mbështetje për investimet si nga buxheti i shtetit ashtu dhe ndihma e huaj, kjo e fundit më e theksuar në mjedis, ujë dhe kanalizime. Pjesa e ndihmës së huaj e planifikuar për infrastrukturën përputhet edhe me SKZHI-në dhe rëndësia e transportit në ndihmën e planifikuar reflekton prioritetet afatmesme të Qeverisë. Më shumë mbështetje nga programet e ardhshme të donatorëve nevojitet për mjedisin, ujin dhe kanalizimet.

#### Transporti

Sektori i transportit ka qenë në qendër të investimeve publike dhe atyre të huaja në dhjetëvjeçarin e fundit. Buxheti i shtetit mbështet pjesën më të madhe të investimeve në rrjetin kombëtar të rrugëve.

Planifikimi për Transportin. Një fond i kufizuar i investimeve publike të mbështetura nga buxheti i shtetit në këtë program, i është dhënë Institutit të Studimeve të Transportit. Ndër burimet kryesore të financimit të planifikimit të transportit janë një seri projektesh të KE, të realizuara, në vazhdim apo të planifikuara, një nga të cilat çoi në përgatitjen e Master Planit për Transportin Kombëtar, që përbën bazën e strategjisë sektoriale të transportit.

Rrjeti kombëtar i rrugëve. Nën këtë program, investimet publike me financim të brendshëm priten arrijnë në 103 milion euro në vitin 2008. Pothuajse 60% e kësaj shume është vënë në dispozicion të konstruksionit të rrugëve, duke përfshirë pjesët e mbetura nga aksi rrugor veri-jug, komponentë të korridorit Durrës-Morinë, rrugës përgjatë bregdetit Jonian si dhe unazat e qyteteve të ndryshme. Ndërkohe që financimi i brendshëm i vënë në dispozicion do të jetë i njëjtë, në total financimet e huaja në 2008-n do të trefishohen duke arritur shifrën 383 milion euro. Kjo përfshin edhe huatë tregtare, siç është rasti i segmentit rrugor Rrëshen-Kalimash, pjesë e korridorit rrugor Durrës-Morinë me vlerë rreth 230 milion euro. Projektet e donatorëve janë duke mbështetur financiarisht ndërtimin e segmenteve rrugore të aksit veri-jug si: Lushnjë-Fier dhe Shkodër-Han i Hotit (Itali) dhe Fier-Tepelene-Gjirokastër (BERZH, BEI). Donatorët janë gjithashtu duke financuar dy nga tre segmentet e korridorit Durrës-Morinë (Milot-Rrëshen dhe Kalimash-Morinë) (BB, BERZH, IDB). Rruga që lidh Sarandën me Konispolin deri në pikën doganore do të financohet nga Greqia dhe rruga që lidh Fierin me Vlorën do të financohet nga BEI.

Përkushtimi i Qeverisë dhe mbështetja e donatorëve për të përmirësuar rrjetin kombëtar të rrugëve tashmë është i qartë, ndërkohë projektet në të ardhmen duhet të orientohen drejt rritjes së sigurisë rrugore dhe reduktimit të aksidenteve.

Rrjeti i rrugëve dytësore. Pjesë e synimit të Qeverisë për të rehabilituar 6,000 km rrugë ushqyese rurale dhe lokale, një projekt madhor, i financuar pjesërisht nga BB, është në fazë të avancuar të përgatitjes. Përgjegjësia financiare për këto rrugë i është deleguar njërive të qeverisjeve vendore. Si rezultat, përgatitja e projektit përfshin krijimin e strukturave të përbashkëta midis qeverisjes qendrore dhe asaj lokale që do të koordinojnë procesin dhe që njëkohësisht do të shërbejnë si mekanizma për të mirëmbajtur këto përmirësime në të ardhmen.

Portet. Buxheti i shtetit për vitin 2008 ka vënë në dispozicion nga burimet e brendshme financiare, 2.9 milion euro për zhvillimin e portit të Sarandës dhe për të financuar pjesërisht ndërtimin e terminalit të pasagjerëve në portin e Durrësit (BEI me mbështetje shtesë nga CARDS). Një tjetër mbështetje për zhvillimin e portit të Durrësit është parashikuar edhe nga BEI dhe BERZH. BB është duke mbështetur ndërtimin e terminalit të pasagjerëve në Sarandë dhe IFC mbështet dhënien me koncension të portit të mallrave në Durrës. Italia do të mbështesë zhvillimin e portit të Vlorës. Mbështetje shtesë është kërkuar nga KE/IPA për zhvillimin e portit të Shëngjinit. Ndërhyrjet që do të nevojiten kohë pas kohë në këtë sektor, në të ardhmen duhet të ndjekin master planet përkatëse.

Hekurudhat. Në dispozicion të këtij programi janë vënë 3 milion euro nga buxheti i shtetit të vitit 2008, shumë kjo e ndarë përafërsisht në mënyrë të barabartë ndërmjet përmirësimeve në infrastrukturë dhe blerjes së pajisjeve për trenat. Gjatë pesë viteve të fundit nuk ka pasur financime të huaja në këtë sektor, përveç një studimi të bërë me financim të Qeverisë Çeke për rrjetin dhe sistemet e telekomunikimit të Hekurudhës Shqiptare fokusuar në instalimin e sistemit të sinjalistikës në stacionin e Durrësit dhe Shkozetit për vitin 2007-2008 (Faza e parë përfshinte periudhën e viteve 2003-2004) dhe financimit Interreg për një studim të hekurudhës Durrës-Maqedoni. Për këtë sektor edhe për vitet në vazhdim është parashikuar një mbështetje e kufizuar. KE nën programin CARDS ka planifikuar një projekt të vogël për dixhitalizimin grafik të rrjetit hekurudhor, ndërkohë që edhe ristrukturimi i kompanisë është një çështje akoma e pazgjidhur.

Aviacioni civil: Buxheti i shtetit përfshin angazhime financiare modeste në këtë sektor, kryesisht të drejtuar në mbështetje të ndërtimit të aeroportit të Kukësit. Pas mbarimit të punimeve në Aeroportin Ndërkombëtar të Tiranës, prioriteti kryesor qëndron në përmirësimin e kuadrit ligjor dhe reformës në këtë sektor.

Mbështetja e mëtejshme e donatorëve duhet të fokusohet në:

- mbështetje për riorganizimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve
- mbështetje për përmirësimin e sistemit të menaxhimit të aseteve rrugore
- përmirësimin e standardeve të sigurisë rrugore dhe masat për zbatimin e tyre
- mbështetje për përfundimin e rikonstruksionit të akseve të rrjetit kombëtar rrugor
- zgjerimin me një korsi të dytë të dy akseve rrugore, veçanërisht në segmentet Tiranë-Shkodër dhe Durrës-Rrogozhinë
- mbështetje për sipërmarrjen e programit të investimeve në rrjetin e rrugëve lokale dhe ato rurale, veçanërisht rrugët në ndihmë të turizmit
- kompletimin e financimeve të angazhuara për zbatimin e programit për rrjetin dytësor të rrugëve
- hekurudhat: rehabilitimin e linjave Durrës-Rrogozhinë dhe Vlorë-Milot, instalimin e sistemit të sinjalistikës dhe interlokimit për linjat Durrës-Tiranë dhe Milot-Rrogozhinë,

dhe përmirësimin e shërbimit ndaj pasagjerëve

- rritjen e kapaciteteve për kontrollin e trafikut ajror dhe përmirësimin e sistemit rregullues
- rritjen e kapaciteteve të administratës portale sipas standardeve ndërkombëtare

## Energjia

Prioritetet në sektorin e energjisë fokusohen në krijimin e një strukture regullatore dhe institucionale të efektshme, rikonstruktimin e plotë të kompanive publike të energjisë, rritjen e furnizimit me energji (nëpërmjet investimeve në prodhimin, shpërndarjen dhe transmetimin e energjisë, shfrytëzimit të burimeve të petrolit dhe gazit; dhe burimeve të rinovueshme të energjisë), përdorimit eficient të energjisë me sa më pak impakt negativ për ambientin dhe pjesëmarrjes aktive të tregut vendor në tregun rajonal të energjisë elektrike, në përputhje me kërkesat e BE-së.

Buxheti i shtetit nuk është një instrument i mjaftueshëm financiar për mbulimin e nevojave në investime të sektorit të energjisë dhe ndërkohë KESH, e cila është kompani publike energjetike, nuk mund ti mbështesë financimet e veta vetëm nëpërmjet buxhetit të shtetit.

Sektorin e energjitik ka përfituar rreth 24% të gjithë ndihmës së donatorëve të dhënë për Shqipërinë qysh prej vitit 2000. Kjo ndihmë është dhënë kryesisht në formën e huave të buta, të cilat janë mjeti më i përshtatshëm për një sektor drejt privatizimit. Pesë donatorët më të mëdhenj në sektorin energjetik (BERZH, BEI, BB, Italia dhe Gjermania) kanë kontribuar secili në vlera që variojnë 15-20% të fondeve totale. Mbështetja e dhënë përfshin rehabilitimin e hidrocentraleve të Drinit dhe Bisticës, me donatorë kryesorë Austria, BERZH, Italia, Japonia, Gjermania dhe Zvicra; rehabilitimin e transmisionit dhe shpërndarjes mbështetur nga BERZH, Italia, Japonia, KfW, Zvicra dhe BB; pajisjet për mirëmbajtje të veçanta mbështetur nga Norvegjia dhe Spanja, importin e energjisë mbështetur nga Italia, reduktimin e humbjeve në energji nga Zvicra dhe BB, integrimin në rrjetin rajonal të elektricitetit mbështetur po nga BERZH, Italia dhe BB, reformën institucionale mbështetur nga Italia, SHBA dhe BB dhe ndihmën për menaxhimin e KESH-it mbështetur nga Italia.

Në të ardhmen ndihma financiare për energjinë do të ofrohet për gjenerim të energjisë duke përfshirë këtu financimet për stacionet termale si ai në Vlore, investuar nga BEI, BERZH dhe BB. Është e rëndësishme që financimet me anë të huave koncesionare të vazhdojnë përgjatë kësaj periudhe. Në të njëjtën kohë, Qeveria ka inkurajuar gjithashtu ngritjen e hidrocentraleve të rinj me terma koncesionare, ku në disa raste donatorët do të japin mbështetje për garantimin e kredive, për shembull, një mbështetje të tillë e jep Gjermania (KfW).

Mbështetja e mëtejshme e donatorëve duhet të fokusohet në:

- përmirësimin e mëtejshëm të sistemit të dhe shpërndarjes
- kapacitetet për furnizimin me energji dhe ato prodhuese
- mirëmbajtjen e digave
- përdorimin me efikasitet të energjisë dhe përdorimin e burimeve të energjisë së rinovueshme

## Uji dhe kanalizimet

Krahasuar me vendet e tjera europiane, Shqipëria është një ndër vendet me mbulimin më të ulët në furnizimin me ujë të popullsisë veçanërisht në zonat rurale. Financimi i infrastrukturës së sektorit të ujit dhe kanalizimeve nga buxheti i shtetit është i ndarë në midis MPPTT dhe njësisë të qeverisjes vendore, të cilat që prej vitit 2007 janë gradualisht duke e marrë përsipër

përgjegjësinë e menaxhimit të furnizimit me ujë të popullatave respektive. Buxheti i shtetit për investimet publike nën këtë sektor do të kalojë 26.1 milion euro në vitin 2008. Kjo shumë është e ndarë pothuajse në mënyrë të barabartë ndërmjet sektorëve të ujit dhe kanalizimeve, granteve konkurruese për njësitë e qeverisjes vendore, si dhe bashkëfinancimit i projekteve të ndihmës së huaj.

Përsa i përket reformës institucionale dhe menaxhimit, sipas Programit në Mbështetje të Politikave të Zhvillimit të BB, duhet të eliminohet në mënyrë progresive subvencionimi i sistemit të furnizimit me ujë. GTZ ka mbështetur privatizimin e sektorit të furnizimit me ujë; Projekti i BB dhe BEI “Uji në bashkitë dhe trajtimi i ujërave të zeza” ka mbështetur kontratat e menaxhimit dhe ngritjen e departamentit të standardeve pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Ujërave dhe Kanalizimeve; Italia ka mbështetur departamentin e projekteve në MPPTT dhe atë të furnizimit me ujë për Tiranën; ndërsa Austria ka mbështetur furnizimin me ujë të Shkodrës.

Prezenca e donatorëve është më e fuqishme në zbatimin e projekteve me investime konkrete për ndërtimin dhe rehabilitimin e rrjeteve të ujit dhe kanalizimeve. Donatorët shumpalësh dhe ata dypalësh kanë qenë shumë aktivë, kështu: Zvicra ka operuar në Shkodër dhe Pogradec; Norvegjia në Burrel; Luksemburgu në Dibër; Italia në Tiranë dhe Vlorë; Greqia në Sarandë; Austria në rajonin e Shkodrës; KfW në Pogradec, Korçë, Kavajë, Berat, Kuçovë, Lushnjë dhe Elbasan; dhe BB dhe BEI në Sarandë, Lezhë, Fier dhe Durrës. Projektet e planifikuara do përqëndrohen në Shkodër, një investim i përbashkët i Austrisë, Zvicrës dhe Gjermanisë; në Vlorë me mbështetje të përbashkët nga Holanda dhe KE; si dhe në zonat rurale me mbështetje të KfW. Tre donatorët më të mëdhenj në sektorin e ujit (Gjermania, Italia dhe BEI) kanë dhënë 62% të investimit total. Programi IPA për vitin 2007 ka ofruar 10% e investimit total, dhe është parashikuar gjithashtu që financimet nga IPA të luajnë një rol të rëndësishëm në rritje në financimin e investimeve në sistemin e furnizimit me ujë.

Gjatë periudhës afatmesme dhe afatgjatë varesia nga financimet e donatorëve në sektorin e ujë-kanalizimeve do të jetë më e madhe se në sektorët e tjerë. Kjo përputhet edhe me tendencat aktuale të vendeve kandidate apo anëtare të BE-së, ku një pjesë konsiderueshme e financimeve të huaja dhe veçanërisht financimet e BE-së i kushtohen sektorit të ujit dhe kanalizimeve.

Mbështetja e mëtejshme e donatorëve duhet të fokusohet në:

- kapacitetin qendror, në monitorimin e impaktit të zbatimit të reformave në sistemin e furnizimit me ujë: pajisjes me matësa, nivelet e arkëtimeve, planet e biznesit
- trainimin e stafit të njësive të furnizimit me ujë dhe përdorimin e teknologjive të reja
- forcimin e laboratorëve dhe monitorimin e cilësisë së ujit
- krijimin e faturave kompjuterike dhe sistemit të arkëtimeve në njësitë e furnizimit me ujë
- ngritjen e një skeme stimuluese për mbikëqyrjen e leximit të matësave së ujit
- përfundimin e transformimit të ndërmarrjeve të ujit në kompani private
- ngritjen e Agjencisë Rurale të Ujit dhe Kanalizimeve
- futjen e subvencioneve në bazë performance për të inkurajuar njësitë e furnizimit me ujë për mbulimin e shpenzimeve
- shkrirjen e njësive të furnizimit me ujë për të arritur një numër optimal njësish që do të inkurajonin investimet nga sektori privat
- investimet në zonat urbane dhe rurale ku indikatorët e aksesit janë shumë të ulët ose në ato zona ku ka nevoja thelbësore për rinovimin e rrjeteve ekzistuese sipas master planeve kombëtare



## Mjedisi

Strategjia ndërsektoriale e mjedisit ndikon jo vetëm Ministrinë e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave por edhe Ministrinë e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit (uji dhe kanalizimet, trajtimi i ujrave të mbetura, trajtimi i mbetjeve të ngurta, kontrolli teknik i automjeteve, etj.), Ministrinë e Shëndetësisë (monitorimi i shëndetit publik), Ministrinë e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit (mbrojtja nga erozioni) dhe METE (efiçenca e energjisë dhe burimet alternative).

Mbrojtja e mjedisit. Sfidat kryesore në këtë sektor janë zhvillimi i qëndrueshëm i vendit përkrah sigurimit të mbrojtjes së burimeve natyrore nga ndotja dhe degradimi dhe promovimit të vlerave mjedisore. Ndërhyrja e donatorëve në këtë sektor përfshin mbrojtjen e Liqenit të Prespës (GEF dhe PNUD), monitorimi i emetimit të ozonit (UNEP dhe UNIDO), përdorimi i paneleve diellore (GEF dhe PNUD), rehabilitimi i hot spots/zonave industriale (CARDS, Holanda, GEF dhe PNUD), rritja e ndërgjegjësimit (Holanda dhe Suedia) dhe disa nga projektet e KE/CARDS në mbështetje të legjislacionit mjedisor, monitorimit dhe mbrojtjes nga ndotja në zonat industriale. Një ndër projektet më të mëdha është edhe ai i Menaxhimit të Burimeve Natyrore, i financuar nga GEF, Suedia dhe BB, që përfshin menaxhimin e integruar të burimeve natyrore, ruajtjen e biodiversitetit dhe ndërgjegjësimin e publikut. Mbrojtja e mjedisit do të jetë një nga elementet kryesore në procesin e integritit evropian dhe mbështetja e donatorëve do të jetë mëse e nevojshme. Projektet e planifikuara për të ardhmen përfshijnë mbështetje për zbatimin e acquis mjedisor (CARDS), menaxhimin e basenit të lumit Drin (GEF) si dhe edukimin mjedisor në nivelet e arsimit nëntë-vjeçar (Holanda).

Peshkimi. Buxheti i shtetit 2008 ka parashikuar 0.9 milion euro për thellimin e kanalit të Butrintit dhe bashkëmbështetje me fonde për projektin e IDB për portin e peshkimit në Durrës. Projekti për Zhvillimin e Peshkimit i financuar nga BB dhe Italia ka mbështetur përveç të tjerave, edhe organizatat e menaxhimit të peshkimit, planet e grumbullimit dhe akuakulturën.

Pyjet. Buxheti i shtetit 2008 i MMPAU me vlerë prej 2.6 milion euro do të shpenzohet kryesisht për ripyllëzim. Mbështetja e donatorëve për një nga komponentët që lidhet me projektin e Menaxhimit të Burimeve Natyrore, e financuar nga GEF, Suedia dhe BB, i është përkushtuar reformës institucionale në sektorin e pyjeve. Donatorë të tjerë në këtë fushë janë Suedia, e cila mbështet Shoqatën Kombëtare të Pyjeve dhe KfW, e cila mbështet menaxhimin e pyjeve në parkun kombëtar të Prespës.

Trajtimi i ujrave të zeza. Nga buxheti i shtetit për MPPTT, vetëm 0.9 milion euro i janë vënë në dispozicion trajtimit të ujrave të zeza. Impiantet e këtyre të fundit janë mbështetur nga KfW në Kavajë dhe KE/CARDS në Vlorë. Një nga komponentët e projektit të Menaxhimit të Integruar të Zonës Bregdetare është edhe ndërtimi i impianteve përpunuese të ujrave të zeza. BERZh po eksploron përdorimin e kredive në financimin e projekteve mjedisore, duke përfshirë uljen e ndotjes së ujit të detit.

Menaxhimi i mbetjeve të ngurta. Investimet publike në këtë fushë janë ndarë midis programit të mbështetjes së mbrojtjes së mjedisit të MMPAU-t dhe programit të shërbimit publik të MPPTT. Gjithsesi për vitin 2008 vetëm ky i fundit ka marrë fonde (në vlerën 1.5 milion euro). Mbështetja aktuale e donatorëve konsiston edhe në ndërtimin e gropave për trajtimin e mbetjeve të ngurta (landfill), financuar nga KE/CARDS dhe në mbështetjen institucionale (Suedia). Projekti më i madh i planifikuar është ai i përmirësimit të zonave të mbetjeve të ngurta për Tiranën (me financim të Italisë), ndërkohë që mbështetje e mëtejshme është planifikuar edhe për ndërtimin e gropave për trajtimin e mbetjeve të ngurta (landfill) (KE/CARDS)

Mbështetja e mëtejshme e donatorëve duhet të fokusohet në:

- përshtatjen e mëtejshme të standardeve ligjore me BE dhe përforcimi i legjislacionit

mjedisor

- investime në mbrojtjen e mjedisit me qëllim që standardet e BE-së të arrihen brenda 20 vjetëve
- investime në trajtimin e ujrave të zeza (veçanërisht në zonat turistike), mbedhjen, riciklimin e mbetjeve të ngurta (landfill), rehabilitimin e zonave të ndotura dhe burimeve të ndotjes, përmirësimin e teknologjisë në industrinë shtetërore
- përmirësimin e sistemit të monitorimit të mjedisit, veçanërisht monitorimit të cilësisë së ajrit
- mbështetjen e politikave të peshkimit për tu afuar me standardet europiane, në veçanti në fushën e menaxhimit të burimeve, mbikëqyrjes, inspektimit dhe kontrollit, dhe në politikat e tregjeve dhe ato strukturore
- projekte për inventarizimin e pyjeve dhe ruajtjen e tyre nga zjarret
- studime fizibiliteti për burimet ujore në 5 nga 6 basenet kombëtare ujore të mbetura, menaxhimin e ujërave të zeza dhe kanalizimeve si dhe monitorimin e cilësisë së ujrave të nëndheshëm.

## Teknologjia e informacionit dhe komunikimit

Strategjia ndërsektoriale për TIK mbulon dy fusha: (i) Zhvillimi i tregut të TIK që drejtohet nga politikë-bërësi (MPPTT) dhe zbatohet nga rregullatori Enti Rregullator i Telekomunikacionit; dhe (ii) modernizimi/dixhitalizimi i Qeverisë Shqiptare për të ofruar shërbime “online” për qytetarët, që drejtohet nga Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit (AKSHI) në bashkëpunim me agjencitë e tjera Qeveritare. Përsa i përket dixhitalizimit të institucioneve publike mbështetja e viteve të fundit nga donatorët është bërë në sistemin e arsimit, financuar nga PNUD, në rregjistrimin e bizneseve, e-taksa dhe e-prokurime, mbështetur nga Llogaria e Sfidës së Mijëvjeçarit e SHBA, sistemin e thesarit, financuar nga BB dhe në administrimin publik, nga Italia, KE, dhe PNUD.

Mbështetja e donatorëve në të ardhmen duhet të fokusohet në:

- rehabilitimin e infrastrukturës qendrore për 25 institucione të Qeverisë Shqiptare (LAN, server, kompjutera, etj.)
- Përshtatjen nga INSTAT të metodologjisë së EUROSTAT përsa i përket statistikave vjetore të TIK
- ngritjen e sistemit qendror të informacionit që ofron shërbime “online” për qytetarët për sa i përket: punësimin, doganave, arsimit, bibliotekave, licensave dhe lejeve, gjyqeve, rregjistrimit të pasurive dhe rregjistrimeve personale.

## 3.5 ZHVILLIMI SOCIAL

Megjithë suksesin ekonomik të Shqipërisë, niveli i të ardhurave në vitet 1990-të ishte ndër më të ultit në Europë. Zhvillimi i qëndrueshëm ekonomik e ka drejtuar tregun drejt reduktimit të varfërisë në Shqipëri. Prioriteti i katërt strategjik i SKZHI-së synon konsolidojë këtë progres duke përmirësuar aksesin në shërbimet shëndetësore dhe modernizuar arsimin për të arritur njohuritë që duhen për të ruajtur progresin në periudhën më afatgjatë. Investimet, si nga financimet e brendshme ashtu dhe të huaja, në sektorët socialë kanë qenë në proporcione pothuajse të barabarta. Ndhma e huaj e planifikuar për zhvillimin social ka qenë në nivele të ulëta dhe do të duhet të rritet në programimin për të ardhmen.

## Shëndetësia

Në përgjithësi, sektori drejtohet nga Strategjia e Shëndetësisë, ndërkohë që programet e buxhetit të Ministrisë së Shëndetësisë drejtohen edhe nga disa strategji ndërsektoriale duke përfshirë mjedisin dhe mbrojtjen e konsumatorit.

Krahasimet ndërkombëtare sugjerojnë se totali i shpenzimeve të Qeverisë për shëndetësinë është shumë më i ulët se shpenzimet e vendeve të ngjashme. Kjo adresohet nga drejtimet strategjike më të fundit të buxhetit të përcaktuara në SKZHI si dhe nga procesi i PBA-së ku shpenzimet në sektorin e shëndetësisë pritet të rriten me një normë më të shpejtë se mesatarja. Investimet e Qeverisë në sektorin e shëndetësisë gjatë viteve të fundit kanë qenë të ndara pothuajse në mënyrë të barabartë midis shërbimeve parësore dhe dytësore shëndetësore, me një kontribut të vogël në shëndetin publik dhe në planifikim. Donatorët vazhdojnë të japin ndihmë shtesë për sektorin, në nivele rreth 50% të investimeve të Qeverisë. Rreth 1/2 e ndihmës së donatorëve shkon për rindërtim të spitaleve, 1/4 shkon për planifikim dhe administrim, dhe 1/4 tjetër ndahet midis shëndetësisë primare dhe asaj publike. Planet e donatorëve për të ardhmen fokusohen më shumë në shëndetësinë primare, e cila është në të njëjtën linjë me prioritetet e SKZHI-së.

Planifikimi Shëndetësor. Megjithëse çështjet e shëndetësisë nuk paraqiten në mënyrë të qartë në kërkesat e BE-së tek *acquis communautaire*, ekziston një numër kapitujsh që përfshijnë çështjet dhe impaktin e sistemit të shëndetësisë në punësim, kuadrin institucional, shpërndarjen e shërbimeve për mbrojtjen e fëmijëve, shërbimet e arsimit, etj. Sektori i Shëndetësisë do të përfitojë nga zbatimi i projekteve IPA përmes fushave të mësipërme. Reformat në fushat e qeverisjes dhe financave shëndetësore do të vazhdojnë të mbështeten nga projektet në vazhdim të BB, Italisë, Zvicrës, Agjencisë së Kombeve të Bashkuara UNAIDS, dhe SHBA, ku shumicës së këtyre projekteve i duhen edhe disa vjet para se të përfundojnë. Projekte të planifikuara për të ardhmen janë projekte të reja nga SHBA, Suedia dhe Agjencitë e Kombeve të Bashkuara, por këto janë relativisht modeste, në krahasim me angazhimet në vazhdimësi.

Shërbimi Shëndetësor Primar. Qeveria po i kushton një vëmendje të veçantë përmirësimit të shërbimit shëndetësor primar duke synuar që shërbimet bazë shëndetësore të jenë lehtësisht të aksesueshme, me cilësi të pranueshme dhe efikasë në ofrimin e shërbimeve. Investimet e Qeverisë për kujdesin shëndetësor primar janë rreth 6.7 milion euro në 2008 duke përfshirë edhe një komponent të fortë për pushtetin vendor. BB ka qënë donatori më i madh që mbështet këtë fushë. Gjithashtu, donatorët e tjerë ofrojnë rreth 2.9 milion euro në investime, veçanërisht për kujdesin shëndetësor primar. Italia, Austria, Norvegjia dhe Suedia kanë dhënë fonde për rihabilitimin e shumë klinikave të vendit.

Shërbimi Shëndetësor Dytësor. Investimet e qeverisë në kujdesin shëndetësor dytësor janë rreth 14.5 milion euro në 2008. SKZHI synon të shkojë drejt një vetë-mjaftueshmërie më të madhe financiare në spitale. Megjithatë, gjendja aktual e spitaleve është akoma e prapambetur dhe mbështetja e donatorëve në këtë fushë është kritike. Mbështetja e donatorëve në këtë fushë në vitin 2007 vlerësohet të jetë rreth 8.6 milion euro, duke u përqëndruar kryesisht në rihabilitimin dhe ndërtimin e spitaleve dhe trainimin e personelit (IDB, OPEC, CEB, Greqia, dhe Zvicra).

Shëndeti Publik. Investimet e donatorëve në kujdesin shëndetësor publik e kanë tejkaluar financimin e kufizuar të Qeverisë. Mbështetja e donatorëve për kujdesin shëndetësor publik është llogaritur të jetë rreth 0.55 milion euro në vitin 2008. Donatori kryesor është SHBA që mbështet aktivitetet me temë planifikimin familjar, e ndjekur nga Italia, Gjermania dhe Norvegjia që mbështesin promovimin e shëndetësinë dhe punën me të rinjtë. Një projekt i rëndësishëm rajonal Suedez që synon luftimin e SIDA-s filloi në 2007. Mbështetje me ndihmë teknike është planifikuar edhe nga UNICEF dhe UNFPA.

Sfida kryesore është krijimi i një sistemi shëndetësor i cili është i aftë të ofrojë një shërbim primar shëndetësor, i cili të aksesohet lehtësisht, të ketë cilësi të konsiderueshme dhe të jetë efikas. Për të arritur këtë, duhet të ndryshohet mekanizmi bazë i organizimit, menaxhimit dhe

financimit, për të ruajtur dhe përmirësuar vazhdimisht shëndetin e popullsisë. Gjithashtu, ka disa iniciativa nga donatorët (Agjencitë e Kombeve të Bashkuara, Norvegjia, Italia dhe SHBA) për të përmirësuar aksesin e grupeve më të dobëta (duke përfshirë veçanërisht gratë, fëmijët dhe handikapët) drejt shërbimeve shëndetësore.

MSH po punon për të ndërtuar një përqasje me bazë sektori (SWAp) për kujdesin primar shëndetësor, në mënyrë që të sigurojë administrim të qëndrueshëm të ndihmës së huaj në të ardhmen.

Prioritetet kryesore strategjike në sektorin e shëndetësisë që duhen mbështetur nga donatorët në periudhë afatmesme dhe afatgjatë përfshijnë:

- rritjen e kapacitetit të MSH për të zhvilluar politika, strategji dhe planifikim në nivelin kombëtar
- futjen e skemave organizative të reja mikse, publike-private
- përmirësimin e sistemit financiar të shëndetësisë nëpërmjet riorganizimit të sistemit të sigurimit shëndetësor (ngritjen e politikave dhe e kapaciteteve) për të transformuar pagesën direkte nga xhepi në pagesa të rregullta mujore që të mundësojë njerëzit të marrin ndihmë shëndetësore kur kanë nevojë, duke kaluar në pagesën e kontributeve shëndetësore nga të gjithë
- ngritjen e sistemit të informimit shëndetësor
- përmirësimin e administrimit të qendrave dhe klinikave në të gjithë nivelet
- mbështetjen e administratës së spitaleve me ngritje të kapaciteteve si dhe me pajisje mjekësore dhe sisteme administrimi
- përmirësimin e skemës rregullore në mënyrë që të respektohen të drejtat e të gjithë aktorëve ku adresohen çështje si kujdesi ndaj qytetarëve, e drejta për shërbime specifike, privatizimi, roli i organizatave profesionale, legjislacioni i punës për profesionistët e shëndetësisë

## Arsimi

Tendenca më e fundit në shpenzimet për arsimin publik ka qënë negative gjatë periudhës së tranzicionit dhe në vitin 2004 arritën në 3.1% të PBB-së, ndërkohë kur mesatarja e vendeve të BE-së është 4.9%, fakt ky që ka pasur një impakt negativ në zhvillimin e arsimit. Strategjia e sektorit të arsimit bazë synon të garantojë një sistem modern kombëtar të arsimit, i cili do të stimulojë rritje të qëndrueshme ekonomike, konsolidimin e demokracisë dhe sukses në dialogun dhe konkurrencën me shtetet e rajonit e më tej. Sfidat kryesore për sektorin janë përmirësimi i cilësisë së mësimdhënies nëpërmjet decentralizimit dhe fuqizimit të autonomisë shkollore, përmirësimi i qeverisjes në ofrimin e shërbimit dhe futja e përgjegjshmërisë në sistem, pjesëmarrja e komunitetit dhe e të gjithë grupeve të interesit dhe rritja e transparencës.

Ristrukturimi i Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës dhe e të gjithë sistemit arsimor nëpërmjet një skeme të qartë përgjegjshmërie dhe përgjegjësie mbështetet përmes zbatimit të projektit në vazhdimësi 'Cilësi dhe Barazi në Arsim' i financuar nga BB, BEI dhe CEB. Projekti është ndërtuar në bazë të prioriteteve të SKZHI-së, si rritja e kapaciteteve të drejtorëve të shkollës dhe specialistëve të arsimit në nivel rajonal, dhe përfshirja e komunitetit për të luajtur një rol më aktiv në administrimin e shërbimit arsimor. Procesi do të shoqërohet me themelimin e Sistemit Informativ Administrativ Arsimor në të gjithë nivelet.

Arsimi parashkollor. Arsimi parashkollor është lënë pas dore në krahasim me nivelet e tjera arsimore. Bazuar në situatën parashkollore, në përpjekje për të ndërtuar një program të ri kombëtar për zhvillimin e adoleshencës, janë prezantuar modelet kontekstuale të Reggio-Emilia dhe "Step by Step" me mbështetjen e UNICEF dhe Fondacionit Soros. Spanja ka qënë shumë

aktive në mbështetjen e përmirësimeve në arsimin parashkollor dhe kujdesin e fëmijëve në periferi të Tiranës.

Arsimi bazë. Prioritetet kryesore të SKZHI-së për arsimin bazë janë: sigurimi i një sistemi arsimor me cilësi të lartë, gjithëpërfshirës, dhe fleksibël, i cili i përgjigjet kërkesave të ekonomisë së tregut; ofrimi i aksesit në arsimin bazë për të gjithë fëmijët; dhe rritja e normës së regjistrimit për arsimin sekondar në 75% në 2012. Rritja e numrit të nxënësve në arsimin bazë dhe përmirësimi i cilësisë kërkojnë ridizenjimin e shërbimeve të arsimit në përputhje me ndryshimet demografike në zonat urbane dhe rurale duke pasur parasysh grupet më të dobëta, e gjitha kjo mbështetur nga Suedia, Spanja dhe Italia, dhe CARDS. Prezantimi i reformës kurrikulare në mënyrë që të përmirësohet cilësia e arsimit, dhe përpjekjet e tjera që synojnë përmirësimin e monitorimit të performancës të sektorit të arsimit, janë akoma në fazën e tyre fillestare dhe akoma nuk kanë dhënë rezultate të dukshme. Reformat në arsimin bazë duhet të shoqërohen me zbatimin e një formule financimi ku qartësohen përgjegjësitë e financimit të të gjitha niveleve qeverisëse deri në 2009. Kjo përpjekje po mbështetet edhe nga projekti i BB “Cilësi dhe Barazi në Arsim”. Investimet në arsimin bazë janë bërë kryesisht nga Qeveria. Ndërsa donatorët si Spanja, Italia, dhe Suedia kanë mbështetur arsimin bazë me projekte të përqëndruara në trainimin e mësuesve, shëndetësi, rikonstruktimin e shkollave, laboratorë mësimi të rinj etj. Ndhima e tyre pritet të vazhdojë me zbatimin e projekteve të reja.

Arsimi i mesëm. Buxheti i shtetit ka dhënë financim të rëndësishëm për arsimin e përgjithshëm të mesëm. Përveç projektit të BB “Cilësi dhe Barazi në Arsim”, projekte të tjera në vazhdimësi të donatorëve janë të përqëndruara në rikonstruksionin e shkollave në veri nga Italia, Austria dhe Spanja dhe në jug nga Greqia, laboratorët e informatikës (specifikisht projekti “e-schools” i UNDP), dhe trainimi i mësuesve mbi të drejtat e njeriut (Greqia). Sfidat kryesore të cilat kërkojnë financim të kombinuar të Qeverisë me donatorët në të ardhmen përfshijnë përmirësimin e cilësisë së procesit të mësimdhënies dhe mësimit me përqëndrim në një kurrikul gjithëpërfshirëse, trainimin e mësuesve, fuqizimin e Institutit të Kurrikulës dhe Trainimit dhe Qendrën për Vlerësimin dhe Arritjen e Studentëve, zhvillimin e një plani kombëtar për vlerësimin në arsim, dhe përmirësimin e transparencës dhe integritetit të sistemit të provimit të Maturës Shtetërore.

Arsimi profesional. Gjatë viteve të fundit, Qeveria dhe donatorët kanë financuar ndjeshëm për të përmirësuar arsimin profesional. Donatorët kryesorë kanë qenë KE/CARDS (me rreth 6 milion euro gjatë tre viteve të fundit), Zvicra, Italia dhe Austria (trainim profesional në turizëm dhe agrikulturë). Mbështetje e mëtejshme nga donatorët do të nevojitet për ndërtimin e infrastrukturës në shkollat profesionale, rritjen e kapacitetit të mësuesve dhe ndihmë për reformën në arsimin profesional, kurrikula, studime mbi nevojat e tregut, shkëmbim eksperiencash, etj.

Arsimi universitar. Sfidat kryesore në arsimin universitar përfshijnë përmirësimin e skemës institucionale dhe ligjore për arsimin e lartë; themelimin e një sistemi efektiv të akreditimit; autonomi institucionale të universiteteve; integrimin e mësimdhënies dhe punës kërkimore; dhe përmirësimin e sistemit financiar të arsimit të lartë. Fondet qeveritare për arsimin universitar zënë rreth 24% (2006-08) të buxhetit të shtetit. Në 2008, vlera totale e investimeve publike të brendshme do të jetë 10 milion euro. Financimi nga donatorët për arsimin universitar përfshin angazhime të mëdha nën programin Tempus së bashku me një projekt të madh italian që mbështet ndërtimin e një qendre post universitare dhe një rrjet telematik midis universiteteve shqiptare. Projekte të mëdha që përfshijnë shkëmbimin kulturor, ndërtimin e librarive, trainimin e mësuesve dhe administrimin e arsimit të lartë mbështeten nga Greqia, Gjermania dhe Zvicra, së bashku me ndihmën nga Austria dhe Spanja. Shumë donatorë si Japonia, SHBA, Gjermania, Italia, Holanda dhe Austria kanë dhënë bursa studimi.

Mbështetja e donatorëve në të ardhmen duhet të fokusohet në reformën në të gjitha nivelet e arsimit, si një nga prioritetet më të mëdha të Qeverisë. Vazhdimësia e përjasjes me bazë sektori (SWAp) aktual në sektorin e arsimit do të jetë e nevojshme. Çdo plan në të ardhmen në

mbështetje të sektorit mbas përfundimit të angazhimeve aktuale inkurajohet të përdorë format të ngjashëm, i cili ka rezultuar efikas për autoritetet kombëtare të arsimit.

Fushat më prioritare që kanë nevojë për ndihmën e donatorëve në periudhën afatmesme janë:

- kapaciteti administrativ për të përmirësuar qeverisjen me përqëndrim në rikonstruksionin e MASH dhe të të gjithë sistemit arsimor nëpërmjet një skeme të qartë përgjegjësie midis institucioneve, deri në nivelin e punëve individuale
- monitorimi i zbatimit të strategjisë së decentralizimit në shkollat primare dhe sekondare
- konstruksion dhe rikonstruksion të shkollave me një përqëndrim në nivelet e arsimit para-universitar
- krijimi i Sistemit të Menaxhimit të Informacionit për Administrim Arsimin në të gjithë nivelet, në të gjitha nivelet
- përmirësimi i procesit të mësimdhënies dhe të mësuarit, duke fuqizuar Institucionin e Kurrikulës dhe Trainimit
- përmirësimi i efikasitetit të skemave financiare të arsimit duke synuar në një rritje të ndihmës financiare nga Pushteti vendor
- zgjerimi i provizionit të arsimit para-shkollor duke u bazuar në modelet kontekstuale dhe para-shkollore (duke u aplikuar) të Reggio-Emilia dhe Step by Step, nëpërmjet modeleve të programeve kombëtare; shpërndarja e shërbimeve të fëmijërisë në grupet më të prekura, veçanërisht por jo ekskluzivisht në Shqipërinë veri-lindore, ndërtimi i kopshteve të reja
- mbështetje e vazhdueshme për qendrat e trainimit të hapur profesional në rajonet e tjera të Shqipërisë
- standarte ndërkombëtare për të plotësuar kërkesat e procesit të Bolonjës
- fuqizimi i kapacitetit të universiteteve mbi fushat e shkencës dhe punës kërkimore

## **Punësimi, emigracioni dhe barazia gjinore**

### **Punësimi**

Vizioni i strategjisë së punësimit dhe trajnimit profesional i cili është bazuar në Strategjinë e Lisbonës, është përmirësimi i cilësisë së shërbimeve që jepen për punëkërkuesit dhe punëdhënësit nëpërmjet përmirësimit të shërbimeve të punësimit, zbatimit më efektiv të programeve të tregut të punës, arsimit dhe trajnimit profesional si dhe arritjes së niveleve të pranueshme për integrim më të shpejtë rajonal dhe europian.

Sfidat më të vështira që kemi përpara janë forcimi i kapaciteteve të zyrave të punës që ato të luajnë një rol efektiv ndërmjetësimi midis tregut të punës dhe forcës së punës; përmirësimi dhe unifikimi i metodave të punës; përmirësimi i kontakteve me ndërmarrjet dhe zhvillimi i partneritetit; përdorimi i teknologjisë së informacionit për të përmirësuar cilësinë e shërbimeve të punësimit.

Përmirësimi i arsimit profesional dhe sistemit të trajnimeve në bashkëpunim me MASH-in janë prioritetet e SKZHI për vitet në vijim. Hartimi i legjislacionit mbi inspektimin e punës, shëndetin dhe sigurinë në vendin e punës në përputhje me politikat e BE-së si dhe reduktimi i tregut joformal të punës, përfshirë këtu rritjen e bashkëpunimit midis Inspektoriatit të Lartë të Punës, administratës së tatim taksave, policisë si dhe Shërbimit Kombëtar të Punës por edhe përfshirja të zonave të kontrollit përtej zonave urbane janë prioritetet e SKZHI-së për inspektimin në punë.

Investimet e Qeverisë në këtë sektor kanë qenë të kufizuara dhe të përqëndruara kryesisht në rinovimin e zyrave të punës. Investimet në shëndetësi dhe në sigurimin në punë ose në punën e Inspektoriatit të Lartë të Punës kanë qënë shumë të kufizuara.

Zvicra mbështet projekte që kanë si objektiv shëndetin dhe sigurinë në punë. Disa donatorë të tjerë si Italia, SHBA, Gjermania, Suedia janë aktivë në mbështetje të përpjekjeve për të reduktuar tregun informal të punës. Italia dhe Suedia mbështesin Shërbimin Kombëtar të Punës me një angazhim prej 1.8 milion euro. Pjesa më e madhe e kësaj mbështetje përfundon në 2007. KE/CARDS planifikon të fillojë në fillim të vitit 2008 një projekt prej 1 milion euro për mbështetjen e Zyrave Rajonale të Punës dhe aktiviteteve të inspektimit të punës. Organizata Ndërkombëtare e Migracionit dhe Italia janë të përfshira në konsolidimin e shërbimeve rajonale të punësimit (trainime për shërbimet e emigracionit, ngritja e zyrave të këtyre qendrave dhe paisja e tyre).

Fusha të rëndësishme ku mund të jetë e nevojshme ndihma e huaj në të ardhmen janë:

- zyrat rajonale të punës
- rritja e kapaciteteve për Ministrinë e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta për të hartuar programe për nxitjen e punësimit
- mbështetja për programet e punësimit për grupet në nevojë siç janë romët dhe gratë
- mbështetja institucionale për Inspektoriatin Shtetëror të Punës për të hartuar legjislacionin mbi shëndetin dhe sigurinë në vendin e punës në përputhje me direktivat e BE-së si dhe rritjen e bashkëpunimit me administratën e tatim taksave si dhe agjensitë e tjera shtetërore për të luftuar informalitetin
- reforma e sistemit të arsimit profesional përfshirë këtu hapjen e qendrave dhe shkollave të reja profesionale, modernizimi i kurrikulës si dhe zhvillimi institucional (për shembull: Këshilli Kombëtar i Arsimit dhe Trajnimit Profesional, Agjencia Kombëtare e Trajnimit dhe Arsimit Profesional, një mekanizëm kombëtar për trajnim punësimi, etj)

## Migracioni

Shqipëria është një nga vendet me përqindjen më të lartë të migracionit në botë, me rreth 20% të popullatës që jeton jashtë vendit. Strategjia ndersektoriale për migracionin përfshin jo vetëm MPÇSSHB por edhe MPJ, MASH, MF dhe METE. Migracioni përbën një aspekt shumë të rëndësishëm të marrëdhënieve të Shqipërisë me vendet anëtare të BE-së të cilat janë dhe destinacioni kryesor i shumicës së emigrantëve shqiptarë. Duke qenë se në shumë raste Shqipëria konsiderohet si vend i botës së tretë për sa i përket migracionit, lufta kundër emigrimit të paligjshëm është një nga prioritetet kryesore të vendit.

Sfidat kryesore për të ardhmen janë: lufta kundër emigracionit ilegal duke marrë masa si për shembull zbatimi i Marrëveshjes së Ripranimit me BE-në; përmirësimi i imazhit të emigrantëve shqiptarë jashtë vendit; përmirësimi i shërbimeve konsullore dhe diplomatike në vendet që presin emigrantë; mbrojtje e të drejtave të emigrantëve shqiptarë; mobilizimi i komunitetit shqiptar në botë; drejtimi i dërgesave të emigrantëve drejt investimeve; lufta kundër fenomenit të ikjes së trurit nëpërmjet bashkëpunimit me institucionet ndërkombëtare për të zhvilluar programe që tërheqin studentët për të përdorur aftësitë e tyre në vend.

Ka shumë projekte në vazhdim por edhe të planifikuara që fokusohen në çështjet e migracionit. Tre nga këto programe financohen nga KE/CARDS, ndërkohë që një tjetër mbështetet nga UNHCR. Një nga projektet e KE/CARDS po zbatohet nga IOM dhe mbështet strategjinë e migracionit (që udhëhiqet nga MPÇSSHB) duke mbështetur rritje të kapaciteteve, pajisje, mbështetje dhe monitorim. Italia ka financuar një projekt që analizon impaktin e dërgesave të emigrantëve në Shqipëri si dhe krijimin e një sistemi të integruar të dërgesave të emigrantëve,

e implementuar nga IOM. Ndërsa PNUD në bashkëpunim me Qeverinë mbështet projektin “Brain Gain”.

Mbështetja e donatorëve është e nevojshme për:

- riintegrimin e emigrantëve
- sistemin e menaxhimit kombëtar për emigrimin përfshirë këtu strukturën institucionale dhe një sistem për rregjistrimin e qytetarëve të vendeve të treta që kthehen në Shqipëri
- arsimimin cilësor dhe rritjen e ndërgjegjësimit të të rinjve në çështjet e emigrimit
- tërheqjen e studentëve që mbarojnë studimet jashtë për të përdorur aftësitë e tyre në vend

## Barazia Gjinore

Përveç MPÇSSHB, në implementimin e prioriteteve të SKZHI-së për barazinë gjinore dhe dhunën në familje janë të përfshira dhe disa ministri të tjera. Momentalisht, buxheti i shtetit mbështet Departamentin e Shanseve të Barabarta me një shumë prej 0.2 milion euro. Gjashtë projekte donatorësh, nga Agjencitë e Kombeve të Bashkuara, Austria, Italia dhe PNUD japin një mbështetje prej 0.9 milion euro në vitin 2007. Dy projekte nga PNUD dhe Austria (në total 0.2 milion euro) mbështesin gratë në proceset vendimmarrëse. Tre projekte me vlerë totale prej 0.36 milionë euro dhe të udhëhequra nga UNFPA mbështesin Institutin e Shëndetit Publik duke vënë theksin në çështje që kanë të bëjnë me shëndetin e gruas dhe barazinë gjinore. Katër projekte (Italia, Holanda, Norvegjia dhe Spanja) japin mbështetje për Departamentin e Punës me një vlerë prej 0.3 milion euro në 2007 dhe e përqëndruar tek punësimi i grave dhe emancipimi i tyre. Shifrat e vitit 2007 përfshijnë mbështetjen e BB, CEB dhe BEI me një vlerë prej 10 milion euro nga projekti “Cilësi dhe Barazi në Arsim” (investime, shpenzime operacionale dhe mirëmbajtje). Gjithashtu, IPA do të ofrojë mbështetje socio-ekonomike në këtë fushë. Shumë donatorë të tjerë mbështesin aspekte të ndryshme të barazisë gjinore dhe kjo në termat e programimit më të gjerë ose nëpërmjet NGO-ve, p.sh. Suedia (përmes projektit gratë për gratë), Austria, UNIFEM, Italia dhe Holanda.

Sfida më e madhe e sektorit është që gratë të mundesohen të kenë pjesëmarrje të barabartë në vendimmarrje, të kenë të drejta të barabarta për shkollim, punësim, të mund të përdorin shërbimet publike dhe të gëzojnë rezultatet e punës së tyre. Është thelbësore që kushdo që preket nga dhuna në familje të mund të përdorë informacionin si mjet mbrojtje nëpërmjet akteve ligjore, këshillimeve shëndetësore dhe mbrojtjes sociale, që shenjat e para të dhunës të trajtohen dhe parandalohen dhe shkaktarët e dhunës të përgjigjen para ligjit për aktet e tyre. Donatorët kryesorë që mbështesin parandalimin e dhunës në familje janë Holanda, Kanadaja, OSBE-ja dhe PNUD-i.

Mbështetja e donatorëve do të jetë e rëndësishme për:

- prezantimin e programeve globale të ndërgjegjësimit për edukimin ndaj çështjeve shëndetësore më shumë në zonat rurale, mbështetje për gratë në zonat rurale që të kenë mundësi të përdorin shërbime shëndetësore, përmirësimi i teknologjisë së informacionit.
- Përmirësimin e kuadrit ligjor dhe institucional që garanton barazinë gjinore nëpërmjet amendimeve në barazinë gjinore dhe legjislacionin e sigurimeve shoqërore, përmirësimi i statistikave të dhunës në familje nga Policia e Shtetit si dhe krijimi i bordi ankesash për rastet e diskriminimit
- mbështetjen e grave në nevojë nëpërmjet forcimit të strukturave publike që trajton viktimat e dhunës dhe trafikimit veçanërisht në zonat rurale si dhe të programeve që kanë për qëllim riintegrimin e tyre
- dhënien e mbështetjes sociale viktimave nëpërmjet strehimit, veprimeve policore,



shërbimeve sociale, shërbimeve shëndetësore në nivel lokal, si dhe mundësive të tjera për të rindërtuar jetën e tyre

## Kultura dhe Rinia

Kultura. Sfidat kryesore në SKZHI-së përsa i përket kulturës fokusohen në përmirësimin e standarteve të menaxhimit dhe trajtimit të trashëgimisë kulturore dhe përafrimi i këtyre standarteve me ato të vendeve europiane bazuar në politikën komunitare “të bashkuar në larmi”. Mbështetja e Qeverisë për aktivitetet kulturore kombëtare është e kufizuar. Pjesa më e madhe e investimeve në këtë sektor shkojnë për trashëgiminë kulturore (kryesisht për restaurimin e ndërtesave të trashëgimisë kulturore/qendrave dhe muzetë) si dhe për artin dhe kulturën (kryesisht për Teatrin Kombëtar dhe për Qendrën Kombëtare të Kulturës). Mbështetja e donatorëve me një vlerë prej 2.8 milion euro, është fokusuar në menaxhimin dhe restaurimin e trashëgimive arkeologjike, ndërtesat kulturore dhe studime arkeologjike. Kjo përfshin projekte nga donatorë të ndryshëm dypalësh si Austria, Suedia, Holanda, Franca, Zvicra si dhe një projekt i Këshillit të Europës. BB është e angazhuar në ruajtjen e Parkut Kombëtar të Butrintit.

Rinia. Dokumenti i SKZHI-së vë theksin në ngritjen dhe mundësimin e një mjedisi i cili do të inkurajojë pjesëmarrjen e të rinjve në hartimin e politikave dhe procesin e vendimmarrjes në nivel kombëtar me qëllim rritjen e ndërgjegjësimit për rolin e të rinjve në ndërtimin e shoqërisë, në fushën e kulturës dhe në atë socio-ekonomike. Të rinjtë duhet të shihen si një partner i vërtetë në qeverisje, duke pasur parasysh përgjegjësinë direkte të tyre në zhvillimet e sotme ekonomike në vend. Ka një sërë donatorësh që mbështesin rininë në përgjithësi (Italia, Austria, Kanadaja) por edhe duke u fokusuar në sektorë veçanërisht tek shëndetësia (UNFPA, Italia, Norvegjia) dhe në drejtësi (Suedia, Holanda, Norvegjia)

Mbështetja e donatorëve duhet në mënyrë të veçantë për:

- rehabilitimin e mëtejshëm dhe restaurimin e infrastrukturës së trashëgimisë kulturore
- shkëmbimin kulturor ndërkombëtar
- katalogimin elektronik të pasurive kulturore dhe rritjen e aksesit të publikut
- zhvillimin e infrastrukturës që ka të bëjë me kulturën dhe artet duke përfshirë rehabilitimin e teatrove dhe qendrave kulturore
- përmirësimin e legjislaturës për pronësinë intelektuale
- Rritjen e kapaciteteve të organizatave të rinisë dhe mbështetjen e krijimit të Agjencisë Kombëtare të Rinisë
- nxitjen e shëndetit dhe mbrojtjes sociale për të rinjtë
- nxitjen e të drejtave të njeriut dhe të kulturës vullnetare midis të rinjve

## Mbrojtja Sociale, përfshirja dhe sigurimet

### Mbrojtja sociale

Mbrojtja sociale në formën e pagesës direkte ndaj njerëzve në nevojë, zë një vend të konsiderueshëm në buxhetin e shtetit, nga 0.8% në 0.4% të PBB-së gjatë viteve 2000-2005. Njësitë e qeverisjes vendore shpërndajnë ndihmë ekonomike familjeve përfituese bazuar në një seri kriteresh komplekse, shpesh të ideuara për të përjashtuar aplikantët më shumë sesa për tju përshtatur nevojave të tyre. Sidoqoftë, mosfunksionimi i përgjithshëm në këtë fushë nuk është më i madh krahasuar me vendet e tjera. Grupe të tjera në nevojë mbështeten janë vlerësuar nga sistemi i mbrojtjes sociale, i cili siguron shërbime rezidenciale dhe ditore. Këto institucione

ju shërbejnë jetimëve, handikapëve, viktimave të trafikimit dhe personave me probleme sociale, duke përfshirë problemet psiqike dhe ato të abuzimit me drogën. Politika e asistencës sociale është mbështetur kryesisht nga projekti “Shpërndarja e Shërbimeve Sociale”, projekt i përbashkët i DfID dhe EB, i cili është drejt përfundimit. Prioritetet e tjera të kësaj fushe mbështeten nga katër projekte të BB dhe CARDS në bashkëpunim me Këshillin e Europës. Këto projekte arrijnë një total prej 16 milion euro gjatë një harku kohor 4 deri 7 vjet. Shumë nga donatorët dypalësh kanë programe në mbështetje të mbrojtjes sociale ku shumë prej tyre janë të zbatuara nga OJF-të. Të gjitha projektet që janë në vazhdim do të përfundojnë në mes të 2008.

Sfidat kryesore të këtij sektori mbeten: rishikimi i skemës së asistencës sociale, përmirësimi i përcaktimit të përfituesve kryesorë me të ardhura në dorë, veçanërisht përfitimi nga ndonjë zbulim pas përfundimit të reformës së rregjistrimit civil, përmirësimi i përcaktimit të skemës së asistencës sociale, përmirësimi i vlerësimit të familjeve aplikante, dhe përmirësimi i administrimit të subvencionit për energjinë.

Politikat e kujdesit social do të inkurajojnë sigurimin e shërbimeve për personat në nevojë brenda familje dhe komunitetit në vend të pranimit të tyre në qendra rezidenciale. Prioritetet strategjike të kësaj reforme përfshijnë: decentralizimin e shërbimeve sociale, transferimin e qendrave të shërbimit rezidencial nën kompetencën e pushtetit lokal, krijimin e shërbimeve sociale të reja në komunitet, institucionalizimin e marrëdhënieve midis organizatave jo-qeveritare si sigurues të shërbimeve sociale dhe si mbrojtës të të drejtave dhe interesave të grupeve në nevojë, dhe transformimi gradual i shërbimeve rezidenciale në shërbime të bazuara në komunitet apo të lëvizshme.

Mbështetja e donatorëve duhet në mënyrë të veçantë për:

- përgatitjen e hartës së re të varfërisë që do të bazohet në rezultatet e Censurit 2011, si dhe në vazhdimin e Anketës të Matjes së Nivelit të Jetesës, të cilat në të kaluarën janë financuar nëpërmjet një komponenti të Projektit për Shpërndarjen e Shërbimeve Sociale
- rritjen e kapaciteteve dhe trajnimin e nëpunësve të qeverisjes vendore për rishikimin e skemës së asistencës sociale dhe shpërndarjen e shërbimeve sociale
- përmirësimin e sistemit të monitorimit

## Përfshirja Sociale

Strategjia Ndërsektoriale e Përfshirjes Sociale fokusohet në rrezikun e varfërisë që mbetet edhe pas fillimit të rritjes ekonomike. Ajo është një përmbledhje e strategjive sektoriale dhe ndërsektoriale që kanë për qëllim ndihmën e individëve, familjeve dhe grupeve në nevojë, fëmijëve, romëve dhe personave me aftësi të kufizuara, në mënyrë që ato të mund të operojnë vetë dhe të kenë të drejta të barabarta me anëtarët e tjerë të shoqërisë. Zbatimi i prioriteteve të sipërpërmendura përfshin ministri të ndryshme.

Ka rreth 25 projekte në vazhdim me vlerë totale 13 milion euro. Dhjetë projekte fokusohen tek fëmijët dhe zënë 70% të vlerës totale. Këto projekte financohen nga SHBA, Gjermania, Itali, Spanja, Austria, Zvicra dhe Agjencitë e Kombeve të Bashkuara. Gjashtë projekte të tjera me një vlerë prej 2 milion euro janë planifikuar nga të njëjtët donatorë. Të gjitha këto projekte pritet të përfundojnë brenda 12 muajve të ardhshëm.

Ndihma e donatorëve duhet të mbështesë Qeverinë për:

- përmirësimin e statusit të komunitetit rom nëpërmjet institucionalizimit të politikave dhe programeve për reduktimin e varfërisë, për të reduktuar diskriminimin dhe arritur integrimin e tyre në shoqëri
- regjistrimin e komunitetit Rom, trajnim profesional dhe aplikimin e programeve të tjera të

edukimit, vendosjen e rregullit, ofrimin e shërbimeve shëndetësore ne komunitetin rom dhe nxitjen e planifikimit familjar, vaksinimin, kujdesin gjatë dhe pas shtatëzanisë

- mbështetjen e progresin që po bëhet në kujdesin ndaj personave me aftësi të kufizuar për ta sjellë atë më afër normave të BE-së. Kjo mund të përfshijë prezantimin e programeve të identifikimit paraprak dhe parandalimit të paaftësive, koordinimin e shërbimeve shëndetësore dhe sociale për të qenë në të njëjtën linjë me politikën e decentralizimit të kujdesit social, dhe integrimin e kurrikulave arsimore dhe proceseve mësimore.

## Sigurimet shoqërore

Rishikimi i fundit i sistemit të sigurimeve shoqërore nxorri në pah shqetësimin për qëndrueshmërinë afatgjatë të sistemit në raport me popullatën që nuk do të ketë sigurim shoqëror në të ardhmen si dhe faktin që vlera e pensionit në krahasim me rrogën mesatare do të vazhdojë të bjerë. Sfidat kyçe janë zëvendësimi i sistemit “Pay As You Go” me një sistem sigurimesh shoqërore shumë shtyllash duke mbrojtur interesat fiskale të shtetit, nevojat e pensionistëve dhe të drejtat e kontribuesve. Donatori kryesor në këtë sektor është BB që drejton projektin “Shpërndarja e Shërbimeve Sociale” me një total prej 9 milion euro dhe që mbështet reformën e politikave për pensionet nëpërmjet programit në mbështetje të politikave të zhvillimit. Ky sektor ka patur dhe mbështetjen e projektit CARDS i cili përmes një projekti me vlerë 0.7 milionë euro mbështet reformën e sigurimeve shoqërore, përfshirë këtu dhe ndihmën e papunësisë.

Ndihma e donatorëve duhet të mbështesë Qeverinë për:

- të modernizuar sistemin e sigurimeve shoqërore

## 3.6 ZHVILLIMI TERRITORIAL

Zhvillimi territorial është një kategori e përdorur si në dokumentin e SKZHI-së, ashtu edhe në skemën e planifikimit të BE-së. Kjo fushë përfshin një numër sektorësh që merren me zhvillimin e zonave të ndryshme në vend duke përfshirë zhvillimin rajonal, rural dhe lokal, bujqësinë dhe turizmin, dhe planifikimin urban duke promovuar zhvillimin ekonomik në disa nga zonat e vendit. Shumë nga aktivitetet e MTKRS përfshihen këtu nga lidhja e disa programeve madhore me turizmin. Zhvillimi territorial mbulon si nxitjen e zhvillimit ekonomik ashtu edhe aktivitete në ndihmë të infrastrukturës, dhe këtë vetëm atëherë kur janë të planifikuara dhe të menaxhuara në nivel lokal. Ndihma e huaj mbulon rreth 60% të investimeve totale në këtë fushë dhe luan një rol shumë të rëndësishëm në zhvillimin rural. Përqindja e financimeve të huaja për zhvillimin territorial kundrejt totalit të ndihmës së huaj për periudhën afatmesme do të qëndrojë e njëjtë, por nivelet e ulëta të mbështetjes të zhvillimit rural, dhe planifikimit urban dhe hapësinor janë një shqetësim për Qeverinë Shqiptare dhe duhet të adresohen nga donatorët për t'u programuar në të ardhmen.

## Bujqësia dhe zhvillimi rural

Strategjia e sektorit të bujqësisë identifikon këto prioritete strategjike: rritjen e mbështetjes financiare (transferimin e pagesave ose kredive) për fermat dhe bizneset agro-industriale duke i kushtuar vëmendje të veçantë disa prodhimeve bujqësore; përmirësimin e menaxhimit të sistemit të kullimit dhe ujitjes; përmirësimin e marketingut bujqësor dhe produkteve të përpunuara; përmirësimin e nivelit dhe cilësisë së teknologjive, informacionit dhe njohurive të aplikuara nga fermerët dhe bizneset agro-industriale. Sfidë kryesore e këtij sektori lidhet me rritjen e prodhimtarisë dhe konkurrencës në sektorin e bujqësisë dhe në atë të industrisë së përpunimit si brenda dhe jashtë vendit, mbështetur kjo nga një ekonomi e bazuar në tregun e lirë dhe nga një kornizë ligjore sipas standardeve europiane.

Menaxhimi i infrastrukturës së kullimit dhe ujitjes. Buxheti i shtetit 2008 do të financojë 5.25 milion euro për investime publike në këtë program. Gjysma e këtyre fondeve do të vihet në dispozicion të ndërhyrjeve për mbrojtjen nga përmbytjet dhe të pajisjeve për kullim. Gjysma tjetër e fondeve të do të jetë pjesa e bashkëfinancuar nga BB, OPEC dhe Kuvajti për projektin e Menaxhimit të Burimeve Natyrore. Asnjë donator tjetër nuk po mbështet infrastrukturën rurale, ndonëse Italia dhe Greqia kohët e fundit kanë përfunduar projekte për kullimin.

Mbështetja e prodhimit bujqësor blegtoral agroindustrial dhe marketingu. Buxheti i shtetit për vitin 2008 do të financojë 1.9 milion euro investime publike nën këtë program, nga të cilat 0.8 milion euro do të jenë grante konkurruese për njësitë e qeverisjes vendore për ngritjen e pikave të grumbullimit dhe tregjeve. Pjesa e ngelur është kryesisht bashkëfinancime në projektet me donatorët, si p.sh projekti i Zhvillimit të Qëndrueshëm për Zonat Rurale Malore i cili mbështet Agjencinë e Zhvillimit të Zonave Malore (MADA) financuar nga Fondi Ndërkombëtar për Zhvillimin Bujqësor (IFAD); projekti 2KR (Japoni), si dhe Projekti i Shërbimit Bujqësor i BB. Gjithashtu edhe donatorë të tjerë dypalësh kanë mbështetur aktivitetet e prodhimit bujqësor dhe marketingut. Këtu mund të përmenden Italia (projekt që po zbatohet pjesërisht nga FAO), Spanja, Zvicra dhe Gjermania. Po kështu IPA ka të ngjarë të mbështesë me grante ndërmarrjet rurale pasi Shqipëria të ketë fituar statusin e shtetit kandidat për në BE. Ndërkohë, ekziston mundësia për donatorët dypalësh për të mbështetur zhvillimin e kapaciteteve për studime fizibiliteti, vlerësime të mjedisit, analiza tregu dhe për të asistuar qeverinë në zhvillimin e një strategjie të përbashkët për të mbështetur prodhimin bujqësor blegtoral agroindustrial dhe marketingun.

Këshillimi dhe Informacioni bujqësor. Nën këtë program fondet e akorduara nga Qeveria për investime publike arrijnë në 0.5 milion euro, të cilat do të përdoren kryesisht për ndërtimin dhe paisjen e qendrave të transferimit të teknologjisë bujqësore. Një nga komponentët e projektit të Shërbimit Bujqësor (BB) si dhe të projekteve nga tre donatore dypalësh (Italia, Franca, Austria) mbështesin shërbimin këshillimor. Donatorët në të ardhmen mund të mbështesin këshillimin dhe kërkimin shkencor përmes projekteve me spektër të gjerë sektorial që përfshijnë edhe reformën e politikave bujqësore.

Menaxhimi i qëndrueshëm i tokës bujqësore dhe regjistrimi i fermave. Ngritja e sistemit të informacionit bujqësor është e lidhur ngushtësisht edhe me angazhimet e integritit ndërkombëtar si dhe nga nevoja për të menaxhuar programet mbështetëse të BE-së në të ardhmen. Mbështetja e donatorëve në këtë program përfshin komponentë të projekteve të Shërbimit Bujqësor si dhe projektit të Menaxhimit të Tokës dhe Planifikimit Urban (të dyja këto projekte financohen nga BB). IPA/MIPD përfshin angazhime për mbështetje në të ardhmen të zhvillimit të sistemit të informacionit.

Zhvillimi Rural. Parë nga këndvështrimi i progresit që pritet drejt rrugës së integritit evropian, si dhe faktit që IPA për zhvillimin rural (IPARD) pritet të jetë së shpejti burimi dominues i fondeve për zhvillimin rural, strategjia ndërsektoriale e zhvillimit rural është ideuar në mënyrë të tillë që ta përgatisë vendin për ngritjen e mekanizmave të nevojshme për të thithur ndihmën financiare në të ardhmen. Kjo strategji ka përcaktuar prioritetet për periudhën 2007-2013 në përputhje me katër shtyllat kryesore të zhvillimi rural të IPA-s, të cilat janë konkurrenca e fermave, mjedisi, cilësia e jetës dhe kapacitetet e institucioneve lokale. Fondet nga buxheti i shtetit sigurohen kryesisht nëpërmjet MBUMK (nën programin e prodhimit dhe marketingut) si dhe përmes granteve të kushtëzuara apo jo të kushtëzuara të njëjësive të pushtetit vendor. Mbështetja e donatoreve është përqendruar në disa institucione specifike, siç janë MADA (IFAD) dhe Fondi Shqiptar i Zhvillimit (BB, CARDS, Gjermania, Italia, IDB); në zona të veçanta rurale (CARDS, PNUD, Gjermani, Greqi, Austri, Zvicër, Spanjë) ose në financimin e mekanizmave që do bëjnë të mundur zhvillimin, të tilla si unionet e kredive ose bujqësia e qëndrueshme. IPA për zhvillimin rural do të jetë burimi financiar dominues pasi Shqipëria të marrë statusin e vendit kandidat për në BE. Një projekt i ri i USAID (2007-2012) ka për qëllim përmirësimin e konkurrencës së sektorit privat në sektorin e bujqësisë dhe ngritjen e sistemit të informacionit në bujqësi i cili do mundësojë zhvillimin rural në vend. IPA 2008 mund të mbështesë zhvillimin rural duke filluar nga institucionet ekzistuese dhe duke vazhduar më pas me mbështetjen dhe zhvillimin e Agjencisë së Pagesave Rurale.

Fushat që kërkojnë mbështetjen e donatoreve për periudhën afatshkurtër dhe afatmesme janë:

- mbështetja për zhvillimin e strategjisë për përdorimin e tokës, të tregjeve të tokës, zhvillimin rural, shumëllojshmërinë e aktiviteteve në ferma dhe nxitjen e konkurrencës bujqësore
- vlerësimi i përjasjes së ndërmarrjeve agro-përpunuese të ushqimit me kërkesat e BE-së, përgatitja e programit për përmirësimin e tyre dhe fillimi i zbatimit të këtij programi
- sigurimi i kontrollit të vazhdueshëm për prodhimin e bimëve në vend, në veçanti të produkteve që kanë kërkesa specifike nga BE, dhe ngritja e kapaciteteve analitike në sektorin fitosanitar
- ndërtimi i infrastrukturës së tregjeve bujqësore duke i vënë theksin rritjes së efikasitetit të tregjeve ekzistuese të shumicës
- mbështetja për skemat e kredive të buta, bankave rurale dhe dhënies së kredive të garantuara me qëllim modernizimin e fermave dhe bizneseve dhe rritjes së konkurrencës së produkteve në treg
- mbështetja e prodhimit bujqësor dhe atij të produkteve të përpunuara bujqësore
- përmirësimi i menaxhimit të kullimit dhe ujitjes
- mbështetja e Qendrave të Informacionit Bujqësor dhe Qendrave të Transferimit të Teknologjisë Bujqësore
- forcimi i metodave të reja të këshillimit, si shkollat e fermerëve dhe zhvillimi i teknologjisë me pjesëmarrje, si dhe ristrukturimi i metodave kërkimore për t'iu përgjigjur sa më mirë nevojave të fermerëve
- përmirësimi i sistemit të identifikimit të gjedhëve dhe regjistrimit të lëvizjeve të tyre dhe përmirësimi i sistemit të identifikimit dhe regjistrimit të lëvizjeve të kafshëve
- mbështetja institucionale për shoqatat e fermerëve

## Zhvillimi Rajonal

Sfidat kryesore për strategjinë ndërsektoriale të zhvillimit rajonal për periudhën 2007-2013 do të jenë:

- Një politike e vetme për zhvillimin socio-ekonomik të qarqeve (Programi Kombëtar për Zhvillimin e qarqeve), një dokument i vetëm programimi për zhvillimin socio-ekonomik të qarkut (Strategjia për Zhvillimin e Qarkut) dhe një agjenci e vetme vendore që të koordinojë zbatimin e saj.
- Një plan i Qeverisë për Zhvillimin e Zonave të Pafavorizuara dhe krijimin e një zëri të veçantë buxheti për të mbështetur strukturat e zhvillimit të qarqeve të pafavorizuara sikurse dhe të komunave dhe bashkive të pafavorizuara

Këto do të bazohen në partneritetin e ri midis palëve kryesore kombëtare, të qarqeve, të bashkive dhe komunave me Këshillin e Partneritetit të Qarkut.

Investimet publike me financim të brendshëm të Qeverisë në mbështetje të zhvillimit rajonal deri tani kanë qenë shpërndarë mes programeve të ministrive dhe agjencive të ndryshme. Strategjia ndërsektoriale e zhvillimit rajonal ofron një vizion mbi bashkërendimin e gjithë politikave të zhvillimit. Donatorët kanë ofruar ndihmë të konsiderueshme për zhvillimin rajonal në të shkuarën, ku përfshihet një program i mbështetur nga PNUD-i brenda strukturave të Objektivave të Zhvillimit të Mijëvjeçarit, si dhe projekte të tjera që financojnë infrastrukturën lokale, si ai për Zhvillimin e Komunitetit Lokal nga CARDS, Fondi për Investime Sociale nga Gjermania, dhe Puna në Komunitet financiar nga Italia dhe BB. Koordinimi i projekteve të

zhvillimit rajonal do të bëhet edhe më i rëndësishëm me prezantimin e praktikave të BE-së nëpërmjet projektit të IPA-s për mbështetjen zhvillimit rajonal. Një sfidë kryesore ndërsa Shqipëria i afrohet BE-së, ngelet rritja e kapaciteteve për të menaxhuar programet e zhvillimit rajonal sipas kërkesave të BE-së.

Mbështetja e donatoreve në të ardhmen në këtë fushë duhet të fokusohet në:

- krijimin e një sistemi të vetëm për planifikimin dhe menaxhimin e zhvillimit rajonal në vend
- mbështetjen institucionale për Agjencitë e Zhvillimit Rajonal ekzistuese dhe mbështetje për krijimin e agjencive të tjera të reja

## Turizmi

Turizmi. Strategjia sektoriale e turizmit identifikon prioritetet mbi ndërgjegjësimin, publicitetin, investimet në zonat dhe qendrat kulturore dhe natyrore, zhvillimin e burimeve njerëzore, përmirësimin e klimës së biznesit, zhvillimin e produkteve kulturore, si dhe menaxhimin e informacionit. Buxheti i vitit 2008 për Ministrinë e Kulturës, Turizmit, Rinisë dhe Sporteve shpërndan investimin publik nëpërmjet dy programeve:

Programit të zhvillimit të turizmit për vitin 2008 që do të lëvrojë 0.3 milion euro për Agjencinë Kombëtare të Turizmit; ndërsa 1.3 milion do t'i përkushtohen restaurimit të zonave me interes për turizëm.

Nga ana e donatorëve, PNUD-i ka mbështetur ekoturizmin si një aspekt i zhvillimit të turizmit, Një numër donatorësh si Austria, KE, GEF, Japonia, Holanda, së bashku me BB kanë mbështetur zhvillimin e turizmit me anë të projektit të Menaxhimit dhe Integritit të Zonave Bregdetare. Ky projekt, përmes mbështetjes së dhënë në rritjen e kapaciteteve dhe investimeve në infrastrukturë ka për qëllim të sigurojë zhvillim të qëndrueshëm për zonat me potencial për zhvillimin e turizmit. Austria gjithashtu mbështet edukimin profesional në fushën e turizmit, BB, GEF dhe Suedia kanë mbështetur Menaxhimin e integruar të Ekosistemit të Liqenit të Shkodrës, dhe Gjermania bashkë me Greqinë dhe Italinë kanë mbështetur programin për biodiversitetin në liqenet e Prespës dhe Ohrit.

Italia gjithashtu po mbështet Parkun Kombëtar të Karavastasë, ndërsa BB, përmes një granti të GEF ka planifikuar mbështetje të mëtejshme për Parkun Kombëtar të Butrintit. Sipërmarrësit në fushën e turizmit do të përfitojnë gjithashtu nga aktivitetet për zhvillimin e sektorit privat që koordinohen nga METE.

Mbështetja e mëtejshme nga donatorët për këtë sektor duhet të fokusohet në:

- ndërgjegjësim dhe marketing
- programe dhe studime që mbështesin zhvillimin e turizmit, si për shembull programe për trajnime profesionale dhe institucione profesionale për menaxhimin e turizmit
- mbështetje financiare për zhvillimin e turizmit rural dhe format alternative të turizmit
- ekspertizë dhe mbështetje teknike për zbatimin e projekteve pilot për pikat turistike
- studime të standardizuara për zhvillimin e tregut të turizmit të pajtueshëm me standardet e OBT dhe Këshillit Botëror të Turizmit dhe Udhëtimeve

## Planifikimi hapësinor dhe Strehimi

Planifikimi hapësinor. Ligji i ri për planifikimin hapësinor pritet të kalojë së shpejti në Parlament. Ky ligj do të qartësojë kornizën politike dhe ligjore të planifikimit hapësinor. Burimet e brendshme financiare të MPPTT për planifikimin urban dhe strehimin përfshijnë investime publike me vlerë 0.6 milion euro për studimet e zhvillimit urban, 0.25 milion euro për aktivitetet e Agjencisë së Legalizimit të Pronave, si dhe 1.1 milion euro për bashkëfinancimin e projektit Menaxhimi i Integruar i Zonës Bregdetare (financuar nga BB) i cili përfshin planet për zhvillimin e bregdetit të Jugut dhe mbështetjen e strukturave menaxhuese urbane. USAID dhe BB kanë siguruar ndihmë teknike për formulimin e kuadrit të ri të politikave për planifikimin hapësinor. Zbatimi i këtyre politikave pritet të mbështetet në të ardhmen edhe nga projekti i Menaxhimit dhe Administrimit të Tokës (BB) i cili do të mbështesë planet rregulluese dhe planet për investime infrastrukturore për 8 qytete të përzgjedhura. Projekti i KE/CARDS për zhvillimin e qëndrueshëm të rajonit Tiranë-Durrës ndihmoi në përgatitjen e master planit që duhet të adoptohet nga strukturat e reja.

Strehimi. Prioritetet në fushën e strehimit janë: rritja e mundësive për strehim të grupeve shoqërore më të varfra, mbështetja e sektorit të qerave dhe përmirësimi i ndërtesave sociale. Burimet financiare të brendshme që mbështesin investimet publike në këtë sektor pranë MPPTT arrijnë në 3.6 milion euro. Këtu përfshihen blerja e ndërtesave, përmirësimi i kushteve të ndërtesave të komunitetit rom, si dhe kryesisht bashkëfinancimi i projektit të CEB për ndërtimin e banesave sociale. Projekti kryesor që pritet të fillojë së afërmi në sektorin e strehimit është projekti i financuar nga BERZH-i i cili ka për qëllim ofrimin e banesave me kosto të ulët për familjet në nevojë.

Është e nevojshme që të sigurohet vazhdimësia e projekteve në sektorin e planifikimit hapësinor në përputhje edhe me kuadrin e ri politik.

Mbështetja e donatoreve në këtë sektor mund të përqendrohet në:

- rritjen e kapaciteteve të planifikimit hapësinor veçanërisht në qeverisjen vendore, pasi të jenë hartuar politikat përkatëse

përfshirjen e publikut si dhe organizatave kryesore profesioniste në marrjen e vendimeve për hartimin e planeve

## 4. Orientimi i ndihmës së huaj në të ardhmen

Ky kapitull trajton drejtimit e mundshme të ndihmës së huaj në të ardhmen duke dhënë orientime për sektorët prioritarë, bazuar në nevojat e përcaktuara në SKZHI si dhe nga avantazhet e ndihmës së huaj krahasuar me financimin e brendshëm. Gjithashtu në këtë kapitull jepet lista e projekteve prioritare, për të ndihmuar donatorët në mundësitë për financim.

### 4.1 BURIMET E NDIHMËS SË HUAJ NË TË ARDHMEN

Nivelet e granteve dhe huave nga donatorët dypalësh dhe shumëpalësh janë në përputhje me nevojat e Shqipërisë. Vazhdimësia e ndihmës së dhënë nëpërmjet granteve është e rëndësishme duke pasur parasysh theksin që është vënë në nxitjen e reformave dhe ngritjen e institucioneve. Ndërsa huatë e mëdha janë të rëndësishme për programet e mëdha të rehabilitimit dhe ndërtimit të infrastrukturës.

SKZHI-ja parashikon që situata aktuale e investimeve publike do të vazhdojë për një periudhë afatmesme dhe kjo është e reflektuar në qëndrueshmërinë aktuale të shpërndarjes së fondeve në PBA. Gjithsesi, brenda pesë viteve të ardhshme, strategjia kombëtare parashikon disa ndryshime në shpërndarjen e fondeve dhe kjo pjesërisht për arsye se disa nga institucionet e reja apo të reformuara do të kenë kapacitete për të menaxhuar programet e reja dhe pjesërisht sepse theksi emergjent që është vendosur në infrastrukturën e rrugëve do të bjerë mbi infrastrukturën e ujësjellës-kanalizimeve.

Grantet e dhëna nga donatorët dypalësh janë shumë të rëndësishme për periudhën afatmesme. Ato janë burim i rëndësishëm financiar për të mbështetur ndihmën teknike për forcimin e institucioneve, me qëllim që këto të fundit të mund të sigurojnë shërbim publik cilësor. Këto grante gjithashtu janë një burim financiar i rëndësishëm për të mbështetur investimet fizike, dhe veçanërisht aty ku ato shoqërohen edhe me ndihmë teknike, siç është p.sh krijimi i mbështetjes për aktivitetin ekonomik sipas stilit të BE-së. Grantet dypalëshe në përgjithësi tentojnë të jenë në formën e projekteve të vogla, gjë që rrit rëndësinë e koordinimit për sigurimin e efikasitetit të këtyre projekteve dhe për të shmangur përsëritjen dhe boshllëqet në financim.

Qeveria beson që grantet nga vendet e BE-së duhet të luajnë një rol të rëndësishëm në rritje dhe kjo si për arsyen e burimeve financiare që ato sigurojnë ashtu edhe për arsyen e të qenit pjesë e procesit të zhvillimit të kapaciteteve për të arritur statusin e shtetit kandidat për në BE. Nëse Shqipëria do të marrë të njëjtin financim gjatë procesit të hyrjes në BE ashtu siç morën edhe vendet e reja të BE-së, atëherë fondet për Shqipërinë do të trefishohen në vitet që do të vijnë.

Në vitet e fundit huatë nga donatorët dypalësh kanë luajtur rol të rëndësishëm dhe kanë nxitur tranzicionin drejt financimeve tregtare dhe investimeve të huaja direkte. Ato do të jenë edhe më të rëndësishme gjatë periudhës së paraaderimit. Këto financime janë edhe më të rëndësishme sidomos atëherë kur ato sigurojnë investime të mëdha që mund të koordinohen edhe me grantet dypalëshe për ndihmë teknike.

Huatë nga BERZH-i, BEI dhe CEB kanë luajtur rol të rëndësishëm në këto vitet e fundit. Pjesa më e madhe e tyre është siguruar në terma tregtare dhe vlera e tyre për Qeverinë ka të bëjë jo vetëm me dëshirën e bankave për të financuar investime afatgjata në infrastrukturën publike, por edhe me mundësinë e tyre për mbështetje teknike. Qeveria do të kërkojë që kreditë nga donatorët shumëpalësh europianë të vazhdojnë të luajnë rol të rëndësishëm në periudhën e para dhe pas aderimit në BE.

Huatë nga donatorët shumëpalësh po luajnë momentalisht rol shumë të rëndësishëm, dhe kjo veçanërisht në sektorët që nuk kanë mbështetje direkte nga fondet e BE-së si shëndetësia,



arsimi dhe reformat sociale, por edhe në infrastrukturë dhe burime natyrore. Kalimi nga statusi i IDA-s do të nënkuptonte që elementi i kompensimit të huasë do të jetë më pak se 20%. Gjithsesi huatë nga donatorët shumëpalësh janë jashtëzakonisht të rëndësishme për Shqipërinë, sidomos nëse BB dhe donatorët e tjerë shumëpalësh janë në gjendje të sigurojnë ekspertizë, e cila është shumë e rëndësishme për mbështetjen e financimit të tyre, pasi shumë nga këto investime kanë impakt social vetëm në periudhën afatgjatë.

## 4.2 FOKUSI SEKTORIAL

**Nevojat e identifikuar të Qeverisë.** Ndryshimet në shpërndarjen e fondeve për periudhën afatmesme janë të reflektuara në PBA, e cila përfshin edhe angazhimet specifike nga ministritë e linjës. Në limitet e periudhës afatmesme, veçanërisht në harkun kohor 2011-2013, orientimi diktohet nga prioritetet e SKZHI-së. Nivelet e shpenzimeve të përfshira në këto ndryshime nuk janë finalizuar ende në dokumentin e SKZHI-së. Gjithsesi, përveç kësaj pritet që vëmendje më e madhe t'i kushtohet sektorit të ujit dhe kanalizimeve, zhvillimit rajonal dhe rural si dhe mjedisit, duke reflektuar kështu tendencën tipike të shpenzimeve që bëhen nga vendet që duan të arrijnë normat dhe standardet e BE-së si pjesë e politikës për të aderuar në BE. Këtë e tregojnë edhe financimet aktuale që po marrin vendet që kanë hyrë në procesin e integritimit evropian. Tabela 4.1 tregon shpërndarjen e fondeve për shpenzimet në PBA dhe SKZHI, si dhe shpërndarjen aktuale të ndihmës së huaj dhe disa nga të dhëna të programeve strategjike të donatorëve.

**Tabela 4.1 Mesatarja e shpenzimeve kapitale vjetore. (milion euro)**

	Buxheti PBA 2007-10	Prioritete e shtuara në SKZHI 2011-13	Ndihma e huaj vjetore 2007-10	Prioritet në dokumentet e programimit strategjik të donatorëve
<b>Demokratizimi dhe shteti i së drejtës</b>	<b>73</b>		<b>33</b>	
Mbrojtja	48		5	e mesme
Drejtësia	12		13	e mesme
Punët e brendshme	14		15	e mesme
<b>Infrastruktura</b>	<b>424</b>		<b>86</b>	
Transporti	354		40	e ulët
Uji	62	i lartë	27	e lartë
Mjedisi	8	i lartë	18	e lartë
<b>Ekonomia</b>	<b>19</b>		<b>24</b>	
Financat Publike	9		10	e mesme
Ekonomia	10		14	e lartë
<b>Socialet</b>	<b>109</b>		<b>40</b>	

Punësimi	3		5	e ulët
Shëndetsia	41	i lartë	17	e mesme
Arsimi	65		18	e mesme
<b>Territorialet</b>	<b>54</b>	<b>i lartë</b>	<b>34</b>	<b>e lartë</b>
Te tjera	15		21	
<b>Total</b>	<b>694</b>		<b>239</b>	
Shënim: Sektori i energjisë	0		89	e ulët

Burimet: Të dhënat për buxhetin/PBA janë marrë nga MF; shifrat për kostimin e SKZHI-së janë marrë nga SKZHI; situata aktuale e ndihmës së huaj është marrë nga baza e të dhënave të donatorëve, duke përllogaritur mesataren e shpenzimeve për vitet 2006 dhe 2008; prioritetet e së ardhmes janë marrë nga dokumentet strategjike të programimit të donatorëve.

Tabela tregon që ndihma e huaj përbën rreth 35% të investimeve të buxhetit të shtetit (megjithëse jo e gjithë ndihma e huaj është e përfshirë në shifrat e buxhetit). Sektorët mund të grupohen në kategori të ndryshme.

- Ndhimja e huaj përbën më pak se 20% të buxhetit të tanishëm dhe duke pasur parasysh programimin e donatoreve kjo vlerë nuk do të ndryshojë as për periudhën afatmesme për mbrojtjen dhe transportin.
- Ndhimja e huaj përbën më shumë se 20% të buxhetit aktual dhe do të qëndrojë në terma të ngjashëm edhe në të ardhmen për sektorët e punësimit, arsimit dhe shëndetsisë.
- Ndhimja e huaj përbën më shumë se 75% të buxhetit aktual dhe do të qëndrojë në terma të ngjashëm edhe në të ardhmen për sektorët e drejtësisë, punët e brendshme dhe financat publike.
- Ndhimja e huaj përbën më shumë se 50% të buxhetit aktual dhe do të financojë një pjesë të madhe të kërkesave për investimet në rritje për ekonominë, ujin, mjedisin dhe zhvillimin territorial.

**Mungesat në programimin aktual.** Dokumentet e programimit strategjik të donatorëve zakonisht mbulojnë një periudhë tre vjeçare. Prioritetet e programuara aktualisht përputhen mirë me prioritetet afatmesme të donatoreve të treguara në tabelën e mësipërme. Ndërsa tabela e mëposhtme është një përpjekje për të përputhur prioritetet e donatorëve me vlerësimin që Qeveria i ka bërë nevojave të Shqipërisë, si dhe orienton ata donatorë që janë në fazën e rishikimit të prioriteteve të tyre.

**Tabela 4.2 Nevojat dhe orientimet e ndihmës së huaj, në bazë të sektorëve**

	Nevojat	Mungesat në programimin e donatorëve
Demokratizimi dhe shteti i së drejtës	Do të vazhdojë të kërkojë një pjesë të mirë të investimeve publike, dhe ndihma e huaj do të luajë një rol kritik	Theksi mund të vihet në forcimin e administratës publike, por sistemi i drejtësisë dhe rendi publik duhet të dalin më në pah tek programimi i donatorëve
Zhvillimi ekonomik	Nevojë urgjente për të krijuar institucione dhe mekanizma, që do të pasohet nga financime madhore për zhvillimin e sektorit privat, përfshirë këtu zhvillimin rural dhe rajonal.	Ka prioritetin më të lartë në programimet e donatorëve krahasuar me të gjithë sektorët e tjerë, dhe sugjeron që donatorët po përgatiten për një mbështetje në rritje duke qenë në të njëjtën linjë me prioritetet e SKZHI-së.

Transporti	Do të vazhdojë të kryesojë listën e prioriteteve edhe të paktën për 4 vite të tjera, pas të cilave fokusi do të ndryshojë nga rrugët kryesore në ato dytësore dhe tek siguria në rrugë.	Ka mbështetje të mirë nga programet e donatorëve. Ka nevojë që kjo ndihmë të vazhdojë edhe për disa vite, megjithëse do të dominojë financimi nga buxheti i shtetit.
Uji	Ka nevojë urgjente për përmirësimin e kapaciteteve menaxhuese e pasuar nga nevojat e larta për investime.	Donatorët i kanë kushtuar vëmendjen e duhur në programimet e tyre afatshkurtra, por kjo vëmendje duhet të rritet në periudhën afatgjatë.
Zhvillimi social	Ka nevojë për fokusim të menjëhershëm në reformat dhe institucionet, e pasuar nga investimet përkatëse.	Interesi i shprehur nga donatorët në dokumentet e programimit është më i madh se mbështetja aktuale. Kjo sugjeron që një mbështetje më e madhe nga shumë donatorë mund të arrihet në këtë sektor.
Zhvillimi territorial	Një karakteristikë shumë e rëndësishme e integritit evropian do të jetë zgjerimi i mbështetjes për zhvillimin lokal, rural dhe rajonal.	Programimet e donatorëve nuk karakterizohen nga mbështetje e fortë ndaj zhvillimit rural dhe rajonal, bujqësisë dhe planifikimit urban, dhe është e nevojshme që në të ardhmen t'i vihet më shumë theks.

**Prioritetet afatshkurtra.** Mbështetja financiare e sektorëve nga ndihma e huaj do të ndryshojë edhe nga përsheptimi i zbatimit të programeve ekzistuese. Disa ndryshime të shpejta do të arrihen edhe nga zbatimi i programeve të reja. Ministrinë kanë identifikuar një numër të vogël projektsh prioritare për tu konsideruar nga donatorët për financime të reja afatshkurtra. Këto projekte janë përzgjedhur për të reflektuar nevojat e menjëherëshme të ministrive të linjës, duke pasur parasysh prioritetet e SKZHI-së dhe prioritetet afatmesme të identifikuara në kapitullin 3. Tabela e mëposhtme liston këto projekte dhe jep disa tregues të nivelit të financimit të nevojshëm për çdo projekt. Për qëllime të kostimit të përafërt, projektet klasifikohen në katër kategori:

- A. Projekte të mëdha në infrastrukturë, që përfshijnë rrugë të gjera, energjinë, ujin dhe portet ( me vlerë mbi 20 milion euro)
- B. Asete fizike më të vogla, si ndërtesa, zyra dhe pajisje (me vlerë 5-15 milion euro)
- C. Programe sektoriale më të gjera, siç janë programet me përjasje sektoriale dhe programet e zhvillimit të integruar që përfshijnë një sërë aktiviteteve në mbështetje të sektorit në tërësi (me vlerë 5-10 milion euro)
- D. Forcimi i kapaciteteve institucionale, përfshirë trajnimet, sistemet, studimet dhe ndihmë teknike (me vlerë 1-3 milion euro).

**Tabela 4.3 Projekte për mbështetje nga ndihma e huaj**

Strategjia		Titulli i projektit	Tipi
Qeverisja/Ligji			
Drejtësia	1	Ndërtimi dhe rikonstruksioni i gjyqeve	B
Administrata publike	2	Ngritja e kapaciteteve të DAP-it dhe forcimi i procedurave të shërbimit civil	D
Decentralizimi	3	Ndihmë teknike dhe rritje kapacitetesh për administratorët e qeverisjes vendore	D
	4	Ndihmë teknike dhe rritje kapacitetesh për administratorët e qeverisjes rajonale/prefekturat	D
Rendi publik	5	Koordinimi i policisë për emergjencat dhe kontrollin e territorit	D
	6	Mbështetje me pajisje për sigurinë dhe lëvizjen e policëve	B
	7	Rehabilitimi i komisariateve të policisë sipas standarteve të BE-së	B
	8	Emergjencat Civile (zjarri, përmbytjet) dhe ngritja e linjës së telefonit "112"	D
	9	Ngritja e sistemit të radio komunikimit policor DATACOM	D

Krimi i organizuar, T&T	10	Forcimi i kapaciteteve anti-trafikim, trajnime dhe ri-integrimi	D
Statistikat	11	Krijimi i Fondit të Besimit (Trust Fund) për INSTAT nga donatorët ndërkombëtare për realizimin dhe shpërndarjen e statistikave kombëtare	D
<b>Zhvillimi ekonomik</b>			
Ekonomia	12	Zhvillimi i tregut elektronik në Shqipëri	D
	13	Krijimi dhe forcimi i Ndërmarrjeve të Vogla dhe të Mesme	D*
	14	Zonat e lira dhe parkqet industriale në Durrës, Shkodër dhe Vlorë	B
	15	Qendra e përpunimit të eksporteve në Durrës	D
	16	Projekte për të nxitur investimet e huaja direkte	D
Mbrojtja e konsumatorëve	17	Harmonizimi dhe zbatimimi i Legjislacionit dhe ngritja e institucioneve	D
<b>Infrastruktura</b>			
Transporti	18	Rruga Rrëshen-Kalimash	A
	19	Rruga Pllocë-Korçë	A
	20	Rruga Fushë Krujë-Milot, korsia e dytë	A
	21	Krijimi i bordit të hetimit të aksidenteve/incidenteve ajrore	D
	22	Hartimi dhe zbatimimi i planit për ndërtimin e aeroportit të Sarandës	D
	23	Hekurudhat: rikonstruksion i pjesshëm i linjës Durrës-Rrogozhinë dhe Vlorë-Milot	A
	24	Hekurudhat: ngritja e sinjalistikës për linjat Durrës-Tiranë dhe Milot-Rrogozhinë	A
	25	Hekurudhat: blerja e lokomotivave të reja dhe vendosja e tabelave elektronike për shërbimin ndaj pasagjerëve	A
	26	Portet: faza 2B, 4 dhe 5 e masterplanit të portit të Vlorës	A
	27	Ngritja e qendrës së informacionit për trafikun	D
Energjia	28	Ngritja e sistemit të transmetimit të energjisë Korçë-Përmet	A
	29	Ngritja e sistemit të transmetimit të energjisë Vlorë-Sarandë dhe mbështetja e sektorit të turizmit në atë zonë	A
Uji/kanalizimet	30	Matja e ujit : blerja dhe instalimi i 300 mijë matësave	B
	31	Ngritja e sistemit të kompjuterizuar të faturave të ujit dhe e grumbullimit të të ardhurave	D
	32	Krijimi i standardeve kombëtare, programet e decentralizimit dhe tikonstruksionit	A*
Mjedisi	33	Monitorimi i cilësisë së ajrit	D*
	34	Programi i menaxhimit të mbetjeve	C
	35	Zhvillimi i parkut kombëtar me Kosovën dhe Malin e Zi	D
	36	Faza e dytë e programit të zhvillimit të peshkimit, vazhdim i projektit të BB dhe IDB	C*
	37	Inventarizimi i burimeve ujore në 5 basenet ujore të ngelura	D
	38	Kontrollimi i zjarrit në pyje: zbulimi me satelit dhe planifikimi e menaxhimi	D*
<b>Zhvillimi social</b>			
Arsimi	39	Zhvillimi i hershëm i fëmijëve: rindërtimi i 350 kopshteve dhe ndërtimi i 10 kopështeve të reja	B
	40	Projekt mbi arsimin profesional	C
	41	Mbështetje për zbatimin e procesit të Bolonjës në Arsimin e Lartë	C
	42	Shkenca dhe kërkimi shkencor: a) lidhur me punësimin b) lidhur me arsimimin	D
Shëndetësia	43	Zbatimimi i programit me përfaqesë sektoriale për mbështetjen e shëndetit parësor	C
	44	Trajnime për shërbimin parësor dhe përdorimi i teknikave të reja	D
	45	Instituti i Sigurimeve Shëndetsore	D
	46	Instituti i Shëndetit Publik	D

Punësimi	47	Zbatimi i kuadrit shqiptar për kualifikimet (NAVT)	D
	48	Të mësuarit gjatë gjithë jetës, në bashkëpunim me MASH	D
	49	Rritja e efikasitetit të shërbimeve të punësimi; zyrat, trajnimet, sistemi i teknologjisë së informacionit	C
Mbrojtja sociale	50	Integrimi i grupeve të marginalizuara: regjistrimi, planet, pilotimi, grante	C
	51	Riforcimi i strukturave të mbrojtjes së fëmijëve	D
	52	Krijimi i bazës së të dhënave për personat me aftësi të kufizuara, duke përfshirë diagnostikimin dhe identifikimin e nevojave	D
Barazia gjinore	53	Dhënia e kredive dhe granteve për gratë sipërmarrëse	D
Migracioni	54	Ngritja e sistemit kombëtar për menaxhimin e migracionit	D
	55	Përgatitja e strategjisë dhe e planit të veprimeve për riintegrimin e emigrantëve	D
Përfshirja sociale	56	Modernizimi i sistemit të sigurimeve shoqërore (ISSH)	C
	57	Ngritja e kapaciteteve dhe ndihmë teknike për ratifikimin e kodit të BE-së për sigurimet shoqërore	D
Zhvillimi territorial			
Bujqësia	58	Projekti i kontrollit të brucelozës	D
	59	Mbështetje për prodhimin dhe tregtimin e fruti dhe horti kulturës	C
	60	Zhvillimi i pikave të grumbullimit dhe tregjeve	B
Zhvillimi rural	61	Ngritja e Agjencisë së Pagesave Rurale	D*
Zhvillimi rajonal	62	Forcimi institucional për zhvillim rajonal	C*
Turizmi, kultura, rinia, sportet	63	40 hanet rurale të trashëgimisë kulturore	B
	64	Rikonstruksioni i monumenteve kombëtare dhe trashëgimisë kulturore	B
	65	Rikonstruksioni i Teatrit Kombëtar Kolonadat	B
	66	Ngritja e Agjencisë Kombëtare të Rinisë	B
	67	Rikonstruksioni i stadiumit kombëtar të sporteve në Tiranë	B
Planif. Hapësinor	68	Mbështetje e integruar për ofrimin e shtëpive me qera të ulët dhe për mbështetjen ligjore	C

Shënim: Shenja Yll (\*) tregon projektet që janë dërguar për financim edhe nga IPA 2008

Projektet propozimet e ministrive të linjës përfshijnë edhe kostimin e plotë të tyre. DBSKNH pasi i analizoi këto projekte mendon që vlera totale e tyre arrin deri në 400 milion euro. Kjo vlerë është e krahasueshme me vlerën mesatare të angazhimeve vjetore të ndihmës së huaj në vitet e fundit me rreth 300 milion euro<sup>8</sup>. Kështu nëse donatorët do të angazhonin shumicën e financimeve të tyre për projektet e reja prioritare të mësipërme, do të duhej një periudhë dy vjeçare për të siguruar angazhime për të gjitha projektet.

Tabela e mëposhtme përmbledh vlerat e projekteve prioritare sipas sektorëve dhe e krahason këtë me ndihmën e huaj aktuale dhe me PBA. Kolona e parë tregon prioritetet aktuale të Qeverisë në periudhë afatshkurtër, dhe dy kolonat e fundit tregojnë se si ndihma e huaj do të ndryshonte nëse projektet e reja prioritare do të mbështeteshin financiarisht gjatë dy viteve në vazhdim.

<sup>8</sup> Sipas të dhënave të DAC, vlera mesatare vjetore e asistencës së re ka qenë afërsisht e ngjashme me disbursimet vjetore që nga viti 2000, sepse DAC i regjistron të angazhimet në momentin që ato bëhen të pakthyeshme. Sipas bazës së të dhënave, zgjatja vjetore e projekteve ka qenë 3 vjet, me një disbursim të përvitshëm sa 1/3 e vlerës totale


**Tabela 4.4 Orientimi sipas sektorëve (investimet mesatare vjetore në milion euro)**

Periudha	Financime nga buxheti		Ndhma e huaj	
	PBA	Kostimi i SKZHI	Ndhma e huaj aktuale	Projektet e reja prioritare
	2007-10	2011-13	2007-10	
Demokratizimi/Ligji	73	107	33	51
Ekonomia	19	63	24	29
Energjia			89	30
Transporti	354	548	40	119
Uji dhe Mjedisi	70	146	46	73
Sociale	109	173	42	60
Territoriale	54	186	34	42
Të tjera	15	25	23	
<b>Totali</b>	<b>694</b>	<b>1248</b>	<b>330</b>	<b>404</b>

Burimi: shih tabelën 5.1 për ndihmën e huaj aktuale, PBA dhe kostimi i SKZHI; projektet e reja të propozuara janë bazuar në rishikimin e kostimit të bërë nga DBSKNH

Në përgjithësi, tabela e mësipërme tregon që projektet e reja prioritare janë në përputhje me ndryshimet që do të nevojiten për lëvizjen e ndihmës së huaj në PBA. Kjo paraqitet në mënyre grafike në figurën e mëposhtme; energjia nuk është përfshirë pasi burimet kryesore të investimeve nuk janë të përfshira në PBA.

**Figura 4.1 Projektet prioritare që çojnë në ndryshimin e mbështetjes nga situata aktuale në atë të bazuar në SKZHI**



Burimi: shih tabelën 5.1 për ndihmën e huaj aktuale, PBA dhe kostimin e SKZHI; projektet e reja të propozuara bazohen në rishikimin e kostimit të bërë nga DBSKNH

Në veçanti tabela tregon që:

- Financimi nga ndihma e huaj i ofruar për demokratizimin dhe shtetin e së drejtës në kostimin e SKZHI-së është më i lartë se ai parashikuar në PBA. Projektet e reja janë në një linjë me këtë.
- Projektet e reja në sektorin e ekonomisë tregojnë një financim të ngjashëm nga ndihma e huaj pavaresisht një rënieje të këtij financimi në kostimin e SKZHI-së. Kjo reflekton avantazhet krahasuese të donatorëve në këtë sektor.
- Në transport, projektet e reja do t'i japin një nxitje të madhe financimit nga ndihma e huaj, kjo në përputhje me kostimin e SKZHI-së. Financimet për projektet e reja në transport është më e ulët se ajo e parashikuar në kostimin e SKZHI-së, duke reflektuar edhe rëndësinë e financimit të rrugëve nga buxheti i shtetit.
- Financimi nga ndihma e huaj për ujin dhe mjedisin në projektet e reja tregon prioritetin e këtyre sektorëve për pesë vitet në vazhdim dhe reflekton rolin e rëndësishëm të donatorëve në sektorët e ujit dhe mjedisit.
- Financimi nga ndihma e huaj për projektet e reja në sektorin social është pak më e lartë se ajo e ndihmës së huaj ekzistuese duke reflektuar kostimin e SKZHI-së. E njëjta tendencë aplikohet edhe në zhvillimin territorial.

## 5. Përmirësimi i menaxhimit të ndihmës së huaj

Ky kapitull përshkruan menaxhimin e deritanishëm të ndihmës së huaj si dhe planet e Qeverisë për përmirësimin e tij. Fokusi kryesor është përmirësimi i bashkërendimit të planifikimit, menaxhimit dhe vlerësimit midis të dyja palëve, asaj të donatorëve dhe të Qeverisë.

Ky kapitull i referohet anketimit të Organizatës për Kooperim dhe Zhvillim Ekonomik, anketim i bërë nga Komiteti i Ndhmës së Huaj për Zhvillim (DAC) i cili ofron mbështetje të rëndësishme për ndryshimet e kërkuara (referoju seksionit 1.4). Rezultatet e vitit 2005 të përdorura për Anketimin e kryer në vitin 2006 paraqiten në tabelën 5.1 bashkë me objektivat që duhet të arrihen në 2010, të cilat japin drejtimet se ku Qeveria dhe donatorët duhet të fokusojnë përpjekjet e tyre për përmirësimin e menaxhimit të ndihmës së huaj.

**Tabela 5.1 Indikatorët e Deklaratës së Parisit: rezultatet e 2005 dhe objektivat për 2010 për Shqipërinë**

Indikatorët	Rezultatet 2005	Objektivat për 2010
<b>Pronësia</b>		
1 Pronësia - Strategji Kombëtare Operacionale	C	B ose A
<b>Pozicionimi</b>		
2a Cilësia e sistemeve MFP	4.0	4.5
2b Cilësia e sistemeve të prokurimeve	Nuk ka informacion	Nuk aplikohet
3 Ndhima e raportuar në buxhet	32%	85%
4 Zhvillimi i koordinuar i kapaciteteve	28%	50%
5a Përdorimi i sistemeve të MFP të vendit (qarkullimi i ndihmës)	14%	43%
5b Përdorimi i sistemeve të prokurimit të vendit (qarkullimi i ndihmës)	6%	Nuk aplikohet
6 Njësitë paralele të zbatimit të projekteve	57	19
7 Parashikimi vjetor	49%	74%
8 Ndhimë e pakushtëzuar	59%	më shumë se 59%
<b>Harmonizimi</b>		
9 Përdorimi i përjasjeve me bazë programi	5%	66%
10a Misionet e koordinuara	9%	40%
10b Punimet analitike të koordinuara	22%	66%
<b>Menaxhim për rezultate</b>		
11 Kuadër i konsoliduar i vlerësimit të performancës	D	B ose A
<b>Përgjegjësia e përbashkët</b>		
12 Rishikime të përgjegjësisë së përbashkët	Jo	Po

### 5.1 RAPORTIMI DHE REGJISTRIMI I NDIHMËS SË HUAJ

DBSKNH në bashkëpunim të ngushtë me MF është përgjegjës për menaxhimin e ndihmës së huaj. Qeveria do të mbajë dhe adoptojë bazën e të dhënave të donatorëve e cila deri tani është mbajtur nga STD. DBSKNH dhe MF do të përcaktojnë një procedurë të qartë e cila do ti lejojë të dy institucionet të punojnë me këtë bazë të dhënash ndërsa ruajnë qëndrueshmërinë e saj. Do të përcaktohen procedura sipas të cilave kjo bazë të dhënash do t'i vihet në dispozicion Qeverisë dhe donatorëve në mënyrë transparente dhe të vazhdueshme. Për të arritur këtë qëllim, do të vazhdojë të jetë e nevojshme të merret informacion mbi ndihmën e huaj nga të dyja palët, si nga donatorët dhe nga agjencitë qeveritare. Gjatë vitit 2008, Qeveria do të vazhdojë të përmirësojë procedurat për integrimin e ndihmës së huaj në strukturat e rregjistrimit dhe raportimit qeveritar. Ajo do të punojë gjithashtu në krijimin e Sistemit të Informacionit për Menaxhimin e Ndhmës së Huaj i cili do të mbështesë këto procedura.



Mbështetja për këtë sistem informacioni është e parashikuar të bëhet nën SPI por nuk është i përfshirë si prioritet në vitin e parë të implementimit të tij. Në të ardhmen do të bëhen progrese pragmatike duke e fokusuar vëmendjen në mirë koordinimin midis DBSKNH dhe MF. Fushat kryesore në të cilat kërkohet punë e menjëhershme dhe e mëtejshme janë:

- Përmirësimi i klasifikimit të projekteve të donatorëve në mënyrë që të reflektojnë dhe të lidhin kontributin financiar me programet përkatëse të buxhetit të shtetit aty ku mund të bëhet një lidhje e tillë.

Monitorimi i informacionit mbi disbursimin përkrah monitorimit të buxhetit të shtetit. Nga donatorët kërkohet një raportim i vazhdueshëm për të përditësuar bazën e të dhënave dhe për të siguruar që informacioni i dhënë është i klasifikuar dhe i raportuar vazhdimisht bashkë me informacionin që ndodhen në buxhet.

## **Pronësia: Udhëheqje e efektshme për politikën dhe strategjitë si dhe koordinimi i veprimeve për zhvillim.**

**Rezultatet e anketimit të vitit 2006:** Sipas Anketimit të vitit 2006 rezultati i arritur për treguesin e pronësisë (treguesi 1) ishte mesatar. Sfidat e identifikuara ishin integrimi i kufizimeve të planeve dhe strategjive të ndryshme. Veprimet prioritare që duhet të ndërmerren ishin kompletimi dhe zbatimi i SKZHI 2007-2013.

**Arritjet dhe progresi i deritanishëm:** DBSKNH ka forcuar rolin e tij në menaxhimin e ndihmës së huaj dhe në koordinimin e tij me MF dhe Ministrinë e Integritimit. Progres është bërë në lidhjen e prioriteteve kombëtare dhe strategjive me procesin e buxhetit. SPI-ja përcakton një sërë rregullash/principesh për të siguruar që politikën, planifikimin dhe zbatimin e buxhetit të bëhet në mënyrë të integruar, koherente dhe efeçente.

Përpjekje dhe fonde të përbashkëta të donatorëve kanë bërë të mundur që të vihen në dispozicion fonde të mjaftueshme dhe ndihma teknike të bashkërendohet me efikasitet. Është zhvilluar gjithashtu një strukturë e vetme strategjike, nëpërmjet SKZHI-së 2007-2013. Gjithashtu progres është bërë në krijimin e lidhjes midis PBA-së dhe SKZHI-së, ku tavanet e PBA-së dhe planet e shpenzimeve do të reflektojnë qartë prioritetet e SKZHI-së dhe MSA-së. Departamenti i investimeve publike është përgjegjës për zhvillimin e procedurave të reja për menaxhimin e investimeve publike. Ka pasur progres dhe në zhvillimin e procesit për identifikimin, aprovimin dhe monitorimin e investimeve publike si nga buxheti i shtetit ashtu dhe nga ato me financim të huaj, gjë e cila do të lehtësojë do të ndihmojë në përmirësimin e lidhjeve me ndihmën e huaj.

**Veprime prioritare për të arritur objektivat e vitit 2010.** Zbatimi i SKZHI-së dhe SPI-së. Aprovimi i ligjit të ri për menaxhimin e sistemit buxhetor dhe hartimi i rregullave për menaxhimin e ndihmës së huaj.

## **5.2 LIDHJA ME BUXHETIN**

### ***Programimi dhe Buxheti***

Anketimi i vitit 2006 nxorri në pah se vetëm 32% e Ndhmës së Huaj Për Zhvillim (ODA) është pasqyruar në buxhet, rezultat ky që është shumë më i ulët nga objektivi për vitin 2010, i cili është 85% (Indikator 3). Vlerësimet e fundit në bazë të të dhënave të donatorëve sygjerojnë se pothuajse 75% e gjithë financimit të huaj është pasqyruar në buxhet, ku përfshihen të gjitha huatë dhe pothuajse gjysma e granteve. Kjo mbështetet edhe nga rezultatet paraprake të anketimit DAC për 2008 që rezultojnë se vetëm 76% e ndihmës së huaj është e rregjistruar në buxhet. Donatorëve u kërkohet që ta shikojnë me prioritet rëndësinë e rregjistrimit të ndihmës së huaj në buxhet. Kjo mund të arrihet nëse donatorët do të punojnë ngushtësisht me ministrinë përkatëse të linjës si dhe me MF. Gjithashtu gjatë periudhës së programimit donatorët duhet të sigurohen që strukturat e menaxhimit të projekteve të mëdha të pozicionohen në mënyrë efektive me institucionet buxhetore.

Përdorimi i vazhdueshëm i bazës së të dhënave të donatorëve nga ana e DBSKNH dhe MF, së bashku me raportin vjetor të dokumentit të ndihmës së huaj, do të bëjë të mundur që informacioni për ndihmën e huaj të përfshihet në diskutimet e buxhetit. Qeveria ka përdorur tashmë tabelat e investimeve të brendshme dhe ato të ndihmës së huaj me qëllim që të sigurojë që ndarja e fondeve për sektorë të jetë në përputhje me prioritet dhe synimet e strategjisë kombëtare. Ky proces do të jetë pjesë e përgatitjes së ciklit buxhetor të vitit 2009; si më poshtë:

**Tabela 5.2 : Ndhma e Huaj në Ciklin e Buxhetit**

Të dhënat	Veprimet kryesore të procesit të buxhetit
Nëntor - Dhjetor	DBSKNH konsultohet me ministritë për të parë nëse ka angazhime të rëndësishme të cilat kërkojnë fonde shtesë nga buxheti që tejkalojnë rritjen e parashikuar vjetore të buxhetit.
Mesi i muajit Janar	MF prezanton strukturat makroekonomike dhe tavanet për shpenzimet në total, duke futur dhe vlerësimet për fonde që kërkojnë për përshejtimin e politikave të reja.
Fund -Janari	DBSKNH përgatit Dokumentin e Politikave Prioritare (DPP) për KPS duke u bazuar në konsultimet me ministritë, për për t'i paralajmëruar ata për angazhimet e pafinancuara.
Mesi i muajit Shkurt	KPS vendos tavanet fillestare për ministritë duke u bazuar në DPP.
Shkurt - Mars	Përmes procesit të Rishikimit të Politikave të Programit i cili koordinohet nga MF ministritë konsultohen për të përditësuar/rishqyrtuar programevet.
Fund Shkurti	Dërgohen instruksionet për PBA-në
Korrik	Drafti i parë i PBA-së dorëzohet në KPS

Gjatë gjithë ciklit, ministritë raportojnë për kërkesa për fonde shtesë të cilat do të konsiderohen duke pasur parasysh të gjithë programet në vazhdimësi dhe të planifikuar me fonde nga ndihma e huaj. DBSKNH ka për detyrë të sigurojë që e gjithë ndihma e huaj të jetë marrë në konsideratë në këtë proces. Për të arritur këtë qëllim DBSKNH në bashkëpunim me MF duhet të vazhdojë përpjekjet për të klasifikuar gjithë fondet e ndihmës së huaj kundrejt një ose disa programeve përkatëse të buxhetit. **Donatorët duhet të inkurajohen që të marrin në konsideratë këto procese kur programojnë dhe raportojnë ndihmën e huaja.**

Baza e të dhënave të donatorëve përfshin një kollonë për ministrinë përkatëse që është përgjegjëse për projektet. Kjo kolonë është plotësuar pjesërisht nga donatorët që raportojnë në STD dhe pjesërisht nga DBSKNH. Tabela e mëposhtme tregon se 86% e fondeve kanë një ministri të vetme udhëheqëse. Megjithatë një numër i sektorëve të SKZHI-së kanë numër të ndryshëm institucionesh zbatuese, ku përfshihet dhe administrata publike (e shpërndarë në shumë institucione); sektori i drejtësisë (i cili përfshin institucione të pavarura dhe gjithashtu përfshin projektet mbi të drejtat e njeriut të cilat nuk janë të lidhura drejtpërdrejtë me MD); mjedisi (i cili përfshin projekte të zbatuara nga MPPTT); dhe zhvillimi rajonal dhe lokal (i cili përfshin shumë projekte të zbatuara nga pushteti vendor).

Nëse projektet do të menaxhoheshin sipas programit të buxhetit, ato jo vetëm që duhet të lidhen me ministrinë përkatëse, por edhe me departamentin përkatës brenda ministrisë. Kolona e fundit e tabelës me poshtë tregon përqindjen e ndihmës së huaj në sektor lidhet dukshëm me një departament të ministrisë udhëheqëse. Disa sektorë (kryesisht Administrata Publike) kanë një përqindje më të madhe të ndihmës që lidhet me tepër drejtpërdrejtë me një sektor sesa me ministrinë përkatëse.

**Tabela 5.3 Pjesa e ndihmës se huaj që lidhet me ministrinë udhëheqëse**

Sektori i SKZHI-së	Ministria udhëheqëse	Projekte të ministrisë udhëheqëse	Projekte të departamenteve udhëheqëse <sup>1</sup>
Mbrojtja	MD	100%	35%
Administrata Publike	MB	33%	62%
Drejtësia	MD	88%	56%
Punët e Brendshme	MB	97%	97%
Ekonomia	METE	100%	100%
Financa Publike	MF	92%	92%

Energjia	METE	100%	100%
Transporti/Uji	MPPTT	100%	100%
Mjedisi	MMPAU	68%	100%
Arsimi	MASH	98%	64%
Shëndetësia	MSH	99%	86%
Sociale, Barazia gjinore	MPCSSHB	100%	89%
Bujqësia/Rurale	MBUMK/FZSH	91%	100%
Lokale/Rajonale	MB	37%	100%
Lokale/Rajonale	Pushteti vendor	63%	-
Urbane	MPPTT	75%	100%
Të tjera	-	23%	13%
Totali		86%	85%

Burimi: Baza e të dhënave të donatorëve

<sup>1</sup> Kolona e fundit tregon pjesën e ndihmës së huaj që ka lidhje të drejtpërdrejtë me një departament të qeverisë. Kjo nuk do të thotë që ndihma e huaj është pasqyruar në buxhetin e departamentit përkatës ose që departamenti është aktivisht i përfshirë në menaxhimin e projektit.

Dy janë sfidat kryesore për lidhjen e ndihmës së huaj me programet e buxhetit:

- Katër sektorët - mbrojtja, drejtësia, shëndeti dhe arsimi kanë disa projekte të mëdha ndërsektoriale të cilët përfshijnë shumë institucione. Donatorëve u kërkohet të formalizojnë këto projekte si projekte me përfaqëse sektoriale (PBSË).
- Mbështetja për zhvillimin lokal, rajonal dhe rural është praktikuar në mënyra të ndryshme dhe qeveria është përpjekur të sigurojë nivelin e duhur të koordinimit për këto projekte. Baza e të dhënave të donatorëve tregon 11 projekte në vazhdimësi dhe të planifikuara me më tepër se 1 milion euro në mbështetje të zhvillimit të komunitetit vendor<sup>9</sup>. Qeveria po ndërmerr iniciativë për të përmirësuar koordinimin e këtyre programeve në nivel kombëtarpërmes zhvillimit të agjencive rajonale dhe rurale të modeleve europiane. Ka gjithashtu disa programe të cilat kanë për qëllim përmirësimin e financave dhe planifikimit të pushtetit vendor duke synuar që ndihma e huaj të ofrohet edhe për qeverisjen vendore. Donatorëve u kërkohet të mbështesin iniciativat e Qeverisë për koordinimin e zhvillimit lokal.

### Pozicionimi: donatorët bazojnë mbështetjen e tyre financiare në strategjitë kombëtare për zhvillim si dhe institucionet dhe procedurat kombëtare.

**Rezultatet e anketimit të vitit 2006:** Anketa e vitit 2006 tregon se lidhja e ndihmës së huaj me strategjinë kombëtare për zhvillim ekonomik-social (SKZhES) ka qenë relativisht e dobët. Një nga sfidat e identifikuara ishte mungesa e koordinimit në sistemin e raportimit dhe rregjistrimit të ndihmës së huaj. Ndër masat kryesore që duhen ndërmarrë theksohet zbatimi i vazhdueshëm i reformave në sistemet e menaxhimit të financimit publik si dhe të prokurimit. BB në analizat e saj për vlerësimin e politikave dhe institucioneve të vendeve e ka vlerësuar Shqipërinë me 4.0 pikë nga 6.0 të mundshme (treguesi 2) krahasuar kjo me mesataren 3.2 për vendet që ende mbështeten nga ndihma ndërkombëtare për zhvillim IDA. Shqipëria vlerësohet ulët gjithashtu përsa i përket indikatorëve të Vlerësimit të Shpenzimeve Publike dhe Përgjegjshmërisë Financiare (PEFA).

**Arritjet dhe progresi i deritanishëm:** Qeveria është e angazhuar të udhëheqë menaxhimin e ndihmës së huaj nëpërmjet DBSKNH dhe në koordinim me MF. Kjo do të ndihmojë në përmirësimin e raportimit dhe rregjistrimit të ndihmës së huaj, dhe lidhjen e saj me buxhetin dhe strategjinë kombëtare. BB ka filluar të eliminojë njësitë paralele të zbatimit të projekteve, një shërbull është projekti për cilësi dhe barazi në arsim i cili për zbatimin e tij mbështetet tërësisht në strukturat e ministrisë. Një tjetër shërbull është fondi i besimit për SPI-në (financuar nga Qeveria Britanike, Italia, Holanda, KE, Austria, Suedia dhe Zvicra, dhe menaxhuar nga BB) i cili do të përdorë strukturat ekzistuese të qeverisë për zbatimin e tij. Donatorët tjerë kanë shprehur interes në uljen e numrit njësisive paralele të zbatimit të projekteve dhe anketimi i vitit 2008 do të masë progresin e bërë në këtë aspekt.

**Veprime prioritare për të arritur objektivat e vitit 2010:** Prioritetet përfshijnë përmirësimin e vazhdueshëm të sistemeve të MFP dhe atyre të prokurimit; menaxhimin e efektshëm i bazës së të dhënave të donatoreve nga DBSKNH në bashkëpunim me MF; donatorët do të inkurajohen të përmirësojnë raportimin e ndihmës së huaj në mënyrë që të jetë sa më i plotë dhe në kohën e duhur.

<sup>9</sup> Ato janë: CËP (BB/Itali); LCDP (CARDS); LGDP (SHBA); Dibër EDP (NL); ICZMCP (CARDS/Austri); Shkodrër DLDP (Zvicër); SIF (Gjermani); DRD (Suedi); Kukës RDI (CARDS); Kelmend IRRD (Austri); dhe Pilot RDPs (CARDS).

## Përqsja e ndihmës së huaj me bazë programesh

Deklarata e Parisit thekson rëndësinë e pozicionimit dhe harmonizimit të ndihmës së huaj në mënyrë që të arrihet përdorim sa më efikas i saj. Kjo mund të arrihet, për shembull, nëpërmjet ndarjes së punës midis donatorëve, gjë e cila mund ul koston e transaksioneve. Një mënyrë për përmirësimin e pozicionimit dhe harmonizimit të ndihmës së huaj është edhe përdorimi i përqsjeve me bazë programi ose përqsjeve me bazë sektori PBP/PBS<sup>10</sup>.

Anketimi i vitit 2006 tregon se vetëm 5% e ndihmës së huaj ofrohet përmes përqsjeve me bazë programi, shifër kjo që është shumë më e ulët se vlera 66% që synohet të arrihet për vitin 2010 (treguesi 9). Gjithashtu, nga anketimi vihet re se vetëm 14% dhe 6% e ndihmës së huaj respektivisht, përdor sistemet e menaxhimit të financimit publik dhe ato të prokurimit publik në Shqipëri. (treguesi 5a dhe 5b). Vihet re gjithashtu se ka pasur 57 njësi paralele të zbatimit të projekteve<sup>11</sup> me financim të huaj në Shqipëri, shifër kjo gjithashtu shumë e ulët në krahasim me objektivin e vendosur për vitin 2010 që është 19 njësi paralele të zbatimit të projekteve (treguesi 6). 2/3 e këtyre njësive paralele u takojnë donatorëve si Gjermania (17), BE (11) dhe BB (10). Kjo situatë ka filluar të ndryshojë: BB nuk po përdor më njësi paralele për projektet e reja, po kështu edhe KE do të mbështesë ngritjen e Njesisë Qendrore Financiare të Prokurimeve duke ndjekur praktikën e BE-së, njësi kjo e cila do të jetë e lidhur me sistemet e Qeverisë.

Qeveria është e vendosur të përmirësojë sistemet e MFP dhe të prokurimit publik, me qëllim që që përdorimi i buxhetit të shtetit nga ana e donatorëve të jetë sa më efektiv. Besimi tek sistemet e MFP dhe prokurimit do të rritet në pesë vitet në vijim si rezultat i iniciativave dhe reformave të vazhdueshme (psh. Reformat në prokurimin publik, administrimin e të ardhurave, menaxhimin e borxhit, administrimin taksave, shërbimin civil dhe administratën civile), si dhe nga mbështetja intensive që do të ofrohet për menaxhimin e zhvillimeve financiare, kryesisht si pjesë e projektimit të BE-së, IPA. Strategjitë për anti-korrupsionin dhe reforma në administratën publike do të ndihmonin në këtë aspekt.

Megjithatë do të duhen disa vite derisa këto përmirësime të jenë bërë në të gjithë sektorët dhe sfidat do të mbeten veçanërisht për donatorët që punojnë me projekte të vogla dhe që mund të varen nga një përgjigje e shpejtë dhe fleksibël. Duke pasur parasysh këto kushte, Qeveria është e vendosur të bashkëpunojë me donatorët për të gjetur zgjidhje të ndërmjetme, të cilat do të ofronin një bashkëpunim sa më të madh me buxhetin, por jo integrim të plotë në të. Propozimi për të krijuar një Fond Besimi (Trust Fund) për mbështetjen e INSTAT do të mund të sigurojë një model pilot për një zgjidhje të tillë të ndërmjetme. Rritja e rolit të PBA-së në programimin shumëvjeçar do ta lehtësojë këtë tranzicion drejt përqsjeve me bazë programesh. **Donatorëve u kërkohet që të venë në dispozicion burimet e tyre gjatë programimit për të siguruar që të gjitha variantet janë studiuar dhe eksploruar për dhënien e zgjidhjeve tranzicionale dhe në mënyrë që projektet pilot kthehen në përqsje me bazë programi.**

Qeveria do të punojë në veçanti për të forcuar rolin e grupeve sektoriale të punës (SĒGs). Në vitin 2003 u formuan 17 grupe të cilat deri tani janë koordinuar nga STD. Numri dhe fokusi i këtyre grupeve të punës është rishikuar me qëllim reduktimin e numrit të tyre dhe përmirësimin e lidhjes së tyre me strategjitë e qeverisë, ashtu siç është e përcaktuar në SKZHI. Pjesëmarrja e OJF-ve në këto grupe do të ishte shumë e vlefshme. Grupet sektoriale të punës do të marrin përgjegjësi të reja si koordinatorë në rastin e PBP/PBS do të sigurojnë koordinim të përgjithshëm të aktiviteteve pa pasur nevojën integrit të plotë financiar të një përqsjeje me bazë sektoriale (SĒAp) formale. Kjo gjë do të kërkojë gjithë komponentët e projekteve të raportojnë sipas praktikave standarte, duke raportuar shifrat financiare të disbursimit dhe

<sup>10</sup> Pwrkufizime dhe pwrshkrime tw ndryshme janw hartuar nga donatorw dhe autoritete tw ndryshme nw lidhje me faktin se çfarw wshtw njw PBP/PBS. Njw PBP/PBS mund tw krijohet nw mwnyra tw ndryshme, duke filluar qw nga krijimi i "shportave tw financimit" e deri nw mbwshtetjet e plota buxhetore. P.sh. referoju dokumentit Harmonizimi i praktikave tw donatorwve pwr ofrim sa mw efektiv tw ndihmws (Vol. 2) (OECD/DAC, 2006).

<sup>11</sup> njësi paralele të zbatimit të projekteve i referohet njësive të projektit ku emërtimi dhe llogaria kanë të bëjnë vetëm me një donator.

treguesit e monitorimit aty ku të jetë e nevojshme. Donatorëve u kërkohet ta mbështesin këtë proces.

Rritja e rolit udhëheqës nga ana e ministrive të linjës përsa i përket grupeve sektoriale të punës, është e nevojshme për të bërë të mundur rritjen e përdorimit të përqsasjeve me bazë programi apo përqsasjeve me bazë sektoriale. Konsultimi i strategjive sektoriale dhe atyre ndërsektoriale shërben si një pikë fillimi në këtë aspekt. Struktura e grupeve të punës duhet të rishikohet me qëllim rritjen e rolit të përfaqësuesve të qeverisë në to. Për të lehtësuar këtë proces donatorët do të inkurajohen të caktojnë një pikë kontakti, ose donator udhëheqës për çdo sektor. Donatorët inkurajohen të përdorin pjesëmarrjen dhe diskutimet e tyre në grupet sektoriale të punës për të promovuar lëvizjen drejt PBP/PBS.

Një shembull i ndihmës së huaj me përqsasje me bazë programesh apo me përqsasje me bazë sektori në Shqipëri është një projekt në sektorin e arsimit i financuar nga BB, BEI dhe CEB (në zbatim që nga qershori 2006). Ky PBS është krijuar nën strukturën e projektit për cilësi dhe barazi në arsim i cili është një instrument për zbatimin e strategjisë kombëtare. Projekti PBS i arsimit mund të shërbejë si një model për tu ndjekur nga sektorët e tjerë.

### **Harmonizimi: veprimtaritë e donatorëve janë më të harmonizuara, më transparente dhe kolektivisht më efikase.**

**Rezultatet e anketimit të vitit 2006:** Anketimi i vitit 2006 tregon se përpjekjet për harmonizim deri tani kanë qenë të vogla dhe se ka vend për përmirësim të dukshëm. Sfidat e identifikuara në këtë aspekt kanë qenë përdorimi i paktë i ndihmës së huaj në formën PBP/PBS. Veprimtaritë prioritare që duhen të ndërmarrin donatorët nën drejtimin e Qeverisë kanë të bëjnë më tepër me koordinimin e misionëve dhe koordinimin e punës së tyre analitike në vend. Në vitin 2005 vetëm 36 nga 257 misione të donatoreve (që është vetëm 9%) ishin të koordinuara (treguesi 10a), objektivi për t'u arritur në vitin 2010 është 40%. Ndërsa përsa i përket punës analitike vetëm një e katërta e saj (indikatori 10b) është koordinuar midis donatorëve. kjo shifër është shumë më e ulët se objektivi prej 60% që duhet arritur në vitin 2010.

**Arritjet dhe progresi i deritanishëm:** përdorimi i ndihmës së huaj në formën e PBP/PBS është ende i kufizuar në Shqipëri. Puna e përbashkët analitike midis donatorëve është gjithashtu e kufizuar, por PEIR i kohëve të fundit i përgatitur bashkërisht nga BB dhe DfID është një shembull i përmirësimit të saj. Ka gjithashtu disa shembuj të bashkëpunimit të deleguar, të vlerësimeve të përbashkëta dhe strategjive të përbashkëta të ndihmës për vendin. **Një tjetër shembull është iniciativa e OKB-se 'Një OKB'** e cila u lançua nga Qeveria dhe zyrat e OKB-së në maj të vitit 2007, si dhe shembulli i Komisioni European i cili kryen konsultime të shumta me gjithë vendet anëtare të BE-së për përgatitjen e programit IPA 2007 dhe 2008.

**Veprime prioritare për të arritur objektivat e vitit 2010:** të rigjenerohet dhe formalizohet puna e grupeve sektoriale nën drejtimin e qeverisë, punë e cila do të shërbejë si bazë për zhvillimin e mëtejshëm të ndihmës së huaj në formën e PBP/PBS. Donatorët inkurajohen të caktojnë një donator udhëheqës apo pike kontakti për çdo sektor. Donatorët, nën drejtimin e Qeverisë, inkurajohen të përdorin misione të përbashkëta, punë analitike të përbashkëta, vlerësime të përbashkëta dhe mundësisht strategji të përbashkëta të ndihmës së huaj në vend.

## **5.3 KAPACITETI DISBURSUES DHE ABSORBUES I NDIHMËS SË HUAJ.**

Anketimi i vitit 2006 mat parashikimin e ndihmës së huaj (treguesi 7) si propocion i disbursimeve të planifikuara (sikurse raportohet nga donatorët) të cila janë regjistruar në sistemin financiar qeveritar. Në vitin 2005 Shqipëria arriti një nivel të lartë disbursimi, kjo në krahasim me premtimet financiare/angazhimet nga donatorët (në fakt, disbursimi ishte në nivel më të lartë se premtimet për vitin 2005). Sipas shifrave zyrtare të OECD/DAC, disbursimi ka qenë në nivelet 98% për periudhën 2000-2005<sup>12</sup>. Shumë nga disbursimet nuk janë të rregjistruara në sistemin kontabël të qeverisë. Rritja e përdorimit të përqsasjeve me bazë programi dhe përqsasjeve me bazë sektori pritet ta përmirësojë situatën. **Gjithsesi, donatorëve u kërkohet që të hartojnë menaxhimin e të gjithë projekteve në mënyrë të tillë që të integrohen sa më shumë të jetë e mundur me sistemet e MFP-së të Qeverisë duke bërë të mundur që të gjitha disbursimet të raportohen në thesar.**

<sup>12</sup> Niveli i lartë i disbursimit reflekton faktin se premtimet nga ana e donatorëve janë rregjistruar vetëm nga DAC kur marrëveshjet janë nënshkruar dhe zbatimi i tyre është pothuajse i garantuar. Shifrat e larta nuk tregojnë se disbursimi ka ndodhur në kohë duke pasur parasysh që disa nga disbursimet mund të jenë të prapamebetura nga projekte më të hershme.

Baza e të dhënave të donatorëve tregon se disbursimi është bërë më shpejt nga huatë e dhëna nga donatorët shumëpalësh, duke u ndjekur nga grantet e donatorëve dypalësh. Ka pasur ndryshim të konsiderueshem në disbursim përse i përket huave të donatorëve dypalësh dhe granteve të donatorëve shumëpalësh. Në të dy rastet kjo shpjegohet nga vonesat dhe disbursimi i ngadalshëm i disa donatorëve kryesor.

Ritmet e shpejta të reformave dhe rritja ekonomike në Shqipëri nënkupton përballimin e sfidave të mëdha përse i përket menaxhimit të investimeve në shumë nivle të të qeverisë. Këto sfida janë duke u adresuar nga Qeveria me vëmendjen që ajo po i kushton reformës së administratës publike dhe vëmendjen akoma më të madhe që po i kushtohet ngritjes të kapaciteteve qoftë nga Qeveria apo edhe nga donatorët.

Informacioni mbi disbursimin marrë nga baza e të dhënave të donatoreve vë në dukje sektorët të cilëve i duhet kushtuar vëmendje e menjëhershme përse i përket kapacitetit të tyre absorbues. Konkluzionet e nxjerra janë si me poshtë:

Sektorët me disbursim të shpejtë (më shumë se 70%) përfshijnë mbrojtjen, ekonominë, arsimimin, ujin, rendin publik, shoqërinë civile dhe pushtetin vendor.

Sektorët me disbursim mesatar (50%-70%) përfshijnë zhvillimin rural, energjinë, mjedisin, financën publike, shëndetësinë, mbrojtjen sociale dhe administratën publike.

Sektorët me disbursim të ulët (më pak se 50%) përfshijnë transportin dhe drejtësinë.

Inkurajohen donatorët që të përfshijnë në mbështetjen e tyre masat që shërbejnë për të përmirësuar kapacitetin absorbues, veçanërisht në ata sektorë ku disbursimet janë relativisht të ulta.

## 5.4 MONITORIMI DHE VLERËSIMI

### Monitorimi

SKZHI dhe PBA përfshijnë programe monitorimi komprehensive. SKZHI-ja përqendrohet në një numër të vogël treguesish të nivelit të lartë të cilët do të raportohen në bazë vjetore si pjesë e raportit të progresit të saj. Këto indikatorë janë në përputhje me angazhimet e Shqipërisë për Objektivat e Zhvillimit të Mijëvjeçarit (OZHM). Treguesit e PBA-së janë më të detajuar dhe kanë për qëllim të japin më tepër informacion përse i përket progresit të çdo programi buxhetor.

Monitorimi i zbatimit të strategjive sektoriale dhe atyre ndërsektoriale është i bazuar në një listë treguesish të cilët janë të përcaktuar për secilën strategji. Këta tregues fokusohen në arritjen e qëllimeve strategjike, dhe janë zhvilluar mbi bazë të impakteve/ndikimeve dhe rezultateve.

PBA bën të mundur që alokimet financiare për periudhën tre vjeçare të reflektojnë politikat dhe prioritetet e përcaktuara në strategjitë sektoriale duke bërë kështu lidhje të qëllimshme midis alokimeve financiare të buxhetit dhe objektivave të politikave të programeve buxhetore. Monitorimi i zbatimit të strategjive sektoriale dhe ndërsektoriale në nivelin e input-it dhe output-it është si rrjedhim pjesë e sistemit të raportimit buxhetor. Sipas SPI-së, çdo ministri ka për detyrë të hartojë Planin e Integruar të Ministrisë i cili përfshin gjithashtu dhe Planin e Monitorimit të Ministrisë dhe mendohet të shërbejë si:

- Një mjet planifikimi që përmbledh angazhimet kryesore të çdo ministrie për vitin aktual, të shprehura në dokumente të rëndësishme (si për shembull PBA) për të ndihmuar Qeverinë në vlerësimin e performancës;

- Një mjet monitorimi me anë të të cilit ministritë raportojnë progresin e tyre tre-mujor, përsa i përket arritjeve të tyre në lidhje me angazhimet kryesore; si dhe
- Një mjet komunikimi, në kuptimin që dokumenti mbledh angazhimet kryesore të çdo ministrie në mënyre kompakte dhe të integruar, duke ofruar kështu transparencë për publikun.

Planet e Integruara të Ministrive u përgatitën për herë të parë në vitin 2007. Një raport i shkurtër vjetor i ministrive për përmbushjen e angazhimeve të bëra në planin e integruar të ministrive dhe planit të monitorimit do të publikohet në vitin 2008.

Donatorëve u kërkohet të sigurojnë që procedurat e monitorimit të projekteve dhe programeve të tyre të jenë në përputhje me treguesit e SKZHI-së, OZHM-së dhe PBA-së, si dhe të raportohen përmes mekanizmave të njëjtë sikurse edhe indikatorët e mësipërm.

## Vlerësimi

Vlerësimet e bëra nga donatorët janë një burim i rëndësishëm informacioni për të kuptuar impaktin e ndihmës së huaj dhe për të siguruar të dhëna të mjaftueshme për të përmirësuar planifikim e mëtejshëm të saj. Deri tani janë bërë një sërë vlerësimesh nga ana e donatorëve, dhe disa prej tyre janë të përmbledhura më poshtë:

BB. Vlerësimi i Strategjisë së Ndhmës në Shqipëri (2005) Programi i BB ka në përgjithësi rezultate të mira por qëndrueshmëri dhe impakt institucional të dobët, veçanërisht në shëndetësi, arsim, qeverisje dhe në klimën e investimeve. Programet kanë qënë më të suksesshme atëherë kur: a) janë shoqëruar me reforma sektoriale të miratuara dhe mbështetura nga Qeveria; b) janë mbështetur nga analizat dhe strategjitë sektoriale; c) kanë qënë të përbëra nga një seri projektsh fazat e të cilave janë përgatitur me kujdes dhe të cilat janë të lidhura me procesin; d) të hartuara për të ngritur institucione lokale; si dhe e) kanë qënë pjesë e perpjekjeve të donatorëve, të koordinuara nga qëllime të qarta. Programimi i ardhshëm i BB duhet të ketë objektiva të qarta dhe duhet të jetë më i përzgjedhur, i përqendruar në infrastrukturë, shëndetësi dhe arsim. Gjithashtu, duhet një punë më e ngushtë me institucionet qeveritare.

Vlerësimi afatmesëm (2007) i PAMECA, EURALIUS, Mbështetjes për Sistemet e Prokurimeve Publike (SPPS), dhe Programit të Zhvillimit të Komuniteteve Lokale (LCDP). Të gjithë projektet ishin të përshtatshme. Rezultatet kanë qënë të kënaqshme por sfidat ekzistojnë dhe përfshijnë: ndryshimet e mëdha në staf dhe problemet që përfshijnë stafin lokal dhe institucioneve (kryesisht PAMECA, dhe EURALIUS); mungesën e kornizës logjike, indikatorëve të qartë dhe punës së koordinuar (PAMECA); hartimin shumë të komplikuar i projektit (EURALIUS); paqartësi mbi politikat ekzistuese (EURALIUS, SPPS); dhe përputhshmëria e kufizuar në hartimin e investimeve vendore si dhe mungesë e vëmendjes ndaj mirëmbajtjes së qëndrueshme (LCDP). Disbursimet financiare janë vlerësuar si të mira. Vlerësimi ka rekomanduar një menaxhim më të decentralizuar në Shqipëri.

Austria: Vlerësimi i Programit të mbështetjes së vendit (2005). Ndhimja e huaj austriake ka qënë e menaxhuar mirë dhe e suksesshme në arritjen e rezultateve të pritura. Në përgjithësi, aktivitetet kanë qënë në përputhje me nevojat e vendit. Pavarësisht kësaj, projektet kanë qënë të fragmentuara, koordinimi strategjik dhe përfshirja e Qeverisë në programim dhe në reforma në lidhje me projektet ka qënë e kufizuar. Është rekomanduar një përqendrim më i madh tematik në përputhje me politikat dhe institucionet vendase.

SIDA: Vlerësimi i Rezultateve (2007) Projektet e mbështetura nga Suedia kanë qënë në përputhje me objektivat e qeverisë dhe me ato të SIDA-s. Shumë nga projektet i kanë arritur rezultatet e pritura megjithë vonesat e fillimit, shpesh këto të shoqëruara me reforma institucionale. Rritja e kapaciteteve ishte një ndër fokuset më të rëndësishëm, por qëndrueshmëria dhe ngritja e

institucioneve ka qenë e brishtë. Përpjekja për të vazhduar me projekte me përqasje me bazë sektoriale ka qenë mikse: disa nga nënsektorët kanë qenë një përzjerje e mirë e projekteve dhe kjo është një arritje e suksesshme; megjithatë, nuk ka një programim sektorial të rregullt dhe lidhja midis strategjive sektoriale dhe identifikimit të projekteve është akoma e dobët dhe shumë nga projektet janë akoma të izoluar. Efikasiteti dhe menaxhimi i projekteve ka qenë i ndryshueshëm.

Ka disa nota të përbashkëta nga vlerësimet e mësipërme. Së pari, ndihma e huaj është përputhur me nevojat dhe në shumicën e rasteve janë arritur rezultatet e projektit. Së dyti, rëndësia e vendosjes së një përputhshmërie midis strategjive, programeve dhe projekteve. Së treti, vlera në përqëndrimin e programeve të donatorëve në një numër të kufizuar sektorësh dhe nënsektorësh. Së katërti, rëndësia e fokusimit në ngritjen e institucioneve dhe vështirësitë për të arritur këtë. Së pesti, përfitimi nga menaxhimi lokal.

**Qeveria i inkurajon donatorët të ndërmarrin më shumë vlerësime të përbashkëta në partneritet me Qeverinë.** Vlerësimet do të jenë pjesë e iniciativave qeveritare për përmirësimin e vlerësimit të politikave publike. DBSKNH është duke planifikuar ngritjen e kapaciteteve për një vlerësim të sintetizuar të punës si tipar rutinë i dokumentit të orientimit të ndihmës së huaj, i përgatitur çdo vit në periudhën nëntor-dhjetor përpara fillimit të procesit të buxhetit. Kjo do të mbulojë si efikasitetin e vlerësimit (përfshirjen e kapaciteteve absorbuese) ashtu dhe impaktin. Donatorët janë të ftuar ta mbështesin këtë iniciativë. Në periudhën afatmesme kjo do të përfshijë bashkëpunim më të gjerë të qeverisë për të siguruar që aktivitetet e vlerësimit në ministritë e ndryshme janë përdorur gjatë periudhave të rishikimit të strategjisë kombëtare.

**Menaxhimi për rezultat dhe përgjegjësia e dyanshme: Donatorët dhe vendet partnere menaxhojnë burimet, përmirësojnë vendimmarrjen, dhe janë përgjegjës për rezultatet e zhvillimit.**

**Rezultatet e anketimit të vitit 2006.** Anketimi përdor një vlerësim cilësor për të vlerësuar masën në të cilën burimet menaxhohen në bazë të rezultatit të dëshiruar dhe sa përdoret ky informacion për të përmirësuar vendimmarrjen (treguesi 11<sup>13</sup> dhe 12).

Rezultati i këtij vlerësimi ishte i ulët përse i përket sistemit të raportimit dhe vlerësimit si dhe ndërgjegjësimin publik për strategjitë e qeverisë. Sfidat e identifikuar në këtë aspekt ishin se të dhënat ishin të një cilësie të pamjaftueshme dhe jo në kohën e duhur. Veprimet prioritare që duhen ndërmarrë janë krijimi i sistemit të vlerësimit dhe monitorimit në nivel kombëtar si pjesë e SKZHI-së për vitet 2007-2013. Është vënë në dukje gjithashtu mungesa e një mekanizmi për vlerësime të përbashkëta për progresin e bërë në zbatimin e marrëveshjeve dhe premtimeve midis donatoreve dhe qeverisë. Veprimi prioritar në këtë aspekt u identifikua krijimi i Planit të Veprimit për Harmonizim, i cili do të adresojë veprimtaritë e të dy palëve si donatorëve edhe Qeverisë.

**Arritjet dhe progresi i deritanishëm:** Ndërsa synohet për më tepër progres, SKZHI-ja përfshin tregues të nivelit të lartë për sektorët dhe sistemi i raportimit të MSA-së ofron një performancë të rregullt të sistemit të monitorimit dhe raportimit. Ka pasur gjithashtu progres në zhvillimin e një raporti për monitorimin e SKZHI 2007-2013. SKZHI-ja ka kaluar në një proces konsultimi të gjerë në publik duke përfshirë këtu dhe grupe pune të përcaktuara me kujdes, grupe këshilluese, donatorë dhe shoqërinë civile. 22 nga 29 strategjitë janë konsultuar me komunitetin e donatorëve. Çdo strategji është dorëzuar para komisionit parlamentar përkatës. Janë bërë konsultime publike tematike si ai i integritit në BE dhe NATO, zhvillimi ekonomik dhe social, dhe shteti i të drejtës, si dhe janë zhvilluar tryeza të rrumbullakta rajonale, debate televizive, dhe përfshirje e parlamentit. Në këto aktivitete u ftuan rreth 700 vetë. Këto struktura konsultimi tregojnë vendosshmërinë e Qeverisë për zhvillim dhe stabilizim.

**Veprime prioritare për të arritur objektivat e vitit 2010:** Zhvillimi i Planit të Veprimit për Harmonizimin. Donatorët inkurajohen të mbështesin vlerësimin e përbashkët të ndihmës së huaj nën drejtimin e Qeverisë.

<sup>13</sup> Ky vlerësim cilësor ndjek metodologjinë e BB - Kuadri Gjithëpërfshirës për Zhvillim (CDF) dhe fokusohet në krijimin e njw sistemi të raportimit dhe vlerësimit të orientuar drejt rezultateve dhe tw bazuar në teorinë e kostos së efektshme. Vlerësimi është bazuar në tre kritere: cilësia e informacionit mbi zhvillimin, masën në të cilën plawt e interesuara kanë akses në këtë informacion, dhe masën në të cilën ekziston njw sistem i koordinuar i monitorimit dhe vlerësimit tw pwrpjekjeve për zhvillim (OECD, 2007).



## ANEKSI 1. NDIHMA E HUAJ SIPAS DONATORËVE

Tabela A1.1 Disbursimet e ndihmës së huaj sipas donatorëve, 2000-2005 (milion euro)

	2000	2001	2002	2003	2004	2005	Total 2000-05
KE	59.5	44.1	20.9	23.2	30.2	53.1	231.1
IDA	44.0	23.4	53.9	40.6	43.9	20.2	226.1
SHBA	30.6	28.9	42.2	27.3	27.6	29.1	185.7
Greqia	8.4	8.5	10.1	57.0	13.1	16.5	113.6
Gjermania	13.3	16.8	16.9	14.4	16.1	20.8	98.3
Italia	12.5	14.8	16.5	14.2	12.5	5.9	76.4
Holanda	2.6	7.8	7.9	8.7	7.5	6.2	40.8
Japonia	4.8	4.6	2.8	7.3	6.7	12.0	38.2
Zvicra	4.8	4.0	6.4	7.2	5.0	6.5	34.0
Norvegjia	2.4	2.1	4.0	4.1	5.5	4.4	22.5
Donatorë të tjerë dypalësh							
Britania e Madhe	6.6	3.6	3.3	3.1	2.8	2.6	21.9
Franca	1.2	1.4	2.0	2.4	4.5	8.6	20.1
Suedia	0.3	2.6	2.7	3.7	3.9	5.9	19.0
Austria	3.3	1.6	1.2	2.5	3.4	2.9	14.8
Spanja	1.0	1.0	0.9	1.2	1.1	5.4	10.6
Turqia	0.3	0.4	1.1	0.3	3.2	4.8	10.1
Shtetet Arabe	-0.3	1.1	4.3	4.8	-0.5	-0.5	9.0
Danimarka	2.3	2.7	2.3	1.4	0.0	0.2	9.0
Kanada	0.9	1.7	0.9	1.1	0.8	0.4	5.8
Korea	0.0	0.0	0.0	0.1	4.9	0.1	5.1
Finlanda	0.2	0.3	0.6	0.9	1.0	0.5	3.6
Luksemburgu	0.7	..	0.2	0.5	0.6	1.0	3.0
Irlanda	0.4	0.0	0.2	0.3	0.4	0.5	1.8
Republika Ceke	..	0.0	0.1	0.5	0.4	0.3	1.3
Belgjika	0.6	..	..	0.0	0.3	0.3	1.2
Slovenia	..	..	0.0	0.1	0.1	0.9	1.1
Polonia	0.3	0.1	0.0	0.1	0.1	0.1	0.8
Hungaria	..	..	..	0.1	0.0	..	0.1
Donatorë të tjerë shumëpalësh							
SAF+ESAF+PRGF(IMF)	12.1	7.9	3.5	-2.0	1.1	1.6	24.4
IFAD	3.6	1.1	1.6	2.7	4.0	1.8	14.8
Agjencitë Arabe	1.4	0.7	2.7	3.9	1.0	1.4	11.1
UNDP	1.8	1.6	1.1	0.9	1.1	1.4	7.8
UNHCR	0.2	3.4	1.7	1.1	0.8	0.4	7.6
UNICEF	0.3	0.8	0.4	0.5	0.5	0.5	2.9
UNTA	0.7	0.3	0.3	0.3	0.3	0.6	2.5
ËFP	..	..	0.1	0.3	1.5	0.3	2.2
BERZH-i	-0.9	0.1	0.8	0.5	0.4	0.7	1.6
UNFPA	0.4	0.2	0.3	0.3	0.2	0.2	1.6
GEF	0.0	0.0	0.3	0.5	0.2	0.2	1.2

Burimi: OECD/DAC (2007) Donatorët janë renditur sipas totalit ODA për periudhën 2000-2005.

## ANEKSI 2. PROGRAMIMI I DONATORËVE

Orientimi i Qeverisë për komunitetin e donatorëve fillon me negociimin e Qeverisë me donatorët gjatë periudhës së programimit, për të siguruar që prioritetet e Qeverisë janë kuptuar nga donatorët. Statusi aktual i fushave kryesore të donatorëve dhe programeve të tyre janë paraqitur më poshtë. Qëllimi nuk është të jepet një pamje e plotë e prioritetëve aktuale të donatorëve dhe përqëndrimi në sektorë, por më shumë për të paraqitur ndarjen e fushave mes donatorëve.

**Tabela A2. 1 Programimi aktual i donatorëve sipas fushave sektoriale**

	Strategjitë/ Programet e vendit	Periudha	Demokratizimi Shoqëria Civile	Arsimi Shëndetsia Mbrojtja Sociale	Zhvillimi Ekonomik	Energjia	Transporti	Ujësjetës Kanalizime/ Mjedisi
<b>Donatorë Dypalësh</b>								
Austria	Programi I vendit	2007-09						
Danimarka	Programi Me vendet fqinje	2008-12						
Gjermania	Protokoll	2006-07						
Greqia	Nuk ka	Nuk ka						
Italia	Nuk ka	Nuk ka						
Hollanda	Dokumente Kombëtare dhe Rajonale	Nuk ka						
Spanja	Plan Veprimi	2006-08						
Suedia	Strategjia e Vendit	2004-07						
Zvicra	Strategjia e Vendit	2006-09						
Britania e Madhe	Plan rajonal Ndhme	2004-09						
SHBA	Fushat e programit/ MCC	2006-08						
<b>Donatorë Shumëpalësh</b>								
KE	IPA/MIPD	2007-09						
BB/IDA	Strategjia e Ndhmës së vendit	2006-09						
<b>IFI</b>								
CEB	Nuk ka	Nuk ka						
BERZH	Strategjia e Vendit	2006-08						
EIB	Nuk ka	Nuk ka						
IFC	Nuk ka	Nuk ka						

**Shenim:** Tabela është ndërtuar bazuar në rishikimin e strategjive dhe programeve të donatorëve në vend duke u përqëndruar veçanërisht në fushat/sectorët prioritarë të tyre. Tabela nuk përfshin "Agjencitë e Zbatimit të Projekteve" siç janë Agjencitë e OKB, OSBE dhe Këshillin e Europës.

Siç mund të shihet nga tabela A2.1, pothuajse të gjithë sektorët janë mbështetur nga donatorë të ndryshëm. KE, BB si dhe Gjermania, duke qenë donatorët më të mëdhenj, mbulojnë

pothuajse të gjithë sektorët. IFN-të po kthehen në një burim të rëndësishëm në rritje për mbështetje dhe financime si në terma projektesh të mëdha infrastrukture ashtu dhe në zhvillimin e sektorit privat, përfshirë mbështetjet për Ndërmarrjet e Vogla dhe të Mesme dhe aksesin në financë. Zhvillimi ekonomik, duke përfshirë zhvillimin e sektorit privat dhe aksesin në financë dhe lehtësimin e tregtisë, është mbështetur më së shumti nga donatorët dypalësh. Ndërkohë, qeverisja dhe shoqëria civile është një fushë e gjerë e mbështetur si nga donatorët dypalësh dhe nga ata shumëpalësh.

Një numër donatorësh të rinj, duke përfshirë Republikën Çeke, Kuvajtin, Korenë e Jugut dhe Turqinë, kanë filluar ta rrisin mbështetjen e tyre ndaj Shqipërisë gjatë viteve të fundit. Turqia është fokusuar kryesisht në arsim, zhvillim social, dhe kulturë; Kuvajti po mbështet bujqësinë, ujin dhe kanalizimet; Korea e Jugut është aktive në sektorin e energjisë; dhe Republika Çeke ka mbështetur sektorin e shëndetësisë dhe transportit.

## **Donatorët bilateralë**

**Austria:** Mbështetja në kuadër të Programit austriak, 2007-2009, fokusohet tek problematika të tilla si, uji i pishëm, ujrat e zeza, mjedisi dhe arsimi në fushën e turizmit. Mirëqeverisja dhe çështjet gjinore janë gjithashtu problematika që ndërthuren me objektivat e këtij programi.

**Danimarka:** Programi Danez i Fqinjësisë 2004-2008, fokusohet në konsolidimin e shoqërisë civile dhe medias së lirë dhe të pavarur. Tashmë është aprovuar dhe strategjia e re për fazën e dytë të Programit të Fqinjësisë (2008-2012). Fushat me më tepër interes dhe që mund të aprovohen nga Parlamenti danez në të ardhmen janë buqësia dhe zhvillimi rural.

**Gjermania:** Fushat prioritare të mbështetjes nga ky vend janë, furnizimi me ujë të pishëm, menaxhimi i kanalizimeve dhe plerave, prodhimi i energjisë, transmetimi dhe shpërndarja e saj; dhe zhvillimi ekonomik, në veçanti zhvillimi i sektorit privat, mbështetje për NVM-të, si dhe për modernizimin e buqësisë dhe promovimin e turizmit. Një ndihmë e konsiderueshme ofrohet gjithashtu për nismat anti-korrupsion.

**Greqia:** Mbështetja ka qenë e përqendruar tek investimet në infrastrukturë, kryesisht në fushën e arsimit dhe shëndetësisë, si dhe tek transporti dhe infrastruktura e rrugëve. Gjithashtu fushë tjetër ku është treguar interes janë nismat anti-trafik.

**Italia:** Fushat prioritare të mbështetjes italiane kanë qenë investimet në infrastrukturë, veçanërisht në sektorët e ujrave dhe kanalizimeve, transportit dhe rrugëve, si dhe energjisë elektrike. Fusha të tjera ku është dhënë ndihmë janë, buqësia, qeverisja lokale, shëndetësia, zhvillimi i sektorit privat dhe migracioni.

**Hollanda:** Mbështetja në nivel rajonal e dhënë nga ky vend është e fokusuar në bashkëpunimin ekonomik rajonal, që përfshin mjedisin e biznesit, mjedisin rajonal, mbështetjen për NVM-të, lehtësime për financime dhe lehtësimin e eksporteve. Fusha të tjera ku është dhënë mbështetje janë bashkëpunimi bashkiak ndërkufitar, reforma në administratën publike, aktivizimi i shoqërisë civile dhe çështjet e të drejtave të njeriut si dhe mbështetje për ngritjen e kapaciteteve në ministrinë e mjedist dhe të iniciativave lokale për mjedisin. Programi kombëtar fokusohet gjithashtu tek mirëqeverisja dhe mjedisi.

**Spanja:** Mbështetja që jep ky vend fokusohet në fushat e qeverisjes, përfshirë këtu konsolidimin e administratës publike; zhvillimit ekonomik, veçanërisht zhvillimin e sektorit privat dhe mbështetje për NVM-të në sektorin e buqësisë; si dhe mbështetje për sektorët socialë (arsim dhe shëndetësi).

**Suedia:** Mbështetja është fokusuar në fushën e demokracisë dhe mirë qeverisjes, përfshirë këtu reformën në administratën publike, çështjet e shoqërisë civile, të zbatimit të ligjit dhe të drejtave të njeriut; barazinë gjinore, ujin dhe kanalizimet, buqësinë dhe pyjet, zhvillimin

ekonomik, përfshirë mbështetjen për NVM-të, si dhe zhvillimin social me fokus të vecantë tek mbrojtja sociale dhe shëndetësia.

**Zvicra:** Fushat prioritare janë decentralizimi dhe konsolidimi i qeverisë lokale; zhvillimi i sektorit privat me një fokus të vecantë tek NVM-të, mjedisi i biznesit, konsolidimi i institucioneve financiare, lehtësimi për investimet e huaja dhe lehtësimi i aksesit në tregjet ndërkombëtare; si dhe mbështetje për shërbimet sociale dhe infrastrukturën bazë nëpërmjet prodhimit dhe shpërndarjes së energjisë, furnizimit me ujë, reforma në fushën e kujdesit shëndetësor dhe integrimin social të shtresave më të prekshme siç janë fëmijët me aftësi të kufizuara dhe ata romë.

**Britania e Madhe:** Mbështetja fokusohet tek nxitja e një strategjie kombëtare zhvillimi, përfshirë këtu edhe ngritjen e kapaciteteve për zbatimin dhe monitorimin e prioriteteve të zhvillimit në nivel qendror dhe sektorial; mbështetje për procesin e PBA-së dhe për reformën në sistemin e taksave dhe administratën publike, si dhe përmirësimin e efektivitetit të ndihmës.

**Shtetet e Bashkuara:** Mbështetja për bashkëpunimin për zhvillim fokusohet në nxitjen e zhvillimit ekonomik në mjediset e veçanta të biznesit, në zhvillimin e sektorit privat, në sektorin bujqësor dhe atë jobujqësor, dhe në konsolidimin e shërbimeve financiare dhe aksesin në financa. Një fushë tjetër mbështetjeje fokusohet tek qeverisja dhe shoqëria civile përfshi këtu rritjen e përgjegjshmërisë dhe transparencës në sektorin publik, mbështetjen për iniciativat anti-korrupsion, konsolidimin e shoqërisë civile dhe OJF-ve; mediave dhe etikës në to, sondazheve mbi opinionin publik, procesin zgjedhor dhe performancën e institucioneve qeveritare dhe atyre të gjyqësorit. Fusha të tjera me interes përfshijnë konsolidimin e reformave në shëndetësi dhe në shërbimin shëndetësor, si dhe mbështetje për OJF-të antitrafik. Një mbështetje e konsiderueshme është dhënë gjithashtu në kuadër të marrëveshjes MCC sidomos në fusha të tilla si politikave dhe administrimit të taksave, prokurimit publik dhe regjistrimit të bizneseve.

#### **Donatorët Multilaterale**

**Komisioni Europian:** Mbështetja në kuadër të IPA/MIPD 2007-2009 fokusohet në katër fusha kryesore: kushtet politike dhe social-ekonomike, standartet europiane si dhe bashkëpunimi ndërkufitar. Mbështetja do të përqëndrohet gjithashtu tek projektet e ideuara për arritjen e acquis në infrastrukturë. Një fushë tjetër ku do të jepet mbështetje do të jetë qeverisja, përfshirë këtu shtetin e së drejtës, administratën publike, gjyqësorin dhe policinë. Gjithashtu, fusha të tjera prioritare janë edhe zhvillimi ekonomik dhe shërbimi i sigurimeve shoqërore, arsimimi dhe arsimimi dhe trainimi profesional, si edhe tregu i punës.

**Banka Botërore /IDA/IBRD:** Strategjia për ndihmën e vendit (CAS) 2006 - 2009 fokusohet në nxitjen e zhvillimit ekonomik, në mënyrë të vecantë nëpërmjet zhvillimit të sektorit privat, ndërmjetësimit financiar; dhe përmirësimin e mjedisit të biznesit. Fusha të tjera prioritare janë edhe manaxhimi i tokës dhe investimet në infrastrukturë, veçanërisht furnizimi me ujë, ujrat e zeza, transporti dhe sistemi rrugor, infrastruktura e turizmit, prodhimi i energjisë, transmetimi dhe shpërndarja e saj; prodhimi bujqësor, zhvillimi rural dhe manaxhimi i burimeve natyrore. Fusha tjetër e rëndësishme ku jepet mbështetje është përmirësimi i kryerjes së shërbimeve publike, veçanërisht sistemi i arsimit, shëndetësor, dhe ai i sigurimeve shoqërore.

#### **Institucionet financiare ndërkombëtare**

**CEB:** Mbështetja fokusohet në huadhënien tregtare (në bashkëpunim me donatorët bilateralë dhe multilateralë) në sektorët socialë veçanërisht në fushën e arsimit dhe strehimit.

**BERZH:** Në të shkuarën mbështetja ka qenë e fokusuar kryesisht në fushën e energjisë elektrike dhe transportit (përfshirë këtu aeroportet, portet dhe rrugët). Në të ardhmen fusha ku do të jepet mbështetje është sektori privat, si për shëmbull dhënia e huave për NVM-të nëpërmjet bankave vendase. Mbështetja për infrastrukturën do të vazhdojë për rikostruktimin e sektorit të transportit dhe të energjisë.

**BEI:** Rikonstruktimi dhe rehabilitimi i infrastrukturës bazë ka qenë fusha kryesore ku është dhënë ndihmë dhe përparësi të veçantë ka patur forcimi i integritit rajonal dhe zgjerimi i sistemit rrugor, hekurudhor dhe atij të energjisë. Në vitet e fundit mbështetja ka qenë e fokusuar në shëndetësi dhe arsim si dhe në përmirësimin e mjedisit, ujit dhe kanalizimeve.

**IFC:** Mbështetja përqëndrohet në mënyrë të veçantë në sektorët e infrastrukturës përfshirë këtu nxitjen e investimeve nga sektori privat nëpërmjet partneritetit midis sektorit publik me atë privat (PPP) në sektorët e energjisë, transportit dhe ujit e kanalizimeve. Fusha të tjera në fokus të kësaj mbështetje janë edhe integrimi rajonal dhe lehtësimi i përfshirjes së sektorit privat në projektet për zhvillimin e porteve dhe naftësjellësit, si dhe lehtësimi i investimeve të huaja.

